Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 1 (128). JANAR 2017. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.

Gjon Dugilaj, shkodrani që dashuron Dibrën

Nga **Abdurahim Ashiku**

11

Zijai i bimëve mjekësore

Nga **Osman Xhili**

7

Haki Duka, një vlerë e pamohueshme e sportit

Nga **Defrim Methasani**

15

RRUGA E ARBRIT PËRFSHIHET NË PROGRAMIN "NJË MILIARDË PËR RINDËRTIM"

Para zgjedhjeve nisin punimet

Kryeministri Edi Rama: Rruga e Arbrit është në procedurë. Është projekti i parë që do realizohet me Programin "Një miliardë të rindërtimit" dhe kam shumë besim që, nëse nuk do të na tradhtojnë procedurat, shumë shpejt do të fillojë puna edhe për Rrugën e Arbrit". Faqe 3

NË BRENDËSI: ■ **Ç'kemi** asaj Dibre! ■ **Ja si mund** të gjenden paratë për Rrugën e Arbrit ■ **Reagim** zyrtar i shoqatës "Bashkësia Dibrane" ■ **Staraveci**, ballkoni i Dibrës ■ **Vdekjet** e minatorëve në galeritë e kromit mbeten të pandëshkuara ■ **Mehdi Cani**, figurë e shquar e mjekësisë dibrane dhe asaj kombëtare ■ **Katër mbretër** dibranë në Tuz të Malit të Zi ■ **Adem Islam Hoxha** i Çidhnës, heroi i rezistencës ndaj monarkofashistëve grekë ■ **S'ka shtëpi** për Korabin! ■ **Marko Alia**, kënaqësi e madhe në shtëpinë e Lacios ■ **Talenti** që mahnit Londrën ■ **"Ngritje pa krye",** komedia ku shfaqin talentin dy vajzat nga Dibra ■ **Fredi i vogël** me zemër të madhe ■ **Qeshuni** vogëlushë ■ "**Hazis Ndreu** me nëntë fusha" ■ **Jordan Daci**, dibrani që dëshiron të bëhet Avokati i Popullit ■ **Dosja** "gjarpri" ■ **Unë zgjedh** të jetoj pa dhunë ■ **Njeriu i punës** dhe i pasionit për jetën, Isa Hoxha ■ **Elegji** për Bajkenin

Dibra nën dëborë

Nga **Alban Tufa**

- Faqe 5

Kjo foto e realizuar nga fotografi Hektor Pustina u zgjodh si një nga fotot më të bukura nga gazeta britanike The Guardian.

OPINION

Zgjedhjet po afrojnë, na sillni Erjonin deputet!

Nga **BUJAR KAROSHI**

Pesë muaj na ndajnë nga zgjedhjet dhe partitë politike kanë filluar edhe projektimet e kandidatëve të listave të mbyllura. PS duket se nuk mendon të fitojë sërish më shumë se 2 deputetë në qarkun e Dibrës dhe me sa duket nuk do t'i kushtojë rëndësi këtij procesi. Por qytetarët, ata që janë më të interesuarit në një përfaqësim të drejtë dhe të denjë në Parlament, nuk shohin asnjë shenjë besimi se kanalet moderne të komunikimit me deputetin e tyre do të qëndrojnë të hapura.

Disa faqe në rrjetet sociale kanë filluar t'u bëjnë kritika të ashpra 6 deputetëve të Dibrës, ku mes ironisë dhe sarkazmës shigjetojnë veprimet ose mosveprimet e deputetëve, të cilët erdhën me premtimet për më të mirën për Dibrën, por në fakt më shumë për Dibrën bëri Shukriu në burg, sesa ata në sallën e Parlamentit.

Lexoni në faqen 4

Rruga e Arbërit - aty ku fjalët nuk i merr era!

Bej "**Like**" dhe "**Share**". Pajtohu dhe qëndro me gazetën #rrugaearberit më pranë #Dibrës!

Rruga e Arbërit rrugaearberit

Për më shumë informacion:
Tel: 00455 68 65 08 441. +355 **68 65 08 441** +355 **69 20 68 603**
Email: rrugaearberit@gmail.com | www.rrugaearberit.com

cyan magenta yelloë black 1

Gazeta “Rruga e Arbërit” është një media e lirë dhe e hapur.
Çdo kontribut me shkrime, abonime ose donacione është i mirëpritur!
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 1 (129). Janar 2017

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN “ë”.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Korrespondentë të përhershëm:
Abdurahim ASHIKU
Osman XHILI
Sashenka NDREKA
Hysen LIKDISHA

Kontribuan për këtë numër:
Alban TUFA
Dionis XHAFA
Arsim KOLARI
Defrim METHASANI
Nazmi KOÇI
Samet ZAGRADI
Selami NAZIFI
Saimir SHATKU
Edmond HASANI
Olta SHEHU
Armanda GJOKA
Elsa SALA
Xhelal ROÇI
Selman MËZIU
Edval ZOTO
Halil RAMA
Manjola TERSHANA
Gjergj EREBARA
Grehans UKA

Fotoreporter: Fehmi Lleshi

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t’i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t’i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. llog. në lekë: 0010036640
IBAN: AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640
Adresa e gazetës:
Rr. “Zenel Baboçi”,
Pall. “Ferar”, Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

Foto: © Edmond Hasani

Ç’kemi asaj Dibre!

Nga **BUJAR KAROSHI**

Ra bora dhe u pamë. Sa të bardhë ishim nga jashtë dhe sa të zinj nga brenda... U rrit çmimi i biletave për Peshkopi me 200 lekë që ditën e parë të Vitit të Ri.

Qeveria u lodh shumë duke nxjerrë deklarata për rrugët e hapura dhe ato ku përdoren zinxhirë. Rruga për Lurë, njoftim pas njoftimi, thuhej se ishte e bllokuar. Si nuk e bënë një njoftim në verë që rruga është e hapur, se si shi, si borë dhe si diell, rrugë për Lurë ka pasur dikur, por tani nuk ka...

Dhe meqë nuk ka rrugë, ndihmat i çojmë me helikopter. Lurjanët në komunizëm i deshën patatet e ziera, kështu që ndihmat i duan gjysmë të gatuara, ndaj i hidhnin nga helikoperi...

Ata që kishin të hanin, ngopeshin dhe dilnin të prisnin ndihmat, ata që nuk kishin, nuk dilnin të lypnin...

Meqë qe ftohtë dhe pati borë, shohim se edhe kush na qeveris: sepse dalin në foto ose i montojnë në kompjuter, që të duken si të dhimbsur për popullin, që rri brenda, ngrohet te zjarri dhe hanë pulë me jufka e lozin domino... Ndërsa qytetit dalin sa për të thyer ndonjë brinjë, pasi rrugët nuk i pastron kush...

Shkollat u mbyllën nga bora. Pati zëra se u mbyllën se shkollat ishin pa ngrohje - ndryshe nga çfarë ishte propaganduar, por këta zëra vinin nga bregu i Lanës në Tiranë...

U hap lajmi andaj nga fshatrat e Bulqizës se ujqërit kanë sulmuar nxënësit që shkojnë në këmbë në shkollë... Duhet të kenë qenë njerëz që kanë ulëritur si ujk, që të bëhej lajm, e nga lajm problem. Se ndryshe nuk kujtohet kush t’u gjejë një furgon fëmijëve, së paku në këto ditë të ftohta...

Fillimi i Vitit të Ri erdhi me avaze të vjetra. Kryeministri premtoi premtimin tre viteve më parë, dy viteve më parë dhe një viti më parë: Rruga e Arbrit do të fillojë shumë shpejt... Këtë vit me siguri do fillojë, pasi kemi zgjedhje...

Ndërsa ne presim që qeveria të fillojë Rrugën e Arbrit, ministrja njoftoi se ndërtuan rrugën në Kurdari e Kurqelaj...

Na e pushuan edhe një ministër dibran. Ky ishte i dyti. Populli thotë lloj-lloj arsyesh se pse e shkarkuan, por unë kam mendimin se i pari u shkarkua se ishte Shkëlqim dhe shkëlqente, ndërsa i dyti ishte Yll dhe shndriste! Tani do qajmë hallin se ka mbetur qeveria në errësirë...

Korabit i shkoi një fazë kampionati duke kërkuar fushë dhe fitore. Të parën ia heqin se nuk bën pazar me ndeshjet, të dytën nuk ia japin se nuk do arbitri. Hajde e merre vesh pastaj pse 22 lojtarë ngaredin pas një topi...

Gjithë PS-istëve, PD-istëve dhe LSI-stëve u them të mos mërziten se pse ka çam në Dibër, sepse nga dy fitore Korabi në këtë sezon, njërën e mori në Peqin...

Lajm i mirë është se stadiumi në Peshkopi, premtim pas premtimi, ka filluar të rregullohet. E kemi rrethuar me llamarina... si shesh ndërtimi...

Tani, lexues, e di që do më pyesësh se “Ç’kemi nga Dibra e Madhe”?

-Eeeeee hhhhaaaaaaaaaaa!

REAGIM

Reagim zyrtar i shoqatës “Bashkësia Dibrane”

Shoqata “Bashkësia Dibrane” dhe “Këshilli i të Urtëve” po ndjek me shqetësim dhe seriozitet reagimet e disa pseudointelektualëve dhe studiuesve që kohët e fundit duan të “kontibuojnë” për Rrugën e Arbërit. Shkrimet e tyre si psh: “Rrugën e Arbërit”, nuk ja kërkojmë shoqatave por qeverisë si dhe shkrime të tjera si to, ku kundërshtohet fizibiliteti i saj, mbajnë frymën e përçarjes dhe të kundërshtimit pa argument dhe fakte konkrete, ato janë vetëmse tymnaja të pavlera, të cilat ndihmojnë kauzën e mos ndërtimit të saj.

“Bashhkësia Dibrane”, kërkon me insistim dhe zyrtarisht ti jepet fund fjalëve që prodhojnë vetëm retorikë dhe kthim pas të projektit dhe fizibilitetit të “Rrugës së Arbërit”, dhe apelon se shkrime të tilla, apo peticione nuk e cojnë përpara vlerat, traditat dhe qytetarinë tone.

“Bashkësia Dibrane” as nuk ka marrë në mbrojtje dhe as do të marri në mbrojtje projektuesin e “Rrugës së Arbërit” z. F. Kaba, pasi studio e tij e ka bërë mbrojtjen e saj kohë më pare në DPRR, pranë MPPTT, duke patur pjesë të grupit të punës, personat të cilët sot sulmojnë ndërtimin e saj sipas standartave dhe parametrave ndërkombëtar dhe evropian.



SHOQATA BASHKESIA DIBRANE
TIRANE-SHQIPERI

Adresa: Rr: “E Saraçëve” nr. 16 (pranë Selvisë) Tiranë-Shqipëri
www.bashkësiadibrane.blogspot.com/email:dibranebashkesia3gmail.com

REAGIMI ZYRTAR I SHOQATES “BASHKESIA DIBRANE”

Shoqata “Bashkësia Dibrane” dhe “Këshilli i të Urtëve” po ndjek me shqetësim dhe seriozitet reagimet e disa pseudointelektualëve dhe studiuesve që kohët e fundit duan të “kontibuojnë” për Rrugën e Arbërit. Shkrimet e tyre si psh: “Rrugën e Arbërit”, nuk ja kërkojmë shoqatave por qeverisë si dhe shkrime të tjera si to, ku kundërshtohet fizibiliteti i saj, mbajnë frymën e përçarjes dhe të kundërshtimit pa argument dhe fakte konkrete, ato janë vetëmse tymnaja të pavlera, të cilat ndihmojnë kauzën e mos ndërtimit të saj.

“Bashhkësia Dibrane”, kërkon me insistim dhe zyrtarisht ti jepet fund fjalëve që prodhojnë vetëm retorikë dhe kthim pas të projektit dhe fizibilitetit të “Rrugës së Arbërit”, dhe apelon se shkrime të tilla, apo peticione nuk e cojnë përpara vlerat, traditat dhe qytetarinë tone.

“Bashkësia Dibrane” as nuk ka marrë në mbrojtje dhe as do të marri në mbrojtje projektuesin e “Rrugës së Arbërit” z. F. Kaba, pasi studio e tij e ka bërë mbrojtjen e saj kohë më pare në DPRR, pranë MPPTT, duke patur pjesë të grupit të punës, personat të cilët sot sulmojnë ndërtimin e saj sipas standartave dhe parametrave ndërkombëtar dhe evropian.

Për ti dhënë fund këtij diskutimi të pavlerë që bëjnë disa sharlatanë studies dhe inxhinier, “Bashkësia Dibrane” ofron dhe rekomandon mbajten e një tryeze pune me ekspert, studies inxhinier, përfaqësues nga Shoqatat dibrane, DPRR, Ministrisë përkatëse, dhe arkitekt ku të jetë i ftuar dhe projektuesi i “Rrugës së Arbërit” e aty të zhvillohet debati përmes një analize konkrete dhe arguemtuese;

Mbetemi në pritje të realizimit të tryezës me grupet e interesit, shoqatat dhe personat e interesuar;

KRESIA E SH.B.D DHE KESHILLI I TE URTEVE

Faksimile e deklaratës së shoqatës “Bashkësia Dibrane”

Shënim i redaksisë:

Pasi u njohëm me deklaratën e shoqatës Bashkësia Dibrane, e ndjejmë për detyrë ndaj lexuesit dhe bashkëpunëtorëve tanë të bëjmë një sqarim.

Njëra nga arsyet e botimit të gazetës “Rruga e Arbrit” është lobimi çdo ditë për ndërtimin e rrugës. Disa anëtarë të shoqërisë civile kanë 20 vite që përpiqen për këtë çështje, por gazeta po bën 11 vjet që po botohet dhe asnjë ditë dhe asnjë numër nuk ka penguar askënd t’i shprehë pikëpamjet dhe mendimet e veta, profesionale apo qytetare qofshin, në dobi të ndërtimit dhe dhënies shtysë që procesi të ecë përpara.

Fatkeqësisht, gjatë këtyre 20 viteve, por sidomos 10 vitet e fundit, nuk kemi mundur që të jemi një zë i vetëm, në mënyrë që ta detyrojmë qeverinë që këtë çështje ta marrë seriozisht. Përkundrazi, dikush haptazi e dikush fshehtas janë bërë palë me qeverinë në këtë vend, dhe “hë se presin dibranët”, “e shtyjmë edhe ca kohë projektin”, “kthejeni për ripunim projektin”, “e lëmë për vitin tjetër fillimin e punës”, “nuk kemi para këtë vit”, e kështu me radhë, rruga ka mbetur aty ku ka filluar.

Ashtu si shkrimi i prof. Bashkim Lleshit, botuar në numrin e kaluar, apo shkrimi i Dr. Gëzim Alpion disa numra më parë, trajtojnë disa problematika për të cilat ia vlen që qeveria t’i marrë parasysh. Ne, si redaksi, nuk e kuptojmë reagimin kaq negativ të shoqatës Bashkësia Dibrane apo qejfmbetjeve të prof. Faruk Kabës në lidhje me këto shkrime. Të kërkosh që të rrisësh standardet e një rruge, e cila nuk është ndërtuar akoma, nuk i bën dëm askujt, përkundrazi. Pasi ajo të ndërtohet nuk ka më kuptim të shkruash apo të flasësh.

Gjithashtu, t’i kërkosh qeverisë që punimet t’i nisë nga tuneli e konsiderojmë krejt legjitime. Ne kemi bindjen se në qoftë se rruga do të ndërtohet pa tunelin, ajo kurrë nuk ka për t’u ndërtuar më. Pavarësisht se çfarë besojmë individualisht secili prej nesh. Sepse asnjë qeveri në këtë vend, që nga koha kur ministër ka qenë Spartak Poçi, për 20 vite me radhë, nuk e ka marrë asnjëherë seriozisht çështjen e rrugës. Dhe më mirë se ne këtë e di edhe prof. Faruk Kaba, projektet e të cilit herë dorëzoheshin pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve apo në Ministrinë e Transporteve dhe ktheheshin e riktheheshin për rishqyrtim, sipas oreksit të qeverisë për tu marrë ose jo me Rrugën e Arbrit. Kur u duhej për politikë thoshin “projektin e kemi gati”, kur nuk u duhej më, e kthenin projektin për “ripunim” dhe thoshin “nuk ka projekt”.

Si gazetë kemi qenë të hapura për të gjithë shoqatat dibrane, sado të vogla apo të mëdha të jenë, por nuk e fshehim simpatinë dhe respektin për “Bashkësinë Dibrane”, edhe për arsyen se ajo asnjëherë nuk është përpjekur ta fshehë “anësinë” nga e djathta. Ndryshe nga disa shoqata të tjera që përpiqen të jenë apolitike ose shumë politike. Ndaj, në këtë kuptim, të bësh një deklaratë kundër disa njerëzve, organizatave apo lëvizjeve që kërkojnë që ta bindin ose ti bëjnë presion qeverisë që të rrisë financimet, ose të rishohë projektin me qëllim përmirësimin e rrugës, është jo në natyrën e “Bashkësisë Dibrane”. As Bashkësisë Dibrane dhe as Prof. Kabës, gazeta nuk ua ka mbyllur faqet asnjëherë për çdo lloj qëndrimi.

Gazeta “Rruga e Arbërit” ka 11 vjet që ekziston për shkak të këtij lobimi. Nga kjo nuk kemi përfituar asnjëherë shuma financiare, përkundrazi, paguajmë çdo numër nga xhepat tanë që ajo të vazhdojë botimin.

Ne kemi bindjen se sikur gazeta të mos botohej, rruga do të ishte harruar. Ndaj, faqet do të jenë të hapura gjithmonë për ata që mendojnë, shkruajnë dhe lobojnë për këtë çështje, pavarësisht se kush preket ose kujt i preket sedra apo interesat.

BUJAR KAROSHI, redaktor i gazetës

aktualitet

Kryeministri Rama: Rruga e Arbrit është në procedurë. Është projekti i parë që do realizohet me Programin "Një miliardë të rindërtimit" dhe kam shumë besim që, nëse nuk do të na tradhtojnë procedurat, shumë shpejt do të fillojë puna edhe për Rrugën e Arbrit".

RRUGA E ARBRIT PËRFSHIHET NË PROGRAMIN "NJË MILIARDË PËR RINDËRTIM"

Para zgjedhjeve nisin punimet

Nga **BUJAR KAROSHI**

Kryeministri Edi Rama shfrytëzoi një takim me kryetarët e bashkive për të deklaruar se "Rruga e Arbrit është duke hyrë në fazën e dytë të procedurave dhe në qoftë se ato nuk na tradhtojnë, shumë shpejt do të fillojë puna".

Kryeministri e dha përgjigjen e tij si përgjigje për kryetarin e bashkisë së Dibrës, Muharem Rama, i cili kërkoi mbështetje nga qeveria për "investime në sistemimin e përroit të llixhave dhe vetë llixhat".

"Ju falenderoj për investimet deri tani në Dibër, por kemi zonën e llixhave, një zonë kurative që pret shumë turistë, për të na mbështetur me investime në sistemimin e përroit të llixhave dhe vetë llixhat. Mendoj që kjo është lehtësuese për Dibrën", - i tha Rama kryebashkiak Ramës Kryeministër.

"Jemi dakord për rëndësinë e llixhave nuk ka këtu, as majtas e as djathtas, - tha Kryeministri. Jam i bindur që nuk ka asnjë shans që të mos kemi konsensus që llixhat e Peshkopisë janë shumë të çmuara, por sill projektin. Ne financojmë projekte. Sillni projektin dhe ne do t'ju mbështesim. Për Dibrën kemi dhënë e do vazhdojmë të japim një mbështetje të vazhdueshme. Përfitoj nga rasti të them që Rruga e Arbrit është në procedurë. Komisioni duhet gjatë kësaj jave të mbyllë fazën e parë të procesit dhe të hyjmë në fazën e dytë. Është projekti i parë që do realizohet me Programin "Një miliardë të rindërtimit" dhe kam shumë besim që, nëse nuk do të na tradhtojnë procedurat, siç ka ndodhur me planin e Lezhës apo me ekskavatorët, shumë shpejt do të fillojë puna edhe për Rrugën e Arbrit".

Për Rrugën e Arbërit Kryeministri foli edhe në një takim me përfaqësues të institucioneve financiare, sipërmarrjes, bankave dhe ekspertë për prezantimin e programit të ri kombëtar "Një miliardë për rindërtim".

"Synojmë që me këtë program të adresojmë disa probleme të rëndësishme të infrastrukturës rrugore nacionale, të adresojmë nevojën për të përmirësuar ndjeshëm infrastrukturën e zonave turistike. Pjesë e këtij programi është edhe Rruga e Arbrit, për të cilën kanë nisur procedurat dhe është projekti i parë i cili përfshihet në këtë program dhe për të cilin ka një procedurë të nisur, bazuar në legjislacionin në fuqi, nga Ministria e Transporteve", - theksoi Kryeministri.

E MAJTA - NJË HISTORI PËR RRUGËN E ARBËRIT

Kur Partia Socialiste ishte në fushatë katër vite më parë, Rruga e Arbërit ishte kryefjala. "Jo vetëm Rruga e Arbrit, por të gjitha rrugët do të jenë ndryshe nga rrugët që ndërtojmë këta, që kanë ngelur rrugëve", - thoshte atëherë kryetari i PS.

Qasja e tij ndaj kësaj çështje ishte shumë ndikuese dhe të bënte me optimizëm.

"Ky është një projekt kombëtar, është një projekt shumë i rëndësishëm jo vetëm për ju, por është shumë i rëndësishëm për Shqipërinë. Është një projekt që nuk garanton thjeshtë lëvizjen, nuk shkurton lëvizjen thjeshtë, po garanton një zhvillim për një territor të tërë që tani është jashtë hapësirës së zhvillimit dhe është një projekt që për ne hyn tek projektet strategjike që ne do ta çojmë përpara me shumë vullnet", - thoshte zoti Rama nga Klosi.

Pasi mori postin e Kryeministrit Rama e përfshiu Rrugën e Arbërit në punën e parë të kësaj qeverie në fushën e infrastrukturës. Por kjo mbeti vetëm në letër.

Punimet e mbetura përgjysëm mbi Urën e Vashës Foto: © Bujar Karoshi

> Një burim nga Ministria e Transportit tha për gazetën se bisedimet janë drejt fundit dhe Rruga e Arbërit do të jetë njëri nga projektet e financimit të paketës "1 miliardë dollarë" që parashikohet të nisë këtë vit me mbështetjen bankave dhe biznesit privat.

> Një propozim i Ing. Faruk Kabës për vënien në funksion të rrugës sa më shpejt në një version pa tunel, ka hasur në kundërshtimin e një pjese të shoqërisë civile, por nuk dihet nëse kjo ka marrë miratimin e Ministrisë së Transportit dhe Autoritetit Rrugor Shqiptar.

Në dhjetor 2014 ishte vetë Kryeministri që në një status në FB dha lajmin e nënshkrimit të një "memorandumi bashkëpunimi me Chinese Exim Bank për hapjen e një kantieri projektesh në Shqipëri me financime kineze. Projekti i parë që do të çelë siparin e një epoke të re bashkëpunimi mes Shqipërisë e Kinës do të jetë Rruga e Arbërit, e cila do të nisë vitin e ardhshëm". Në prill të vitit 2015, Parlamenti miratoi me 89 vota "pro" një ligj të posaçëm që i hapte rrugë negocimit me kompaninë kineze "China State Construction Company". Për të gjithë kjo u interpretua si një hap i rëndësishëm në nisjen e punimeve, por muaj pas muaji u kuptua se negociatat po shkonin drejt dështimit. Asnjë nga përfaqësuesit e Ministrisë së Transportit, Financave dhe Ekonomisë dhe asnjë deputet i Parlamentit shqiptar nuk foli për dështimin e negociatave. Burime të gazetës pohuan se "negociatat dështuan për shkak të dyshimeve për korrupsion, gjë që e detyroi Exim Bank të tërhiqej nga financimi. Por qeveria e pranoi dështimin vetëm në fund të vitit 2015, duke nxjerrë si arsye koston e lartë të ndërtimit dhe financimit të kërkuar prej kinezëve. Nga 210-250 milionë që ishte oferta fillestare, sipas burimeve të qeverisë kostoja e financimit parashikohej të kalonte 600 milionë euro.

Më qesharakja në këtë proces ishte fakti që Ministri i Transportit, sa herë që fliste në televizione apo në takime me shtypin thoshte se "së shpejti nisin punimet", por kur marrëveshja dështoi, askush nuk dha një informacion se cilat ishin arsyet e vërteta.

Tërheqja zyrtare e kompanisë kineze në muajt e fundit të vitit 2016 duket se e vuri në vështirësi qeverinë shqiptare. Në këtë periudhë, një kompani shqiptare, "Gjoka Construction" i propozoi qeverisë shqiptare që ndërtimin e 27 kilometra të mbetura të rrugës mund ta ndërtojë ajo me vlerën e 190 milion dollarë. Një komision i ngritur në Ministrinë e Transporteve po e diskuton këtë draft dhe sipas deklarimeve të fundit të Kryeministrit Rama, duket se procesi është drejt përfundimit.

Erind Gjoka, drejtor i përgjithshëm i "Gjoka Construction", konfirmoi në muajin tetor 2016 se "i kishin propozuar qeverisë shqiptare për ndërtimin e plotë të të gjithë pjesës së mbetur të Rrugës së Arbrit. Koha e realizimit të punimeve 3 vjet dhe me një kosto shumë më të ulët se ajo e kompanisë kineze dhe standard më të lartë teknik".

Një burim nga Ministria e Transportit tha për gazetën se bisedimet janë drejt fundit dhe Rruga e Arbërit do të jetë njëri nga projektet e financimit të paketës "1 miliardë dollarë" që parashikohet të nisë këtë vit me mbështetjen bankave dhe biznesit privat.

Burimi thotë se "Gjoka Construction" ka vënë garanci në bankë një shumë prej 45 milionë USD dhe është Banka Kombëtare Tregtare që pritet të financojë punimet. Por kjo e dhënë nuk është e konfirmuar plotësisht. Një email për më shumë informacion në adresë të kompanisë "Gjoka Construction" dhe deputetëve të Dibrës ka mbetur pa përgjigje.

DEBATI : SHOQËRIA CIVILE DHE RRUGA E ARBËRIT

Peticioni online i nisur katër vite më parë vazhdon të jetë aktiv. Në një faqe në Facebook organizatorët po vazhdojnë të kërkojnë mbledhjen e firmave në letër dhe online, si një mënyrë për t'i dëshmuar qeverisë se qytetarët nuk kanë hequr dorë nga kërkesa e premtuar prej tyre gjatë fushatës së kaluar, me synim nisjen dhe përfundimin sa më shpejt të Rrugës së Arbërit me cilësi dhe standarde. Peticioni i ka kaluar mbi 12 mijë firma, por jo mjaftueshëm për ta detyruar kryeministrin që të ulet me nismëtarët e peticionit dhe organizata të tjera të interesuara, për të kuptuar më shumë se cilat janë shkaqet që procesi nuk po ecën përpara.

Për të nisur dhe përfunduar sa më shpejt punimet, ing. Faruk Kaba, drejtues i firmës projektuese "Infratransprojekt", i cili ka projektuar një pjesë të madhe të segmenteve të rrugës, ka propozuar edhe një projekt të shpejtë, ndërtimin e rrugës në një fazë të parë pa tunel, e cila do të çonte në nisjen e shpejtë të lëvizjes së mjeteve brenda 18 muajve dhe një fazë të dytë ndërtimin e tunelit, kur edhe fondet të jenë të siguruara.

Por ky propozim ka hasur në kundërshtimin e organizatorëve të peticionit, të cilët kanë kërkuar që ky segment rrugor të tenderohet në bllok dhe jo pjesë-pjesë, pasi kjo do të rrezikonte standardet e ndërtimit.

Ndërsa ing. Bashkim Lleshi dhe dy shoqatat dibrane, "Lidhja e Intelektualëve Dibrane" dhe "Nisma Dibrane" kanë propozuar rishikimin e projektit në disa segmente, sidomos Tunelin e Murrizit dhe Urën e Vashës, me qëllim përmirësimin e ndërtimit të standardeve të rrugës.

Këto çështje kanë hapur debat mes shoqatave dibrane, por deputetët e Dibrës apo përfaqësues të Ministrisë së Transportit apo Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve nuk kanë shfaqur asnjë lloj interesimi.

Pavarësisht se kur do të nisin punimet, deri më tani përveç ndonjë të dhëne sipërfaqësore për gjatësinë e rrugës, gjerësinë e saj, veprat e artit dhe volumet e punës, nuk ka asnjë informacion për publikun për detajet të tjera, si. p.sh. gjatësinë e tunelit, Urës së Vashës, mënyrës së financimit si partneritet publik, privat apo si financim nga buxheti i shtetit, nëse rruga do të jetë me pagesë etj.

* * *

Punimet e para në Rrugën e Arbrit kanë filluar më 3 korrik 2005, kur një ekskavator gërmoi pak dhè në Fushë Bulqizë, te vendi i quajtur Gurët e Skënderbeut, sa për të prerë kryeministri i atëhershëm një shirit inaugurimi. Por tenderi i parë për një segment të rrugës nga Bulqiza te Ura e Çerenecit u zhvillua në tetor 2007, për të filluar punimet në fund të atij viti. Disa segmente të tjera, nga Bulqiza drejt Urës së Vashës dhe nga Tirana për në Qafë të Tujanit janë në ndërtim prej disa vitesh.

Nga projekti "1 miliardë për rindërtim" pritet të dalin financimet për pjesën e mbetur të rrugës, 27 km, nga Ura e Vashës në Qafën e Tujanit, ku përfshihet edhe Tuneli i Murrizit, Ura e Vashës dhe disa vepra të tjera arti. Rruga parashikohet në një gjerësi 10.5 m dhe një shpejtësi lëvizje 60 km në orë.

Rruga e Arbërit nr. 129

opinion

Dibra ka në Parlament rreth 14 deputetë, gjashtë prej të cilëve të zgjedhura më vota nga zgjedhësit e qarkut të Dibrës, por ndjehet pak ose shumë pak e përfaqësuar.

Zgjedhjet po afrojnë, na sillni Erjonin deputet!

Nga **BUJAR KAROSHI**

Pesë muaj na ndajnë nga zgjedhjet dhe partitë politike kanë filluar edhe projektimet e kandidatëve të listave të mbyllura. PS duket se nuk mendon të fitojë sërish më shumë se 2 deputetë në qarkun e Dibrës dhe me sa duket nuk do t'i kushtojë rëndësi këtij procesi. Por qytetarët, ata që janë më të interesuarit në një përfaqësim të drejtë dhe të denjë në Parlament, nuk shohin asnjë shenjë besimi se kanalet moderne të komunikimit me deputetin e tyre do të qëndrojnë të hapura.

Disa faqe në rrjetet sociale kanë filluar t'u bëjnë kritika të ashpra 6 deputetëve të Dibrës, ku mes ironisë dhe sarkazmës shigjetojnë veprimet ose mosveprimet e deputetëve, të cilët erdhën me premtimet për më të mirën për Dibrën, por në fakt më shumë për Dibrën bëri Shukriu në burg, sesa ata në sallën e Parlamentit.

Disa nga çështjet kryesore të debatuara gjatë zgjedhjeve të kaluara për banorët e Dibrës ishin: Rruga e Arbërit, HEC i Katundit të Ri dhe Skavicës, Statusi i Minatorëve, ndërtimi kanaleve vaditëse në bujqësi apo investimeve në bujqësi, ruajtja dhe zhvillimi i pyjeve apo ndërtimi i infrastrukturës rrugore brenda rrethit. Por për asnjërin prej problemeve të mësipërme nuk ka zgjidhje konkrete. Rruga e Arbërit vazhdon të mbetet një çështje e hapur dhe pavarësisht se janë thënë se "shpejt nisin punimet", dhe një ligj i posaçëm u miratua në Parlament, çështja është kthyer sërish nga fillimi. HEC i Katundit të ri kaloi përmes procedurave të dyshimta të dhënies me koncension pa miratimin e publikut dhe tenderi dështoi. Statusi i minatorëve nuk është miratuar akoma, ndërsa në Bulqizë duket se vetëm "vdekjet aksidentale" janë rralluar, por problemet mbeten po ato. Ashtu si dhe investimet në bujqësi kanë qenë të pakta ose tregu nuk ka mundur t'i thithë investimet. Mollët dhe patatet kalben sërish, ashtu siç ka ndodhur edhe në të kaluarën.

Deputetët tanë, ata të cilët kanë marrë edhe votat për t'i mbajtur këto premtime, nuk shfaqen më. Maksimumi ata arrijnë sa të heqin një drejtor dhe të vendosin një tjetër, por për elektoratin nuk mendon më kush. Nga profilet e deputetëve në Facebook nuk mësojmë asgjë.

Një perceptim për konkluzionet e mësipërme mund ta krijosh kur takon ndonjë drejtues në strukturat qeverisëse në Dibër ose ato partiake, por edhe duke vëzhguar profilet e deputetëve në rrjetet sociale, kryesisht në Facebook.

Shkëlqim Cani, ishte i pari në listën e PS në qark, por që pas zgjedhjeve deri në Bulqizë është parë të shkojë, maksimumi deri të Ura e Lushës, një urë mbi Drin që të çon në fshatin e tij të lindjes. Më tej asgjë. Në profilin e tij në FB ai është akoma ministër i Financave dhe postimi i tij i fundi në faqen e tij mban datën 13 shkurt 2016, tre ditë para se të shkarkohej nga detyra e ministrit të Financave.

Ulsi Manja, deputeti i vetëm i PS, tashmë i ka "larë duart me Dibrën", siç u thotë miqve të tij. Ai është parë kohët e fundit të riaktivizohet me strukturat e PS në Paskuqan, duke lënë të kuptohet se nuk do të jetë më kandidat i PS në Dibër, as me vullnetin e tij dhe as me atë të kryetarit.

Suksesi i tij i vetëm në Dibër ishin dështimet e njëpasnjëshme, duke i krijuar një hapësirë PDIU për t'u zgjeruar shumë shpejt dhe për të rritur shpresat që në këtë qark të marrë edhe 2 deputetë në zgjedhjet e qershorit 2017. Faqja e tij në FB është e mbyllur, me sa duket nga mërzitja që i krijonin qytetarët me premtimet e pambajtura, kryesisht

Profili joaktiv i deputetit Shkëlqim Cani në Facebook.

Profili joaktiv i deputetit Ulsi Manja në Facebook.

Profili i deputetit Përparim Spahiu në Twitter.



Profili i deputetit dhe disa postime të fundit të deputetit Erjon Braçe në Facebook.

Një vëzhgim në profilet e deputetëve të majtë të Dibrës në rrjetin social Facebook: Shkëlqim Cani është akoma "Ministër i Financave", Ulsi Manja e ka mbyllur profilin ndërsa Përparim Spahiu përdor Twitter.

Një krahasim me profilin e Erjon Braçes, deputetit të "dërguar me dhunë" në Lushnje, por që tani ka arritur ta kthejë Divjakën në zemrën e Myzeqesë.

Disa faqe në rrjetet sociale kanë filluar t'u bëjnë kritika të ashpra 6 deputetëve të Dibrës, ku mes ironisë dhe sarkazmës shigjetojnë veprimet ose mosveprimet e deputetëve, të cilët erdhën me premtimet për më të mirën për Dibrën, por në fakt më shumë për Dibrën bëri Shukriu në burg, sesa ata në sallën e Parlamentit.

për Rrugën e Arbrit.

Ndërsa deputeti tjetër i majtë, Përparim Spahiu nuk shfaqet fare në Facebook. Me të njëjtin emër dalin së paku 9 veta, por asnjëri nuk e lidh profilin e tij me deputetin e LSI. Por, Spahiu, ndryshe nga të tjerët, shfaqet në profilin në Tëitter me ndonjë postim për Dibrën, por kryesisht për turizmin dhe festat e LSI. Shumë pak për investimet e qeverisë në qark apo në ndonjë vepër a investim të ri të qeverisë.

Deputetët e PD, Roland Keta dhe Bedri Hoxha kanë nga një profil në faqen e FB, por jo shumë aktive. Më aktive duket deputetja e re Dhurata Çupi, e cila në statuset e saj nuk përmend vetëm Matin, por bën edhe ndonjë kritikë për qeverisjen në përgjithësi.

Meqë Partia Socialiste po e ndan mendjen çdo ditë e më tepër se në Dibër një deputet do ta ketë të sigurt, të tjerët e listës janë sa për të qenë në rregull me ligjin, do të doja që PS të propozonte për deputet të parin në listë, një person që së paku e mban edhe formalisht lidhjen me elektoratin. Nuk shfaqet atje kur ka ndonjë veprimtari apo me raste festash, por çdo javë e çdo muaj të shkojë në një fshat. Të jetë edhe aktiv dhe i komunikueshëm, më së paku të tregojë durimin dhe gatishmërinë që premtimet që ka dhënë nuk i ka harruar. Në qoftë se do t'i bënte edhe ndonjë kritikë qeverisë, aq më mirë, por edhe nëse nuk e bën publikisht, së paku formalisht e kryen punën e tij. Dhe unë do të propozoja që numri 1 i listës të ishte Erjon Braçe!

Edhe Erjonin e sulmojnë. E shajnë! Bëjnë ironi me të, por ai nuk e ka fshirë faqen e tij në FB, përkundrazi. Është aktiv edhe në rrjetet e tjera sociale, Instagram, etj., me të njëjtën energji që vjen nga këmbëngulja e tij për të qenë afër njerëzve, pranë votuesve të tij.

NJË VËZHGIM NË PROFILIN E ERJONIT: ÇDO JAVË MES VOTUESVE, VERIFIKIM INVESTIMEVE

Kur Erjon Braçen e larguan nga listat e Beratit katër vite më parë dhe e çuan në Divjakë të Lushnjës, të gjithë ishin të një mendje se Edi Rama e largoi Erjonin. Por ai punoi aq fort, sa ia arriti të mblidhte votat e banorëve të urtë e punëtorë të Lushnjës. Jo vetëm kaq, por Erjoni arriti që ta kthente Lushnjën në një qendër të Jugut të Shqipërisë. Nuk ka ditë, javë e muaj që media qendrore të mos flasë për Divjakën. Në Divjakë kanë ndodhur aq shumë ndryshime gjatë mandatit të kësaj qeverie, sa është e paimagjinueshme: iu rikthye laguna qytetarëve dhe është kthyer në një destinacion turistik në guidat e turizmit botëror. Kanë filluar investimet në Divjakë në shtrim rrugësh, hapje e rregullim kanalizimesh urash, ujësjellësa, kanale kulluese e vaditëse, ndërtim shkollash e kopshtesh, shëtitore në Divjakë, ndriçim rrugësh, vendosje linjash të reja elektrike e transformatorësh, investime në bujqësi e sera etj.

Këto dhe plot investime të tjera janë të publikuara të gjitha në median qendrore, por mbi të gjitha janë të pasqyruara në profilin në FB të deputetit Erjon Braçe.

Fshatrat e Lushnjës: Tërbuf, Çermë-Proshkë, Çermë e Poshtme, Staravecm Gërmenj i Madh, Grabjani, Kryekuq, Remas, Gradishtë, Mërtish, Këmishtaj, Goriçaj, Divjakë e Oplot lagje e rrugë të zonës së tij elektorale nuk kanë ditë që të mos shfaqen në profilin publik të Erjonit. Diku një shkollë, diku një rrugë, diku një kanal vaditës a kullues, diku një çati e diku një asfalt një zgjerim rruge, një investim sado i vogël dhe krejt i papërfillshëm reklamohet përmes fotos e fjalëve. Por jo vetëm investime e ndërtime, por edhe për njerëz punëtorë, drejtues e zbatues projektesh, elektricistë e inxhinierë, pensionistë e të rinj, puna e përkushtimi i të cilëve është i lidhur me këto investime.

Erjoni nuk ka qenë vetëm reklamues i mirë i investimeve, por edhe një kërkues i llogarive për ata që mbajnë përgjegjësi kur punët nuk shkojnë mirë. Mos harroni periudhën e verës, kur një sëmundje preku vetëm 3% të të mbjellave të kastravecit dhe ai nuk hezitoi aspak të kërkonte përgjegjësinë e strukturave të Ministrisë së Bujqësisë nga Lushnja në Tiranë, madje duke mos hezituar as të kërkonte publikisht dorëheqjen e Ministrit të Bujqësisë.

(Vijon në faqen 8)

Rruga e Arbërit nr. 129

reportazh

Dibra nën dëborë

Nga **Alban TUFA**

Në kthimin tim në Dibër pas shkëputjes së parë të gjatë; fiks tre muaj mu dashuruan sytë me pamjen që ndesh në të hyrë të qytetit, aty mbi kodra tek futesh në Dobrovë. Këtë pamje nuk ma lanë pemët ndanë rrugës, ti cilat rrëshqisnin mbi sytë e mi, dhe unë nuk mundja të ngopesha me pamjen që me kënaqësinë time ndeshej për së pari herë. Kjo më ngjate si ekran televizori të cilit dikur i mungonte sinjali.

Edhe këtë herë pamja e njëjtë, ekrani po ashtu pa sinjal, pemët rrëshqitën mbi sytë e mi tek furgoni veç soste dishezën, po e njëjta pangopësi me panoramën (vras mendjen si mund të ngopen sytë), por diç më qartë, diç më kthjellët,. sepse pemët ishin lakuriq. E gjithë lodhja e rrugës shterohet nga kjo pamje. Tek futesh më thellë, ndjen se ky vend është një vakum përthithës thënë parimisht vetëm nga çfarë shohin sytë duke mos i përzier ndjenjat. Mandej shpërfaqen çatitë rrotull xhamisë së vjetër, secila prej çative tymos, në sinkron me llullat e pleqve dhe pashmangshëm të shkon mendja se aty brenda ka jetë, kuvendohet dhe se zakoni po gjallon akoma. Nëse për pak e provon të humbësh sensin e kohë-hapësirë, këtu gjithçka të shpall; Dibër dhe dimër.

Anipse dimër qyteti gumëzhin. Gumëzhin në formën më të çlirët, në mënyrën më poetike, gumëzhin pa qëllim. Bulevardi është pikëtakimi. Edhe këtë herë plot. Këtu takohen të gjithë; miq, shokë, familjarë, nga i pari i qytetit tek i fundit. Këta njerëz të gjithë mbartin një hall, një brengë dhe presin të takojnë një shok asnjë mik e të zbrazen.

Këtu këtë fundvit po lidhen shumë krushqi. Viti i ri i mbledh të rinjtë në këtë bulevard dhe beqarët kërkojnë të nisin një jetë. Në të kundërt të Tiranës (ku po studioj) këtu njerëzit njihen, përshëndeten në rrugë. Nuk i bën dot dhjetë metër pa njohur dikë. Ndoshta kjo është pasojë e qyteteve të vegjël, por se kam ndeshur këtë as në qytete më të vogla, gjë që më bën të besoj së këtu njerëzit ruajnë në thelb një harmoni, një respekt që s'ka mund me e zhbërë koha.

Këtu takohet edhe historia; i pari qëndron Elez Isufi, mandej Skënderbeu, pastaj Iliaz Pasha e me radhë. Ata buzëqeshin, japin selame tek iu dridhen cepat e mustaqeve. Shpesh duket sikur thonë që Dibra ka qenë dhe do jetë. Unë ndalem, i përshëndes, ju shpreh një mall që ndonjëherë as veten se njoh e më tej vazhdoj rrugën për në fshatin tim.

Po ai fshat, por malli më i dendur, më i ngjeshur. Nuk jam larguar më shumë se tre muaj nga ky vend. S'po hyj t'i bëj një analizë nëse s'kam mund apo s'kam dashur, por një gjë me lidh aq fort; gjaku sigurisht. Oborri i shtëpisë sime i njëjti veç luleve që nuk ishin, (i ka prish ngrica thotë ime më), dhe prindërit disi më të plakur. Çdo herë kur vij i gjej më të plakur. Koha nuk ndalet, ose ne nuk ndalemi. Vras mendjen si do ketë qenë fshati im para dy-treqind vitesh. Filloj e urrej faktin pse teknologjia është zhvilluar kaq vonë dhe unë nuk kam foto të atyre viteve.

Mëngjeset janë të njëllojta. Dhe mbrëmjet po ashtu, veç mesditës kur sillem rrugëve me shokë e kushërinj. Toka krejt e murrme. Nuk e dua vitin e ri kështu. S'e di në iu ndodh edhe juve që kjo ngjyrë toke të mos ju ngjall asnjë kujtim.

Mëngjesi i katërt i këtij viti nuk është më bezdisës. Çel derën dhe shoh gjithë hapësirën e lyer me qumësht, pastaj mendoj jo qumësht...gjizë. Po gjizë, tipike gjizë Dibre (që Tirana e do fort). Bora dhe gjiza janë dy produkte, nëse mund të shprehem kështu, që vendi ynë i ka me shumicë në dimër.

Aty para dere duke çliruar kërpeshin e syve, i lë të shëtisin nga vargmali i Deshatit deri poshtë nga ata të Lurës. Gjithë çka rrok syri janë dy pllaka të mbivendosura, e bluja mbi të bardhë. Ja kështu bëhet vendi ynë; bardhë e blu.

Foto © Grehans Uka

Lehtë një erë fillon të vij nga Korabi. Ai do të dëshmojë prezencën e vet, sepse sigurisht këtë dimër si çdo të shkuar nuk ia var askush. Dielli qet krye mbi vargmalin e Deshatit, e rrezet i përplas mbi dëborë duke krijuar kështu kristale si kjo dëborë të qe diamant. Duhen një palë syze terr të zeza, por sërish nuk duhet mbuluar ky akt demonstrimi i të bukurës me syze, aq më keq të terrta. Kështu që e bukura do sërish sakrificë.

Hedh hapat e parë në dëborë dhe veten e ndjen (siç thotë një miku im) sikur po shtyp mbi niseshte; prruf-prruf. Qumësht gjizë e tashmë dhe niseshte- kjo trajtë e kristaltë duket se na është bërë si ushqim për dimrin. Nuk ka dimër pa dëborë e pa ngrica thonë pleqtë tonë. E gjitha kjo të shpie në domosdoshmërinë e kësaj trajte.

Me të dalë nëpër fshat vëren që rrugët gjallojnë, të vegjël e të mëdhenj kanë dalë e po rrëshqasin kudo që rrugica të tatëpjeta. Ata gjithherë zgjedhin ato më të gjatat dhe më pak të frekuentuarat, sepse aty nuk ua prish kurrkush terezinë; nuk del asnjë plakë të hedhje hì, apo t'ua prishje rrëshqizat me ndonjë shat a kazëm. Këtu të gjithë janë të barabartë, veç faktit se dikush i ka çizmet më të lëmuar dikush më pak.

Edhe pse dëbora është e një trashësie jo të vogël qyteti sërish gumëzhin, po në atë mënyrën e çiltër e poetike, po në atë mënyrën e paqëllimtë. Sërish njerëz me brenga. Dëbora sikur i shton edhe pse dibranët i kanë marrë masat për një dimër të egër që para nëntorit. Jemi popull punëtor dhe ia kemi dalë gjithherë në mote edhe më të egër. Ndoshta kjo na ka bërë mos e duam një dimër pa dëborë.

Kështu llogaritë nuk janë dhe aq keq. Jemi në janar dhe kemi këtë dëborë të dëshiruar. Nëpër trotuare sheh grupe shokësh të cilët ecin tre-katërshe. Ndër to mund të veçoj një grup që tek ecnin i pari i dalë si pozicion jashtë loje, trazon një degë peme dhe dëbora e ndodhur mbi të, iu bie në kokë e qafë te tjerëve. Këto episode përsëriten shpesh, madje dhe unë e kam bërë disa herë. T'ju them të drejtën të jep kënaqësi. Duhet ta provoni!

Nëpër trotuar njerëzit në ecje e sipër kanë krijuar ca si dhiare duke ecur njëri pas tjetrit. Dëbora e shtypur ka marrë tashmë trajtën e akullt dhe vetëm një rritje relativisht e lartë e temperaturave do mundet ta shkrijë. Nuk e merr kush guximin të shkel mbi dëborën e patrazuar, virgjine, por guxojnë të ecin mbi këtë të akulltën, sidomos edhe disa gra të shëndosha. Sa herë i shoh ashtu, ndjej frikë se mos rrëzohen. Por gjithçka shkon për vije; secila ka ose një djalë, ose një nip përdore dhe sigurisht, mundësitë të rrëzohen janë disa herë më të vogla.

Nëpër Bulevard, punimet e të cilit i ndërpreu ngrica, e tashmë i vulosi dëbora gjenden paleta me pllaka guri. Këto krijojnë forma kubike dhe gjithë ç'përfitojnë sytë, janë forma abstrakte, të pa qëllimta duke qenë një art më vete në mesin e skulpturës dhe pikturës

Nëpër lagje, fëmijë, banorë të pallateve kanë ndërruar banim; natën janë në pallat, ditën janë poshtë në punën e tyre më të rëndësishme të kohës; të bërit njerëz prej bore. Pa u ngopur me dëborën, me pamjen dhe me mallin për familjen më duhet të shkuptem sërish me vendin tim. Më duhet të ik, por jam i bindur që ikja s'do zgjasë tre muaj. Furgonat presin dhe herë herë kam një urrejtje të ndërkryeme për ta sepse ndajnë njerëz. Urrejtje për trenin do ta mbajnë furgonat, duke qenë se trena s'kemi; s'kam ç't'iu bëj.

Ulem në furgon, nga krahu i djathtë me synimin për të shijuar pamjen. Furgoni niset me përtacinën e vet. Po me atë përtaci e ngjit kthesën e Bulkallarëve. Çan tej nëpër Dobrovë. Dyqanet rrëshqasin dhe ata para syve të mi. Tërë ato ndërtesa rrëshqasin. Mandej shfaqet pamja ime e shumëdëshiruar me gjithë pemët që më pengojnë. Malli zë fije prapë në qenien time fillon të tjerret në boshtin e kujtesës sime.

Do thoni ju; po pse nuk del tek ajo kodra në këmbë dhe të ulesh aty me orë të tëra e të ngopesh me pamjen e dëshiruar, të çmallesh me vendin tënd? S'ju ka shkuar mendja? Jo? Normal, s'ka si ju shkon. Po mirë, jua them unë.

Nuk jam ndal dhe as nuk do ndalem kurrë aty sa të kem jetën, vetëm për një arsye: nuk dua të ngopem me vendin tim, dua gjithnjë të kem një boshllëk nga ky vend dhe ky boshllëk të jetë magneti që më tërheq, të jetë e paplota ime. Duke pas këtë boshllëk do çmallem me intervale të shpeshta e të shkurtra me vendin tim, si një lidhje që s'do shkëputet kurrë. Si një litar i gërryer nga sëpata, në mes me një fije çeliku që se pret dot asgjë. Si nevoja dhe mundësia që rreken jetësisht të plotësojnë njëra-tjetrën.

Rruga e Arbërit nr. 129

Shpëtim Puca, me origjinë nga Dibra, drejtues i kompanisë "YENİ BALKAN MAKİNA" propozon financimin dhe ndërtimin e rrugës nga komuniteti i biznesmenëve dibranë.

intervistë

PROPOZIMI I PA MARRË PARASYSH NGA BIZNESMENI DIBRAN NË TURQI:

Puca: Ja si **mund të gjenden paratë për Rrugën** e Arbrit

Nga **BUJAR KAROSHI**

Financimi i Rrugës së Arbërit nga vetë komuniteti dibran ka qenë një ide e diskutuar në mjediset e biznesit dhe shoqërisë civile. Më është dukur një ide që nuk mund të ketë përkrahje dhe nuk ia vlen të harxhosh kohë me të, por një email i mbërritur në redaksinë e gazetës në gusht të vitit 2016, ishte për t'u marrë parasysh. Emaili i shkurtër i ardhur nga Shpëtim Puca thoshte se "Rrugën e Arbrit mund ta bëjnë vetëm dibranët. Unë për veten time jam gati në çdo vend ku të më caktohet të bëj 2-3 km rrugë, me kushte shumë ma lehtësuese se firma kineze. Do të përdor forcën punëtore dibrane dhe si dibran, jam gati të punoj për rritjen e mirëqenies së popullit tim".

Shpëtimi shkruante në email se rrugën mund ta ndërtojnë së bashku 70 biznesmenë dibranë dhe ne si media, kishim detyrë që t'i jepnim zë propozimit të tij.

"Ju si media e keni për detyrë të na mblidhni në Tiranë, të diskutojmë, të ngremë një grup pune dhe të bisedojmë me qeverinë, të nxjerrim një kosto për financimin e rrugës dhe unë së bashku me biznesmenë të tjerë jemi gati të fusim duart ne xhepa për ta sensibilizuar këtë problem".

Nisur nga këto emaile, ne ju drejtuam zotit Puca me disa pyetje:

- Z. Puca, si e mendoni ju financimin nga biznesi privat për Rrugën e Arbrit?

- Më lejoni në fillim të them se dëshira e Rrugës së Arbërit është dëshirë e çdo shqiptari dhe çdo dibrani në veçanti. Jemi rritur në sistemin komunist dhe besoj se e dini edhe juve ç'është e pritura në rrugë orë dhe ditë të tëra për të shkuar në Tiranë sa e gjatë është rruga, sa e vështirë, po ashtu sa i vështirë ishte shansi për të gjetur një makinë. Tani me ardhjen e demokracisë, me rritjen e mirëqenies në përgjithësi mendoj se Rruga e Arbërit është e domosdoshme.

Ishte një gabim shumë i madh mendimi se një makinë duhet të shkojë në çdo fshat dhe zikzaket e rrugës bënin që një autobus të bënte 250 km rrugë të prishur e gjithë gropa Tiranë-Peshkopi ose anasjelltas. Ishin 10 12 orë rrugë sfilitëse për njerëzit në hall, për pleqtë dhe të sëmurët.

Unë jetoj në Turqi dhe shpejtësia mesatare e rrugës që bëj unë është 90-100 km në orë. Po ashtu, një pjesë e punëtorëve të mi e kanë shtëpinë në periferi të Ankarasë dhe atyre u duhet për të ardhur në punë të bëjnë një rrugë prej 70-80 km që në kushtet e rrugëve tona të bëhet për 40-50 minuta. Me këtë doja të thoja që me përfundimin e Rrugës së Arbërit një punëtori nga zona jonë pas 5 vitesh do t'i duket diçka e zakonshme puna ditore në Tiranë.

Financimi i Rrugës për mendimin tim mund të zgjidhet shumë thjeshtë. Flitet për 70 km rruge, që sipas vlerësimeve zyrtare shkon nga 150-220 milion euro ose me vlerësimin kinez, bëje - fito dhe pastaj dorëzoja shtetit që shkon deri në afro 400 milion euro.

- Pse mendoni ju se biznesi dibran mund ta financojë këtë rrugë?

- Mendoj se dibranët i kanë vetë këto para. Mjaftojnë vetëm 70 biznesmenë dibranë që në plan të parë duket më i madh, ngel në Shqipëri, u mbetet qytetarëve shqiptarë.

Po ashtu, çdo biznesmen shqiptar që është edhe nacionalist, edhe fitimet që ai nxjerr nga ndërtimi i rrugës do t'i përdorë përsëri për një investim tjetër më të madh në vendin e tij.

Dihet që fitimi i kompanive të huaja në Rrugën e Kombit ka qenë mbi 500 milionë euro, pra fitimet ikën jashtë vendit, avulluan. Një firmë shqiptare një gjë të tillë nuk e bën. Ato lekë, mirë ose keq, në të ardhmen investohen në Shqipëri. Po ashtu, nuk më pëlqen mënyra se si trajtohen firmat vendase deri më tani, si vjedhës, hajdutë.... Shumë biznesmenë shqiptarë janë heronj kombëtar të ditëve të sotme, pasi ata sakrifikojnë çdo gjë.

- A mundet kompanitë vendase ta ndërtojnë tunelin?

- Unë sot jam në gjendje të bëj 3-4 km rrugë. Puna më e rëndë e ndërtimit është tuneli. Unë jam në kontakt me kompani të huaja që këtë ndihmë e japin, por këtë herë do të jetë ndryshe: kompanitë e huaja do të vijnë të punojnë si nënkontraktore, pra, punën ta marrin nga ne dhe shumë më lirë dhe me kushte më të mira sesa kompania kineze.

Në qoftë se shteti financon një pjesë të rrugës, tunelit, afro 40 milion euro, i gjithë tuneli përfundon shumë lirë dhe me një kohë rekord. Pjesa tjetër është shumë më e thjeshtë.



Foto e faqes së parë në internet e kompanisë wwwyenibalkanmakina.com

KUSH ËSHTË SHPËTIM PUCA?

Në foto: Shpetim Puca/Facebook

Shpëtim Ali Puca, nga Sopoti i Dibrës, jeton prej 25 vitesh në Turqi. Ka mbi 10 vjet që ka kompaninë e tij me qendër në Ankara, YENİ BALKAN MAKİNA (www.yenibalkanmakina.com), firmë e specializuar për mirëmbajtjen e rrugëve. Kompania e tij punon në 15 vende të botës. Ka hapur një filial në Maqedoni "Arida" dhe në Shqipëri "Timak". Kompania merret me prodhimin e makinave për mirëmbajtjen e rrugëve, makina për larjen dhe pastrimin e rrugëve, pastrimin e ujërave te zeza, zjarrfikëse, makina për montimin e sistemit të energjisë diellore etj.

Paulonia është një nga drurët që po nxiten të kultivojnë fermerët vitet e fundit, por Zijaji ka sjellë edhe një bimë tjetër nga Kina, Xhoi, frutat e të cilës kushtojnë shumë shtrenjtë dhe jetëgjatësia e saj është mbi 25 vjet.

Nga **Osman XHILI**

Katër vite më parë, Drejtoria e Bujqësisë në Dibër, në bashkëpunim me Q.T.T.B në e Shkodrës, organizonte një seminar trajnues për kultivimin dhe teknologjinë e disa bimëve me vlera medicinale. Interesimi i fermerëve të ftuar nga komuna të ndryshme ishte shumë i madh, saqë salla e madhe e konferencave ishte mbushur plot. Profesori nga Shkodra, Konstandin Hajkola, me një përvojë të gjatë në lëminë e shkencës dhe të prodhimit, ligjëronte por dhe dëgjonte me vëmendje pyetjet e bëra dhe u përgjigjej atyre me një gatishmëri për tu admiruar.

Mes dhjetëra të pranishmëve në sallë ishte dhe Zija Keshi nga Maqëllara. Ai kishte tokë, por nuk ishte fermer. Nuk ishte marrë me bujqësi e blegtori. Sapo kishte ardhur nga emigracioni në Itali, ku kishte punuar për dhjetë vjet në profesione të ndryshme. Babai i tij, Osmani, kishte punuar gjithë jetën me misrin, jonxhën, grurin, lopët e viçat. Djali i tij, Zijai, e shihte të pamundur e të pavlerë vazhdimin e kësaj mënyre primitive të punuari. Profesor Hajkola fliste për bimë të reja mjekësore si: sherebela, shafrani, aronia, paulonia, e të tjera si këto. Disa ishin eksperimentuar në Shqipëri, një pjesë tjetër, akoma jo. Zijai e kishte harruar për një moment se ku ishte, sa kohë kishte kaluar, se kë kishte pranë. Ishte hedhur në krahët e fantazisë, po fluturonte si pëllumb në fusha të mbjella me këto kultura të reja të së ardhmes. Në mendje kishte piketat e eksperimenteve, që do të realizonte pa u ndalur asnjë çast.

profil

Zijai thotë se Paulonia është një investim, të paktën 40 vjeçar dhe pas çdo pesë vjet prerje lihet një filiz i drejtë, për të formuar drurin e ri, që do të pritet pas pesë vitesh të tjerë.

Zijai *i bimëve mjekësore*

Aronia është një "mbesë" e boronicës autoktone, që Zoti ka kultivuar nëpër male. Vlerat e saj medicinale, kurative dhe ushqimore janë aq të mëdha dhe për pasojë dhe çmimi jo pak intrigues, gati 20 euro për kilogram.

SHEREBELA

Asaj kohe, kjo kulturë ishte në kulmin e shkëlqimit. Nuk ishte më nevoja të mblidhej kjo bimë nëpër male, do të zbriste në fushë. Kishte një çmim të mirë, rreth dymijë lekë, plus dhe që kishte subvencion nga shteti. Aty, ngjitur me rrugën e asfaltuar që të çon tek dogana e Bllatës, tamam mbi shkollën e Majtarës, Zijai kishte plot gjashtë dynymë, që do ti mbillte me këtë kulturë. U interesua për fidanët dhe i thanë që më i miri ishte lloji " Taraboshi"i Shkodrës, që prodhohej nga Agim Rama, shumë pranë llojit autokton, që mblidhej në male. Në vitin 2012, ky lloj sherebele zuri vendin e parë në Europë. U morën jo pak, por 31 mijë fidanë me kubikë, në mënyrë që rritja të ishte e menjëhershme. Vlera e tyre ishte diku te 3,5 milion lekë. Në fund të prillit, fidanët u mbollën në fushë,për tre ditë, 30 centimetra larg njëri tjetrit dhe 70 centimetra mes rreshtave. Parcela u rrethua bukur dhe në krye të saj u hap një pus, që kushtoi mbi katër milion lekë. Dhe pse uji doli që në thellësi 12 metra, shpimi i tij me sondë vazhdoi deri në gati 30 metra, në mënyrë që uji i tij të mos e njihte kuptimin e tharjes dhe shterimit, qoftë dhe në pikun e verës. Plehërimi vetëm me pleh organik, dy vaditje, pastrimi i barërave të këqija, ishin disa nga shërbimet kryesore, që dhanë një rezultat prej 14 kuintalë sherebelë të tharë, që në vitin e parë. Korrja u bë me drapër, në muajin gusht dhe tharja e masës bimore u bë në një ambient të mbyllur, pasi tharja në diell jep ngjyrë të zezë dhe prish cilësinë.Tregtari që erdhi të merrte sherebelën e tharë, u kënaq me pamjen, por bëri dhe analizat për sasinë e cilësinë e vajit bimor, gjë që rezultoi në parametra mjaft të kënaqshëm. Nga shitja e mallit me 1800 lekë për kilogramë, u shtuan rreth 2,5 milion lekë në arkën e familjes.

Në vjeshtë, sipërfaqja u mbulua me një shtresë plehu organik. Më pas, vazhduan shërbimet e vitit të dytë, prashitje e ndonjë vaditje e rrallë. U bënë dy korrje me drapër dhe prodhimi qe shumë më i madh. Por tregjet botërore të sherebelës ishin tronditur, për shumë e shumë arsye, për pasojë dhe ai shqiptar. Çmimi i shitjes kishte pësuar ulje dhe Zijai mezi arriti ta shesë me njëmijë lekë kilogramin. Ishin këto sinjale se ylli i sherebelës gati po perëndonte dhe ndoshta do të duhej shumë e shumë kohë për të rilindur dhe njëherë akoma.

ARONIA

Pusi i hapur, rrethimi i bërë, pritshmëritë, shpresat, të gjitha këto kishin marrë një goditje të fortë. Por Zijai është i qëndrueshëm në karakter, si një boksier me eksperiencë, që amortizon dhe goditje të fuqishme. Që nga takimi me profesorin shkodran, kishte pasur në mendje dhe bimë të tjera si Aronia dhe Paulonia. Përse të mos e provonte të parën si vazhdim të asaj që kishte nisur? Çdo gjë ishte gati, nuk do të bënte asnjë investim shtesë. Mes rreshtave të sherbelës do të fuste fidanat e Aronias. Ndërsa e para do të vazhdonte dhe pak kohë të vegjetojë e të japë prodhim, e dyta do të rritej për bukuri në parcelën me të gjitha kushtet e plotësuara.

Po cila ishte kjo bimë e re, të cilën do ta eksperimentonte fermeri ynë? Po fidanët ku di gjente, pasi në Shqipëri ishte hera e parë që po mbillej? Në fakt, Aronia që po kultivohej, ishte si të thuash një "mbesë" e boronicës autoktone, që Zoti ka kultivuar nëpër male. Vlerat e saja medicinale, kurative dhe ushqimore janë aq të mëdha dhe për pasojë dhe çmimi jo pak intrigues, gati 20 euro për kilogram. Zijai nuk e peshoi dy herë problemin. Dëgjoi se serbët kishin jo pak ekskluzivitet për këtë kulturë . U lidh me një firmë serbe dhe kjo e fundit i merrte fidanët e certifikuar në Lion të Francës. Firma serbe kërkoi lekët për garanci për fidanët që do të sillte. Njëmijë fidanë me 9,5 euro, bënin në total afërsisht 10 mijë euro.

Në fund të marsit fidanët erdhën, bashkë me teknologjinë e kultivimit. Punonjësit e firmës morën dheun për analizë dhe në krye të dy ditëve konfirmuan se të gjitha parametrat dhe cilësitë e tokës ishin në rregull. Në të kundërt, thanë përfaqësuesit e firmës, ne do merrnim fidanët prapë e do të kthenim paratë. Mbjellja e fidanëve u bë në distanca tre metra mes rreshtave dhe dy metra mes bimëve. Gropat u hapën 70 me 70 centimetra, të mbushura përgjysëm me pleh organik. Pas tre muajsh, thanë njerëzit e firmës, do të verifikohet zënja e fidanëve. Për çdo fidan që nuk zen, ti do të marrësh trefishin e vlerës. Mrekullisht, asnjë fidan nuk harroi të çel sythë e gjethe, bile 20 përqind e tyre u futën në prodhim që në vitin e parë. Pjekja e frutit filloi që në korrik, por serbët thanë, që prodhimi duhej të vilej në fund të shtatorit. 50 kilogramë frut i thatë, ishte rezultati i vitit të parë. Ishte ky një investim, i pari në llojin e tij, jo vetëm në Maqëllarë, jo vetëm në Dibër, por aq sa dimë ne dhe në Shqipëri.

Në vitin e dytë, fidanët ishin më të shëndetshëm. Ata lulëzuan që në fund të marsit dhe u futën që të gjithë në prodhim. Shumë prej njerëzve që udhëtonin për në doganën e Bllatës, apo që vinin prej andej, ndaleshin për pak kohë të mrekulluar nga pamja. Disa që kishin ndonjë aparat të mirë fotografik, nuk nguronin të merrnin një pamje si kujtim, apo me idenë për ta kultivuar dhe vetë, këtë bimë të re, të panjohur më parë. Në shtator të vitit të dytë, Zijai mori pesë kuintalë frut të njomë, ose 1,5 kuintalë masë e thatë.

PAULONIA

Trupi me përmasa të habitshme i kësaj bime, rritja e shpejtë, gjethet gjigante, cilësia e lartë e dërrasës, nuk mund të mos tërhiqnin vëmendjen e Zija Keshit, fermerit të ri të pasionuar, nga Maqëllara e Dibrës. Meqë ishte në tratativa me firmën serbe, porositi njëqind fidana të kësaj bime, për ti shtuar me treqind të tjerë, vitin që kaloi. Kjo gjë nuk ishte krejt e re, pasi në Shkodër, apo dhe në disa zona të tjera, kishte fermerë që ishin njohur e miqësuar me këtë kulturë. Në Dibër ka mbjellë një hektar Qamil Lata, kurse këtë vit, Hajrulla Nikolli, Jahe Ashiku e disa të tjerë, duan ti shtojnë dhe disa hektarë të tjerë, fondit pyjor të rrethit tonë.

Fidanët u mbollën në distancat katër me pesë metra dhe vaditeshin me pika njëherë në javë. Tani, në krye të dy viteve, fidanat janë bërë mbi tetë metër lartësi dhe 20 centimetër, diametri i trungut. Në krye të pesë viteve, Zijai mendon të presë fidanat, duke shpresuar të përfitojë mbi një metër kub dërrasë, nga çdo fidan i këtij druri të shtrenjtë princëror. Vetëm katërqind fidanët që ka mbjellë, mund ti japin një përfitim prej jo më pak se 100 milionë lekësh. Zijai thotë se Paulonia është një investim, të paktën 40 vjeçar dhe pas çdo pesë vjet prerje lihet një filiz i drejtë, për të formuar drurin e ri, që do të pritet pas pesë vitesh të tjerë. Kështu, me shumë pak investime të mëvonshme, fermeri do të ketë përfitime të mëdha. Liridoni, një miku im nga Presheva, që njihet si kultivues e prodhues i madh i fidanëve të kësaj bime, bënte apel, që në vend të hashashit "harram", të mbjellim Paulonian, si bimë "hallall" e gati me të njëjtën normë fitimi dhe interesi.

Mendova se Zijai i kishte mbaruar eksperimentet dhe i kishte vënë piketat për të ardhmen. Do tu bënte shërbim Aronias dhe Paulonias dhe aq. Me të jemi miq të vjetër dhe një ditë isha te shtëpia e tij për vizitë. Aty në hyrje të oborrit, pashë ca vazo me ca bimë të mbjella në ta, që tani në dimër dukeshin si të thara. Miku im nuk më la gjatë të mendohesha. - Kanë ardhur nga Kina, - më tha. - M'i rekomandoi një specialist në Tiranë. - Quhet Xhoi, një bimë e re, shumë interesante. Ka një frut shumë të bukur e të shtrenjtë, kurse druri jeton mbi 25 vjet. Një fidan prej tyre kushtonte 22 mijë lekë, por unë e dija, që kur atij i pëlqen diçka, nuk do të ndalej dhe po të ishte dhjetë herë më e shtrenjtë, apo dhe po ti duhej ti merrte fidanat në Kinë. Ai është i sigurtë se do t'ua shohë hajrin këtyre investimeve. Shumë shpejt ai mund të shesë dhe fidana, të cilat që këtë vit i ka të gatshëm për këtë destinacion.

Ndonjëherë, Zijai mërzitet nga pak. Mërzitet se nuk ka subvencione nga qeveria për këtë kategori bimësh. Mërzitet se tregu shqiptar nuk i njeh këto produkte të reja dhe është i pakonsoliduar. Por ai është i sigurt se do vijë një ditë që do të flasë për të. Një ditë kur të ketë tregje, kur të ketë kontrata të lidhura, brenda dhe jashtë vendit. Ne mundemi ta shpejtojmë ardhjen e kësaj dite, ndaj le të përpiqemi. Nuk do të jetë vetëm Zijai i fituar, do të jemi të gjithë.

Rruga e Arbërit nr. 129

vendlindje

Nga ky fshat kanë dalë figura të spikatura në profesione të ndryshme si mësues, pilotë, ushtarakë, biznesmenë, të cilët i kanë dhënë një ndihmë jo të vogël vendit.

Staraveci, *ballkoni i Dibrës*

Nga **Samet ZAGRADI**

Është vetëm 1.3 km larg qendrës, në pjesën veriore të qytetit të Peshkopisë, pjesë e njësisë administrative (qendër) Tomin. Një nga fshatrat më të mëdhenj të rrethit Dibër, i ndërtuar kryesisht nga familje të ardhur nga fshatrat më të thellë, duke qenë se pozitat gjeografike ishte më e favorshme për një jetesë më të mirë dhe më të lehtë. Hijerëndë qëndron sipër qytetit, si për të treguar që ky vend ka qenë bazë e shumë luftërave, ngjarjeve të rëndësishme të historisë.

Quhet ndryshe "Ballkon i Dibrës", epitet ky i marrë, duke qenë se nga aty shihet një panoramë fantastike e qytetit. Në pika të ndryshme strategjike mund të shihet çdo lagje apo pjesë të rëndësishme. Staraveci shërben edhe si urë lidhëse me qytetin, të fshatrave Bahute, Shimçan, Zimur si dhe për bjeshkët fantastike të Gramës, të cilat i shoqëron një bukuri e pashoqe. Kultura dhe tradita qëndrojnë të lidhura fort me njëra-tjetrën në këtë vend, duke e bërë që normat shoqërore, edukativo-fetare dhe tradicionale të mbeten akoma një trend. Bazat fetare myslimane respektohen pothuajse nga të gjithë, por besimtarë të devotshëm janë më të paktë në shifra.

> Quhet ndryshe "Ballkon i Dibrës", epitet ky i marrë, duke qenë se nga aty shihet një panoramë fantastike e qytetit. Në pika të ndryshme strategjike mund të shihet çdo lagje apo pjesë të rëndësishme. Staraveci shërben edhe si urë lidhëse me qytetin, të fshatrave Bahute, Shimçan, Zimur etj...

Numri i familjeve që jetojnë në fshatin Staravec ka ardhur duke u ulur, si pasojë e lëvizjes së popullsisë në zonat urbane. Rreth viteve 2000 në atë zonë jetonin rreth 170 familje, ndërsa në ditët e sotme ky numër ka rënë ndjeshëm në 120.

Nga ky fshat kanë dalë figura të spikatura në profesione të ndryshme si mësues, pilotë, ushtarakë, biznesmenë, të cilët i kanë dhënë një ndihmë jo të vogël vendit. Pjesa më e madhe e fëmijëve nga mosha 10-18 vjeç arsimohen në shkollat e qytetit, me mendimin e një arsimi më cilësor dhe më avangard.

Historia dhe njerëz të ndryshëm shprehen disi në kontradiktë për origjinën dhe historinë e këtij vendi, duke dhënë versione nga më të ndryshmet.

Emri i këtij fshati thuhet se vjen nga gjuha sllave, "Staro", një udhëheqës i madh në luftën kur vendi ishte i pushtuar serbët shumë kohë më parë. Staravec, më konkretisht "vendi i Staros". Ekonomia e këtij vendi kryesisht varet nga emigracioni, bujqësia dhe bizneset private. Ka një ekonomi jo shumë të zhvilluar, pasi edhe investimet në këtë fshat prej 20 vitesh lënë për të dëshiruar. Rruga kryesore që lidh fshatin me qytetin është një nga rrugët më të amortizuara dhe të rrezikshme të rrethit, edhe pse është një distancë mjaft e vogël. Kanalizimet, uji i pijshëm, ai vaditës dhe mungesa e vendeve për sistemimin mbeturinave janë problemet më të shumta që shqetësojnë këtë popullatë. Terreni malor i këtij fshati bën që vështirësitë e banorëve të shtohen sidomos në stinën e dimrit, pasi vështirësia për të lëvizur shtohet ndjeshëm. Transporti i njerëzve bëhet nëpërmjet fugonëve,makinave private dhe në të shumtën e rasteve edhe ne këmbë, pasi distanca nuk është shumë e madhe. Jetesa në këtë fshat nuk është edhe aq e thjeshtë: - shprehen banorët, pasi kiza ekonomike dhe papunësia e madhe nuk ka shpëtuar pa i prekur dhe ato. Ndihma ekonomike, siguruar nga shteti, nuk përmbush nevojat bazë të këtyre banorëve. E veçantë nga të gjithë vendet, ndoshta dhe në Shqipëri, janë llixhat me ujë kurativ, një vlerë mjaftë e madhe që një pjesë e madhe e tyre janë në trojet e fshatit Staravec.

Lajthia është një tjetër e veçantë e këtij fshati, pasi i gjithë mali i Staravecit është mbushur me bimën e lajthisë, produkt ky mjaftë i kërkuar dhe i konsumueshëm. Pjesa bujqësore dhe blegtorale luajnë një rol të rëndësishëm në ekonominë e këtij fshati, pasi shteti mundohet t'i mbështesë duke përdorur grante apo subvencione në ndihmë të tyre.

Molla, arra, patatja, qershia janë produktet të cilat fermeri dibran prodhon më së shumti dhe nxjerr në treg një produkt mjaft cilësor. Dhitë, delet dhe lopët janë një pjesë ndihmëse e popullatës, pasi përdoren për përdorim vetjak dhe jo vetëm.

Shumë njerëz dinë për këtë fshat e shumë të tjerë jo. Por dhe ato që dinë pak, them që kanë akoma me shumë për të mësuar rreth çdo gjëje që karakterizon Staravecin si vend.

(Vijon nga faqja 4)

OPINION

Zgjedhjet po afrojnë, na sillni Erjonin deputet!

"Ky është super projekti, - shkruan ai në FB, duke folur për kanalet vaditëse e kulluese që po vishen me beton. Divjaka përfiton e gjitha, me të gjitha njësitë. Madje brenda në Divjakë, projekti është risi - me rrjet tubash nën tokë. Eleminohen puset kudo, merr fund rreziku i kripëzimit që po afrohej frikshëm. Sa kam luftuar për këtë projekt dhe vetëm tani, kur shoh kanalet të pastrohen e të vishen me beton, kuptoj sa mirë kam bërë".

Në një postim tjetër, ai ka hedhur një video që bashkë me drejtues të tjerë lokalë inspektojnë rrugën e re, që ai e quan "Unaza bujqësore e Myzeqesë".

"40 km mes për mes fushave, bashkon parcelat bujqësore dhe bën më të lehtë prodhimin, grumbullimin dhe eksportin e produkteve bujqësore. Lidh Mërtishin me Ferrasin, Grabianin, Tre Urat, Çerme Sektor, autostradën ku është vendosur pika më e madhe e grumbullimit në Lushnje dhe, në krahun tjetër, Stravecin, Germenjin për të zbritur në Divjakë" - shkruan Erjoni me 27 janar.

"Për herë të parë që nga ndërtimi i shkollës para 50 vitesh, në Kemishtaj, gjimnazi i ri do të ketë edhe sistemin e ngrohjes", - shkruan ai duke publikuar një foto të gjimnazit.

"Superunazëë" e quan ai rrugën prej 40 km që nxjerr në treg me prodhimet e tyre çdo pëllëmbë tokë në Divjakë dhe bën të mundur bashkimin e dy tregjeve të mëdha bujqësore, atë të Divjakës dhe Lushnjës, por edhe të kapet në një kohë shumë të shpejtë plazhet e Divjakës.

"Një vit me parë, banorët e Gradishtës dhe Spolatës, as që më dëgjuan kur ju thashë do bëjmë rrugën tuaj. Mbase bëra unë gabim kur u thashë se, po bëjmë lugjet në disa kanale vaditëse, po bëjmë linjën e re te energjisë dhe, në fund, rrugën", - shkruante atë kohë në profilin e tij Erjon Braçe. "Një rrugë të cilën unë dhe banorët e bënim një vit më parë për një orë, tani e përshkojmë për 12 minuta".

* * *

Kur lexon pak nga këto postime, mes shumë të tjerash, kupton se sa keq ndjehesh për mungesën e përfaqësimit të Dibrës. Sepse Divjaka ka 1 deputet dhe të duket sikur gjithë qeveria punon për të. Ndërsa Dibra kishte tre deputete të PS, 14 në Parlament dhe dy ministra, por sa pak është punuar për të.

Çdo ditë që afrojnë zgjedhjet profilet e deputetëve dhe kandidatëve do të riaktivizohen: dikush më aktiv e më profesional e dikush i dobët e me gabime, por sidoqoftë, sado që të përpiqen, Erjonin nuk e kapin dot. Sepse Erjoni ka qenë katër vite me radhë pranë lushnjarëve dhe banorëve të Divjakës, ndërsa dibranët kanë qenë të braktisur...

Ndaj, na sillni Erjonin! Ndoshta pas saj nuk do të vijnë investimet si në Divjakë, por së paku do të ndjehemi se nuk jemi të harruar!

B.KAROSHI

reportazh

Familjarët e viktimave dhe sindikatat e minatorëve ankohen se autoritetet po fajësojnë viktimat për aksidentet vdekjeprurëse në miniera, duke shmangur përgjegjësitë penale të kompanive.

Vdekjet e minatorëve në galeritë e kromit mbeten të pandëshkuara

Nga **Manjola TERSHANA**

Leonard Shabani vinte nga një familje minatorësh. I ati kishte punuar për 30 vjet me radhë në galeritë e kromit në Bulqizë, ndërsa 28 vjeçari ndoqi rrugën e tij deri ditën e aksidentit vdekjeprurës.

Leonardi e kishte parandjerë fatkeqësinë, përpara se të humbte jetën më 27 nëntor 2014, i shtypur nga një masiv shkëmbor në bllokun D të minierës së Bulqizës.

"Nanë- më thoshte, po iki po nuk dihet nëse kthehem i gjallë," kujton Selvije Shabani, e ëma e minatorit të vdekur.

Selvija, - thotë se Leonardi punonte në një sektor që konsiderohej i rrezikshëm.

Dy vjet më parë, në të njëjtin zonë të minierës pati humbur jetën dhe një minator tjetër, Dilaver Koçi, dhe sipas Selvijes, firma që e menaxhonte galerinë nuk kishte bërë investime për të shmangur tragjedi të tjera.

Për vdekjen e Shabanit dhe plagosjen e rënda të një tjetër minatori, Ramiz Xhufi, Prokuroria e Dibrës ka marrë të pandehur brigadierin e turnit në kompaninë minerare ku ato punonin, Hajdar Celmetën, i cili akuzohet për "shkeljen e rregullave të mbrojtjes në punë."

Megjithatë, familjarët e Shabanit shprehen se për kushtet që çuan në shembjen e galerisë është përgjegjëse firma, e cila sipas tyre ka paguar para nën dorë për të shpëtuar nga përgjegjësia penale, e cila nuk mund të qëndrojë vetëm mbi shpatullat e Celmetës.

"Firma ka dhënë lekë e prandaj i kanë mbyllur të gjitha letrat siç donin vetë," thotë Selvije Shabani.

Selvija shton se kompania ku Leonardi punonte ka tentuar gjithashtu të blejë heshtjen e familjes, por ata kanë refuzuar pajtimin me drejtuesit e saj.

"Nuk mund të shkelnim mbi jetën e djalit tonë me disa milionë të ofruara nën dorë nga firma," shprehet Selvija.

"Ne duam drejtësi dhe për këtë do të luftojmë deri në fund. Duam që përgjegjësit e kësaj tragjedie të vihen para bankës së të akuzuarve," shtoi ajo.

Vdekja e Leonard Shabanit nuk është një rast i izoluar. Vlerësohet së në 10 vitet e fundit afërsisht 300 minatorë kanë humbur jetën në minierat shqiptare.

Viti 2007 dhe 2010 konsiderohen si vitet më të rënda për sa i përket aksidenteve në punë gjatë dekadës së fundit. Vetëm në këto dy vite numërohen 32 raste aksidentesh me pasojë humbjen e jetës në vendin e punës në minierë.

Megjithatë, edhe viti 2014 do të shënonte një rekord tjetër tragjik, kur vetëm në një ditë humbën jetën 7 persona në minierën e Beragozhdit në Pogradec.

Punonjëse të minierës së Bulqizës, duke seleksionuar kromin. Foto: ©Gj.Erebara/reporter.al

Viti 2007 dhe 2010 konsiderohen si vitet më të rënda për sa i përket aksidenteve në punë gjatë dekadës së fundit. Vetëm në këto dy vite numërohen 32 raste aksidentesh me pasojë humbjen e jetës në vendin e punës në minierë.

"Firma ka dhënë lekë e prandaj i kanë mbyllur të gjitha letrat siç donin vetë," thotë Selvije Shabani.

Sipas Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, ISHPSH, shkaqet kryesore të aksidenteve në miniera vijnë si pasojë e shembjes së galerive, shpërthimit të minave, moszbatimit të rregullave të sigurimit teknik, pakujdesi nga punëmarrësit apo shkarjet e dheut.

Përgjegjësja e sektorit të Sigurisë në Punë pranë ISHPSH, Irena Gjoka shprehet se gjatë viteve të fundit është rritur numri i aksidenteve dhe i vdekshmërisë në sektorin e minierave.

Që nga viti 2014 e deri në prill të vitit 2015 rezulton se aksidentet me pasojë vdekjen kanë ndodhur në miniera të licencuara. Nuk është regjistruar asnjë aksident në firma të palicencuara.

Për shkak të aksidenteve në punë, nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore janë vendosur masa administrative me gjobë në 8 subjekte ku kanë ndodhur aksidentet, me vlerën 7,720,000 lekë.

Megjithatë, sipas ligjit të vitit 2001 "Për sigurinë në punë në veprimtarinë minerare" institucioni përgjegjës që siguron zbatimin e dispozitave ligjore e akteve nënligjore në veprimtaritë minerare në Republikën e Shqipërisë nuk është Inspektorati i Punës, por Reparti Inspektim dhe Shpëtim Miniera, RISHMI.

Kjo, sipas përfaqësueseve të sindikatave të minatorëve ka krijuar një konflikt interesi në rastin e aksidenteve në miniera, pasi RISHMI në të shumtën e rasteve fajëson viktimat për aksidentet që ndodhin.

Kryetari i Konfederatës së Sindikatës së Industrisë, Tafë Koleci thotë se RISHMI ligjërisht ka për detyrë të garantojë punën nën tokë dhe për këtë arsye, nuk ka sesi po ky institucion të kryejë dhe inspektimet dhe raportet teknike të rasteve të aksidenteve.

"Nuk mundet RISHMI të kontrollojë vetveten," thotë Koleci. "Kontrollin në nëntokë duhet ta bëjë Inspektorati i Punës," shtoi ai.

Sipas Kolecit, për shkeljet e rregullave të punës në miniera prokuroria vihet në veprim vetëm pasi aksidentet ndodhin dhe RISHMI dorëzon pranë organit të akuzës raportin teknik.

Nga ana tjetër, prokuroria vetë nuk ka asnjë ekspert minierash, gjë që e detyron organin e akuzës të marrë për të mirëqenë vetëm raportin e paraqitur nga RISHMI.

Njësoj si Koleci, familja e Leonard Shabanit hedh dyshime mbi raportet e RISHMI-t, duke nënvizuar se në rastin e vdekjes së djalit të tyre, inspektorët nuk erdhën kurrë për t'i intervistuar.

"Ata nuk erdhën njëherë të kontaktonin me ne familjarët, por e hartuan raportin që faji të binte mbi Leonardin," shprehet Selvije Shabani.

"Firma i ka dhënë lekë RISHMI-t e kjo punë është mbyll…burri im kot shkon javë për javë me taku gjykatësit e prokurorët," shtoi ajo.

Minatorë të minierës së Bulqizës, duke punuar në galeri. Foto: © Gj.Erebara/reporter.al

Njësoj si në rastin e Leonardit, edhe vdekja e Mariana Rushitit në 19 Qershor të vitit 2010 është vlerësuar nga RISHMI si rrjedhojë e pakujdesisë së viktimës.

Nëna e divorcuar e tetë fëmijëve humbi jetën pas një manovre të gabuar të një fadrome në një fushë ku po mblidhte krom.

Flutura, vajza e saj e madhe që sot është 30-vjeç dhe kujdeset për fëmijët më të vegjël shprehet se pas aksidentit, përfaqësuesit e firmës i kanë thënë se 'faji ka qenë i Marjanës, e cila i ka dalë përpara fadromës.'

Ashtu si Marinana Rushiti edhe Leonardi ka lënë pas një vajzë pesë vjeçare dhe të shoqen e ve, që mbijetojnë falë një pensioni prej 20 mijë lekësh.

"Ata [firma] vazhdojnë jetën për qejf, s'kanë nga çojnë lekët, ndërsa ne jemi për bukën e gojës e me lotët në sy për djalin që humbëm," thotë Selvije Shabani.

"Të paktën të vihet drejtësia në vend…kaq kërkojmë," shtoi ajo.

© *reporter.al*

Në galeritë e kromit në minierën e Bulqizës. Foto: © Gj.Erebara / reporter.al

Rruga e Arbërit nr. 129

profil

Mehdi Cani ishte organizator i talentuar që nga dita e parë kur veshi bluzën e bardhë më 1958 në spitalin e Bulqizës e deri ditën kur e hoqi atë.

Mehdi Cani, **figurë e shquar** e mjekësisë dibrane dhe asaj kombëtare

Nga Prof. As. **Nazmi KOÇI**

Shërbimi shëndetësor i rrethit të Dibrës para Luftës së Dytë Botërore, po të mos merret parasysh dërgimi i ndonjë mjeku për fushata të ndryshme pranë Bashkisë apo ndonjë mjeku që bënte pjesë në formacionet ushtarake që kalonin në këto anë, ishte pothuajse inekzistent.

Pas çlirimit të vendit në Dibër filluan të vijnë mjekë stabël nga rrethet e tjera, si: Hysni Rusi, Koço Poro, Lame Koci, Lona Toptani (n/mjeke), që merrej me problemet e kirugjisë dhe obstetrikë gjinekologjisë etj.

Pas mesit të viteve '50, në Dibër filluan të vijnë mjekët e parë dibranë të diplomuar në Fakultetin e Mjekësisë në Tiranë, si: Mehdi Cani, Ahmet Alliu, Lahim Puca, Ahmet Kamberi e më pas numri i tyre erdhi duke u shtuar vazhdimisht.

Dibra pati dhe ka personalitete të shquara të fushës së Mjekësisë. Midis nesh militoi për disa dekada, kirurgu me duar të arta Irfan Jashari, okulisti i famshëm Basri Neziri, mjeku obstetër gjinekolog Rahim Xhika, kardiologu i përmasave europiane Ahmet Kamberi, patologu me aftësi të jashtëzakonshme Qemai Cadri, specialisti balneolog Enver Shehu, kardiokirurgu i famshëm Veli Zogu, shkencëtari erudit Ali Sula, otojatri Muhamet Kodra e shumë personalitete të tjerë të shquar jo vetëm brenda rrethit, por edhe në shkallë kombëtare e më gjerë.

Në qoftë se shërbimin shëndetësor të rrethit të Dibrës do ta krahasonim me një piramidë të Egjiptit, ndërtuar nga faraonët e lashtë, këta mjekë të shquar ishin ata blloqet e rëndë që zunë vend në muret e saj dhe i dhanë bukuri e jetëgjatësi që brezat ta shijojnë e të mrekullohen me të. Por nuk ka diskutim se ai blloku më i rëndë që mbyllte majën e piramidës, që e lartësonte dhe e mbante atë në ekuilibër shekullor, ishte pa diskutim kolegu ynë i paharruar Prof. Dr. Mehdi Cani.

I ndodhur vetëm një dekadë pas këtyre personaliteteve dhe sidomos shefit të nderuar të Shëndetësisë të asaj kohe, pata fatin e madh të jem pranë tyre si një ushtar i ri në fund të rreshtit, por që e sheh mirë efektivin e togës dhe që e dallon po ashtu mirë aktivitetin e secilit. Me këtë cilësi, si bashkëkohës dhe koleg, si vartës dhe si mik, dua të paraqes disa mendime të miat për figurën dhe kontributin e tij, që, siç e kam thënë në një takim kur isha drejtues i shëndetësisë së rrethit, ishte më i miri midis nesh, Prof. Dr. Mehdi Canin, për atë që me shumë mirënjohje Dibra e ka nderuar me titullin e lartë "Qytetar nderi i Qarkut Dibër".

E kam obligim personal e qytetar që të them disa fjalë për intelektualin e shquar dhe njeriun fisnik Mehdi Cani, shefin tim shumë të respektuar të atyre viteve.

Dr. Mehdi Cani (me këtë emër e ka njohur populli i Dibrës, pavarësisht titujve e gradave që ai fitoi më vonë), lindi në Zerqan të Dibrës me 4 shkurt të vitit 1936.

Ai kreu shkollën fillore dhe 7 vjeçare në fshatin e tij, me rezultate të shkëlqyera. Më pas u dërgua për të vazhduar studimet në Politeknikumin mjekësor në Tiranë, të cilin e përfundoi gjithashtu me rezultate të shkëlqyera. Pa asnjë diskutim ju dha e drejta e studimeve të larta dhe vazhdoi Fakultetin e Mjekësisë në Tiranë në vitet 1953- 1958. Në vitin 1958 ai u diplomua shkëlqyeshëm dhe emri i tij u fut në librin e artë të Universitetit të Tiranës. Me një bagazh të bollshëm teorik, por dhe me eksperiencë praktike, pasi ai që student ishte ftuar dhe kishte punuar në disa Klinika të Fakultetit, u dërgua që të punonte në rrethin e Dibrës, fillimisht në spitalin e Bulqizës. Ishte i shkëlqyer në të gjitha ciklet e arsimit ku studioi e po ashtu mbeti edhe në praktikë, në jetë. Edhe studentët e tjerë zerqanas ishin me rezultate të mira gjatë studimeve.

Në vitin 1967, autoritetet e kohës e ndëshkuan Mësuesin e popullit, figurën legjendare të arsimit dibran, Selim Alliu, me arsyetimin se nuk kishte bërë politikë të drejtë arsimore dhe se kishte dërguar shumë studentë në Fakultetin e Mjekësise dhe kishte përgatitur shumë mjekë në Zerqan. Dhe i nderuari Selim Alliu përfundoi mësues në Shupenzë, atje ku më vonë pata fatin të punoja mbi 15 vjet edhe unë. Në të vërtetë faji nuk ishte i shefit të Arsimit. Fajin e kishin zerqanasit që studionin shumë dhe përzgjidheshin për meritat e tyre. Në Fakultetin e Mjekësisë studiova edhe unë nga Okshtuni, edhe Qemal Cadri nga Trebishti, edhe Preng Doci nga Lura, Shefqet Domi nga Kalaja e Dodës, Myslym Cami nga Viçishti, Azis e Ferit Ndregjoni nga Selishta e shumë të tjerë nga të katër anët e Dibrës. Një fakt domethënës është se Zerqani ka sot 4 Prof. Dr. të fushës së Mjekësisë,

shifër kjo që do ta kishin zili disa rrethe të vendit dhe ndoshta është kështu fshati i vetëm në vend me një tregues të tillë.

Dr. Mehdi Cani e filloi detyrën në spitalin e Bulqizës ku punoi si mjek dhe drejtor i spitalit. Spikaten aftësitë e tij profesionale e menaxheriale dhe në vitin 1960 u transferua në spitalin e Peshkopisë, ku shërbeu deri në vitin 1965 si shef i repartit të infektivit dhe drejtor i spitalit "Stefan Luarasi" në Peshkopi. Në vitet 1965 deri 1976 mjeku i nderuar Mehdi Cani do të ishte shef i seksionit të shëndetësisë pranë Kom. Ekz. të rrethit, ku kreu me dinjitet edhe disa detyra shoqërore të ndërlikuara për kohën.

Gjatë drejtimit të shërbimit shëndetësor të rrethit të Dibrës nga Dr. Mehdi Cani, ky shërbim shënoi zhvillim e transformime të mëdha. U hapën specialitete e shërbime të reja, u shtua me ritme të shpejta personeli shëndetësor, sidomos numri i mjekëve. U bënë ndërtime të tilla si spitali i Peshkopisë, spitali i Bulqizës, hoteli i llixhave dhe filloi ndërtimi i kompleksit modern balnear që kemi sot, u hapën spitale e maternitete në të gjithë rrethin.

Si dëshmitar i kohës po qëndroj pak te spitali i Peshkopisë që aso kohe u quajt vepër e parakohshme dhe u bënë kritika për shpenzimet e mëdha që i ishin bërë buxhetit të shtetit. Detyra e projektimit për atë spital u hartua nga Dr. Mehdi Cani. Ishte ai që loboi të nxirreshin fondet, të ndërtohej shpejt dhe me cilësi të lartë kjo vepër që e patën zili edhe rrethe të mëdha si Shkodra, Korça, Elbasani, Durrësi bile edhe Tirana. Spitali u inaugurua në vitin 1974. Unë isha i pranishëm në këtë ceremoni. Disa nga mjekët e Peshkopisë munguan në këtë aktivitet, disa të tjerë ishin midis njerëzve në shesh. Përkrah figurave shumë të rëndësishme politike të kohës në tribunë ishte Mehdi Cani. Ai mbajti edhe fjalën e rastit në këtë eveniment, pasi kishte harxhuar shumë mund e kohë për ndërtimin e tij. Dua të jem i qartë në këtë pikë. Të gjithë ne që erdhëm pas tij bëmë retushe, vumë kangjella e mbollëm lule, por spitalin na e la të ndërtuar Mehdi Cani.

Në vitin 1976 Dr. Mehdiu u transferua në Tiranë, ku punoi në Klinikën Universitare të sëmundjeve infektive. Për një periudhë 10 vjeçare, gjatë viteve 1982-1992, ai ishte drejtor i spitalit infektiv të Tiranës, ku mjekoheshin të gjithë rastet e rënda që grumbulloheshin nga e gjithë Republika për trajtim të specializuar në spitalin qendror. U vendos në elitën e mjekësisë shqiptare. Për 30 vjet me radhë ishte pedagog i Fakultetit të Mjekësisë dhe më pas edhe atij të Infermierisë. Ishte specializuar më parë (1967) për sëmundjet infektive, bëri dhe një specializim të dytë në neurologji. Specialist i klasit të të parë ai u bë një autoritet i padiskutueshëm shkencor. Kur konsulta e spitalit kalonte për të parë të sëmurët rëndë, kishte raste që ata që referonin të shpreheshin: "Këtë rast e ka parë Mehdi Cani" dhe të gjithë profesorët me emër do të shpreheshin: "Le të vazhdojë mjekimin që ka thënë doktori, nuk ka nevojë për konsultë".

Mjeku i nderuar dibran i ngjiti shkallët e karrierës me shpejtësi. Në vitin 1985 mbrojti Disertacionin me temë: "Mbi meningitet për periudhën 1976-1985 në Shqipëri" me të cilin mori titullin "Doktor i Shkencave Mjekësore" dhe më pas titujt e tjerë akademikë që vijojnë. Tirana është një test për mjekët që vijnë nga rrethet. Askush më mirë e më shpejt se ai nuk e përballoi me sukses këtë test. Mori pjesë në kongrese e simpoziume ndërkombëtare si në Austri, Kroaci, Hungari, Itali, etj., ku referoi e dha eksperiencën e tij. Bëri shumë studime dhe publikoi mbi 100 punime shkencore brenda e jashtë vendit, ku trajtoi kryesisht temën mbi neuroinfeksionet. Është autor i librit të sëmundjeve infektive që përdoret edhe sot në Fakultetin e Mjekësisë dhe atë të Infermierisë.

Ai ishte një profesionist i zoti. Nga askush dhe asnjëherë nuk është vënë në diskutim një fakt i tillë edhe pse ka pasur rastin të punojë me figurat më të shquara të mjekësisë shqiptare të atij sektori si: Nikolla Dushniku, Kristo Pano, Elmaz Altari e shumë të tjerë.

Mehdi Cani ishte organizator i talentuar që nga dita e parë kur veshi bluzën e bardhë më 1958 në spitalin e Bulqizës e deri ditën kur e hoqi atë. Ai ishte i tillë se kurrë nuk shau e as ofendoi njeri. Ishte i tillë, sepse në çdo punë printe vetë. Ai të bënte të të vinte zor me edukatën e tij, pa të thënë asnjë fjalë. Kur ishte shef i seksionit të shëndetësisë në Dibër, një herë e kritikuan për butësi dhe se nuk kishte marrë asnjë masë ndëshkuese ndaj vartësve. Doktori i mençur u përgjigj: "Përse duhet të marr masa, a nuk mjafton shembulli im personal që i frymëzon bashkëpunëtorët e mi. Nëse ky nuk mjafton, merrni ju masa për mua. Unë bashkëpunëtorët i kam të shenjtë, dua t'i mësoj e t'i frymëzoj, jo t'i ndëshkoj e sundoj ata." Këtë fakt kam pasur rast ta njoh nga afër edhe unë dhe i jam shumë mirënjohës, pasi më ndihmoi të ec përpara në jetë pa cenuar asnjëherë dinjitetin tim, bile të askujt.

Ai ishte një shok i mirë. Dinte të dëgjonte e respektonte këdo, sidomos ne mjekët e rinj. Me të mund të bisedoje për punën, por jo vetëm, edhe për hallet a shqetësimet që ne kishim. Duke qenë se unë e kisha familjen jashtë rrethit, asnjëherë nuk pata nevojë të merrja udhët e të shkoja atje për t'u konsultuar me vëllanë e madh apo prindërit. Këtë vend me shumë njerzi e zuri ai, kolegu dhe shefi im. Këshillat e tij vllazërore më rezultuan gjithmonë të pastra e të sinqerta. Përjetësisht i jam mirënjohës edhe për këtë. Ai ishte i tillë me të gjithë.

Mehdi Cani ishte një qytetar model dhe njeri me moral të lartë me tërë dimensionin që përmban kjo fjalë. Ai nuk u gjykua e nuk u përgojua kurrë, pasi ai qe një margaritar midis nesh. Një herë, kur një pacient i futi në xhepin e bluzës një 50 lekësh të asaj kohe, mjeku i nderuar, pasi mbaroi ditën e punës, nxori nga kartela adresën e pacientit, shkoi në postë, bleu një zarf dhe ia postoi pacientit në Zalldardhë. Pa huqe e pa vese, njeri i dlirë, ai do të respektohej nga të gjithë.

Humanizmi dhe dashuria e tij për njerëzit, veçanërisht për pacientët ishin të pakufishme. Nuk kam kohë të sjell shembuj për këtë në këto pak radhë, por mund të them se ai i adhuronte njerëzit, të sëmurët, bashkëpunëtorët, të afërmit dhe familjen. Mehdi Cani ishte shembulli më i mirë i mundshëm për qëndrimin njerëzor ndaj të tjerëve. Me atë buzëqeshjen e tij disi hyjnore, ai do të bënte për vete këdo, ndaj dhe mjekimi e shkenca e tij në dobi të njerëzve do të ishin aq efektivë e të dëshiruara nga çdokush.

Dua të rrok edhe një dimension tjetër njerëzor të mjekut të nderuar dibran, Mehdi Cani. Atë të raportit të tij me Dibrën e dibranët, pasi u largua në Tiranë. Të sëmurët, studentët, qytetarët edhe për probleme jo mjekësore, do t'i drejtoheshin për ndihmë atij. Dhe ai nuk do të mungonte asnjëherë ta jepte atë me gjithë gatishmërinë e dashamirësinë e mundshme. Të gjithë mundohemi të bëjmë diçka në këtë drejtim, por askush prej nesh nuk është në nivelin e tij.

Dr. Mehdiu ishte dhe një familjar i devotshëm. Ai së bashku me bashkëshorten e tij znj. Tefta Cami rritën e edukuan tri vajza shembullore: Ildën, Almën dhe Brikenën. Alma, është mjeke e pedagoge e afirmuar, Profesore e asociuar, shefe e Reanimacionit në spitalin e sëmundjeve pulmonare "Shefqet Ndroqi" në Tiranë, derë e hapur për çdo dibran që ka nevojë për të. E thërrasin të gjithë dibranët, por jo vetëm ata, Alma e Mehdiut. Ndjej admirim si për vajzën time kur dëgjoj të thonë: "I kishte ngjarë plotësisht të atit. Mehdi Cani është gjalle!"

Puna dhe vepra e Mehdi Canit janë vlerësuar ndër vite e në vazhdimësi. Edhe vendimi i tanishëm i Këshillit flet për këtë gjë. Është dekoruar me disa Urdhra e Medalje si mjek i shquar. Ka marrë titullin "Punonjës i shquar i shkencës dhe i teknikës" me Dekretin Nr. 7336, datë 13.11.1989 të Kuvendit Popullor me motivacionin: "Për kontributin e dhënë në ngritjen e shërbimit të neuroinfeksionit në vend, për përcaktimin e kritereve të drejta shkencore në mjekimin e meningiteve e për ndihmesën e dhënë në kualifikimin e përgatitjen pasuniversitare të kuadrit në këtë shërbim". Me Dekretin 6872, datë 27.03.1984 të Kuvendit Popullor i është dhënë Urdhri "Për shërbim të mirë popullit". Ai vazhdoi të ngjitet e fluturojë gjithmonë drejt lartësive, derisa një ditë të vitit 2006 u ngjit lart në qiell dhe u nda prej nesh.

Personaliteti ynë i dashur Mehdi Cani është vlerësuar si klinicist, si pedagog e njeri shembullor. Ai bën pjesë në listën e 100 mjekëve të shquar të shekullit, të atyre mjekëve të famshëm që: "Kanë shpëtuar jetë njerëzish dhe janë kthyer në heronj pa titull, që kanë themeluar e kanë promovuar pavione e spitale anembanë vendit për vite, dekada e deri një shekull". Një motivacion shumë i denjë për heroin tonë. Kjo i bën nder atij personalisht, ne miqve e të afërmve të tij, i bën nder familjes, Dibrës mbarë. Prandaj mendoj se Dibra ia kishte borxh një titull nderi këtij biri të denjë të saj, që e ka nderuar vazhdimisht atë. Është rasti të falënderoj Shoqatën e Intelektualëve Dibranë me qendër në Tiranë, e cila e sugjeroi dhe e votoi unanimisht propozimin për t'i akorduar Profesorit të nderuar Mehdi Cani titullin e lartë "Qytetar nderi i Qarkut Dibër". Sigurisht, një falënderim i veçantë shkon edhe për drejtuesit e shërbimit shëndetësor, Këshillin e Qarkut, kryetarin e tij dhe të gjithë ata që e votuan këtë propozim.

Figura multidimensionale e Mehdi Canit meriton të nderohet më tej e vazhdimisht. Emri i tij është i denjë për të mbajtur rrugë, shkolla, spitale e institucione të tjera, bile me shumë dinjitet.

Meqenëse jemi në këtë pikë do të shprehja mendimin tim se vendosja e këtyre emërtimeve nuk duhet të jetë çështje lobimesh, çështje fisi, fshati apo krahinë e veças çështje korentesh politike që anojnë herë majtas e herë djathtas. Kjo çështje që i përket sidomos të ardhmes, duhet të jetë së pari çështje kontributesh, vlerash dhe të përcaktohet pas diskutimeve të kujdesshme në sektorin ku ka punuar secili, me kolegë e qytetarë që i kanë njohur e punuar bashkërisht dhe pas konsultave të tilla të merren vendime që nuk i konteston askush, së paku shumica e shoqërisë. Bie fjala nëse do të vendoset një emër në shërbimin balnear të Peshkopisë ma do mendja se askush nuk do të kontestonte se ky emër i përket mjekut të nderuar që e themeloi atë, Dr. Enver Shehut. Po kështu, do të thoja nëse do të emërtohet shërbimi i Obstetrikë Gjinekologjisë së rrethit tonë, pa dyshim ky nder i takon themeluesit të tij, Dr. Rahim Gjika. Duke qenë kolegu dhe miku i përbashkët i tyre nuk kam preferenca e as subjektivitet në asnjë rast, por besoj se kështu do të mendonin edhe shumica e atyre që kanë punuar e jetuar me ta.

Për kolegun Mehdi Cani duhet të bëhet më shumë, më shumë shkrime e monografi si shembulli i njeriut të mirë që edukon e frymëzon brezat, gjithë shoqërinë. Prandaj në hyrje të këtyre radhëve e quajta si atë bllokun e madh që qëndron në krye të piramidës së shërbimit shëndetësor dibran e kombëtar, që e lartëson këtë piramidë, e bën jetëgjatë e të lavdishme në shekuj, ndërsa ne qëndrojmë në shesh dhe sodisim madhështinë e saj, më saktë madhështinë e tij.

Ndjehem krenar që pata fatin të jetoj e të punoj në një epokë me Mehdi Canin, me një njeri të madh si ai, jam krenar që isha vartësi, kolegu dhe miku i tij.

portret

Një mjedis me një emër domethënës "Tradita Geg&Tosk", shkurt "Tradita", siç e thërresin në Shkodër... mbi të gjitha me një muze vlerash etnografike, reliktesh nga e gjithë Shqipëria...

Gjon Dugilaj
shkodrani që dashuron DIBRËN

Bisedoi: **ABDURAHIM ASHIKU**

Një mjedis i veçantë që kishte hapur portat për mysafirë të rrallë, mësues e mësuese të ardhur që nga kufiri polar e deri nga ultësirat e Egjeut, mësues që vullnetarisht (!) pa asnjë stimul moral e material, kanë vendosur të sfidojnë kohën, të bëjnë atë që bënë Rilindësit e Kombit, tu mësojnë fëmijëve të mërgimtarëve të flasin, shkruajnë e këndojnë shqip.

Një mjedis me një emër domethënës "Tradita Geg&Tosk", shkurt "Tradita" siç e thërresin në Shkodër: me dhoma hoteli, restorant, bufe, por mbi të gjitha me një muze vlerash etnografike, reliktesh nga e gjithë Shqipëria...

Ndërsa përgatiteshim për udhëtimin e lamtumirës u takova me pronarin e kompleksit, me z.Gjon Dugilaj. Kur iu prezantova si dibran i qeshi fytyra. U ula për të marrë me vete zërin e tij...

Unë quhem Gjon Dugilaj. Jam apasionant dhe koleksionist i etnografisë shqiptare. Një prej pasioneve të mija ka qenë për t'i mbledhë kostumet dhe për t'i ruajt në një ditë shprese që të kem një nga muzetë më të mëdhenj në Shqipëri dhe padyshim më të madhin në Veri.

Nuk është vetëm pasioni për t'i mbledhë, është edhe pasioni për t'i njohtë në dizajn, për ta dijtë se ku dhe si erdhën këta dizajn deri në ditë të sodit, si njerëzit arritën për t'i ruajt këta dizajn, si i trashëguan nga brezi në brez.

Kam dy vera që kaloj me ditë të tana në zonën e Dibrës, pra aty ku "Rruga e Arbrit" do të kalojë, ose ma mirë me thanë që nëntoka është më e pasur se mbi toka dhe thania e shkodranëve: "Mençuria lindi në Shkodër, kaloi nëpër Mirditë dhe pushoi në Dibër" nuk asht e pa mençme se është e gjetur.

Unë me të vërtetë nuk mundem me dallue dibranët me mirditorët. Për mue janë një racë, janë një vëlla, kanë njëmijë e njëqind gjana të përbashkëta, thjeshtë përdorin dy emra, apo më mirë me thanë kanë dy besime. Mençuria që thonë se kalue në Mirditë e në Dibër, unë them se ka pushue aty, por kufini nuk ka ekzistuar në atë kohë.

Megjithatë do të kisha dashtë me cilsue disa momente të mia në mbi tokën e Dibrës.

Për mue Zerqani mbetet një nga pasuritë ma të mëdha që etnografia dibrane ka. Reçi është një pjesë tjetër shumë interesante. Kalaja e Dodës ka interesantet e veta ku njerëzit flasin për kishat, pavarësisht se i përkasin besimit mysliman dhe çuditërisht ata tregojnë me mençuri dhe zgjuarsi tokat se ku ishin kishat.

Në shumë fshatra të tjerë të Mirditës flitet për të njëjtën gja çka do të thotë se një popull që ka kulturë, që e donë të ardhmen, ruen edhe të kaluemen, flet për të, e kujton, u thotë edhe brezave se çfarë ishim, çfarë jena dhe çfarë mund të jena.

Krahas kësaj historie dhe kësaj trashëgimie që kam jetuar në Dibër, njëkohësish mandej kam qenë i interesuem për etnografinë.

Kostumin e Zerqanit e dashuroj. Asht kostumi që mund të ketë elegancën ma të bukur që kanë femrat shqiptare. Duke pas parasysh edhe terrenin e thyem kostumi i Zerqanit asht i përshtatshëm jashtëzakonisht shumë me terrenin, njëkohësisht asht edhe shumë elegant, plus që asht i vetmi kostum shqiptar që ka njëqind për qind ngjyrat kombëtare shqiptare.

Fakti është që Dibra dhe Mirdita, për mendimin tem, janë dy zonat që kishin ma afër dhe ma pranë gjakun e Skënderbeut. E zeza dominon në shumë kostume të zonave të Dibrës çfarë do të thotë se dhimbja për Skënderbeun ishte shumë e fortë. Në qoftë se do kthehna pesëqind vjet ma para ngjyra që dominonte ishte kryesisht ngjyra e bardhë, dominonte në kostumin shqiptar. Për

Lura për mua është një shembull i jashtëzakonshëm, shumë i madh për popujt e botës jo vetëm për Shqipërinë, është një fshat i miqësuem gjys katolik dhe gjys mysliman që kalojnë në një harmoni të jashtëzakonshme. Kur shkon në Lurë të duket sikur bota fillon dhe mbaron aty.

Rruga e Arbrit" në të vërtetë nuk asht gja tjetër vetëm se një bashkim shpejtësie i Kombit Shqiptar, asht edhe nji zhvillim ekonomik...

shembull te kostumi...te kostumi (po e kujtoj ma vonë manej)

A. Ashiku. Trevës të Lurës

Gj. Dugilaj: Të Lurës po e po sepse Lura ka lidhje edhe me Veriun, tjetër gja asht interesant por i këtyre nomadëve që ishin me bagëti, si quhen.

A. Ashiku: Çobanëve...

Gj. Dugilaj: Jo të çobanëve. Kanë një emër tjetër...Luma.

A. Ashiku: Kalaja e Dodës...

Luma për shembull në përqindjen ma të madhe të kostumit dominohet nga e bardha. Këta ishin njerëz që nuk ishin gjak i afër i Skënderbeut sepse përndryshe e zeza do të merrte forcë shumë ma të madhe.

Në ato zona që e zeza mori fuqi do të thotë që gjaku ishte shumë i afërt ose lidhjet shpirtërore

ishin shumë të mëdha me Skënderbeun. Me këtë rast do të veçoj gjithmonë Mirditën por kur them Mirditë mendoj gjithmonë Dibrën dhe kur them Dibër mendoj Mirditën.

Sheherlijtë kanë finesën e kostumit që asht shumë për tu theksue se pavarësisht se moda vjen nga Perandoria Otomane shqiptarët e stilizojnë kostumin otoman sipas dëshirës dhe shijeve të veta. Pra do të thotë që edhe sot, edhe të rinjtë e sotëm e përqafojnë modën e huej, por gjithmonë e stilizojnë atë me një përshkrim të vogël të Zadrimës apo me disa damarë të Zerqanit.

Prapse prapë do të kthehem tek Zerqani.

Kostumi i Zerqanit është një kostum që përdoret shumë nga Ansambli i Shtetit. Ndoshta fakti që si lundrojnë me këtë kostum, fakti se si ngjyrat kombëtare prezantohen, fakti i elegancës të Zerqanit, them që asht një kostum shumë i veçantë që ka Dibra, plus tjetra që duhet theksue se Zerqani asht nji zonë tjetër që burrat e Dibrës takohen dhe nuk asht rastësi që ata takohen aty që asht një kryqëzim gjeografik, gjeopolitik dhe një kryqëzim edhe luftash, po asht edhe nji kryqëzim burrash. Pra ajo që them unë që Zerqani me kostumin e vet e bjen historinë e Dibrës mbrapa, them që do të jetë shumë e vërtetë. Kjo është thjesht një ndjesi që unë kam. Ndoshta ndryshe mund të jetë.

A. Ashiku: Kostumi i grave dibrane...

Gj. Dugilaj: Të grave, po. Do të them një gja. Midis burrave dhe grave shqiptare ndryshimi ishte shumë i madh. Burrat ishin të pasionuar për pazmin, gratë e bukura dhe pushkët e bukura, kurse gratë ishin të pasionuara për të qenë princesha para burrit gjithmonë. Dhe në të vërtetë energjia e burrit vjen nga gruaja çka do të thotë që burrat asnjëherë nuk ishin të interesuam shumë për të pas kostume të bukura, se bukuria e burrit ishte gruaja. Ky është ndryshimi midis nesh dhe popujve të tjerë. Edhe sot shqiptarët dojnë me pas gruan e bukur dhe makinën e mirë. Pra iku arma. Nga arma kaloj tek metali, makina, kuptohet. Atëherë ishte gruaja dhe arma e bukur, tash asht gruaja e bukur dhe makina e bukur (qeshim).

Gjithsesi do të kthehna tek strategjia e sotme, "Rruga e Arbrit" në të vërtetë nuk asht gja tjetër vetëm se një bashkim shpejtësie i Kombit Shqiptar, asht edhe nji zhvillim ekonomik. Shpresojmë që ka për tu ba shpejt.

Nuk mundemi me lanë pas dore edhe pasurinë e ujnave që Dibra ka. Flas gjithmonë për ujërat e ngrohta termale që njerëzit i andrrojnë. Njerëzit udhëtojnë me qindra kilometra për ti pa se si janë, sepse nuk i imagjinojnë se si uji mund të dalë nga toka me një temperaturë aq të lartë. Asht për tu theksue se në Dibër uji del me temperaturën që i duhet trupit, gjë që nuk ndodh në shumë vende tjera. Dibra e ka këtë pasuri shumë interesante.

Mandej Dibra ka edhe nji gja tjetër. Janë disa fshatra që janë pakicë ose ma mirë me thanë disa popuj që vijnë e instalohen në Dibër çka do të thotë se vetë dibranët ishin njerëz me shpirt të madh dhe i pranuan këta njerëz që sot flasin bullgarisht. Me thënë të vërtetën edhe kostumet e tyre janë interesante. Janë të ndërtuara pak me etnografinë shqiptare, një vlerë që tregon tolerancën e madhe të popullit tonë, ndoshta diçka edhe negative shpesh herë se jo kështu u treguan popujt e tjerë me ne, por na të paktën u treguan tolerant ndaj popujve të tjerë, si me grekët ashtu me bullgarët e Maqedonët. I vetmi popull që u tregua tolerant me ne ishin italianët se vetëm arbëreshët sot flasin shqip pas pesëqind vjetëve kurse pjesët e tjera shqiptare pothuajse jo. Humbën këto.

Dolëm pak nga tema por edhe kjo është një pjesë e bukurisë që Dibra ka. Pse në fund të fundit janë tre-katër fshatra që janë për tu theksue. Në to jetojnë në paqe, jetojnë në harmoni me pjesën tjetër të dibranëve. Kjo nuk është meritë e atyre që kanë ardhë por është tolerancë dhe zgjuarsi e këtyre që i pritën. Edhe kjo është një meritë tjetër e dibranëve.

Asht edhe një fshat tjetër atje afër Maqellarës, një fshat i vogël me ortodoksë. Një tolerancë tjetër atje që edhe ajo ka bukurinë e vet por që atje nuk kam mund me gjet asnjë kostum ortodoks që i përket zonës së Dibrës.

A. Ashiku: Përshkrimi që ju bëni lidhet me disa familje ortodokse në fshatrat Kërcisht i Epërm dhe Herbel. Po për katolikët e Lurës, për të veçantën e saj ku dy vëllezër të një nëne dhe një babe njeri është katolik e tjetri mysliman dhe pashkët e bajramin i festojnë gjithnjë bashkë keni një mendim?

Gj. Dugilaj: Në qoftë se do të kthehna tek Lura për mua Lura është një shembull i jashtëzakonshëm, shumë i madh për popujt e botës jo vetëm për Shqipërinë, është një fshat i miqësuem gjys katolik dhe gjys mysliman që kalojnë në një harmoni të jashtëzakonshme. Në të vërtetë kur shkon në Lurë të duket sikur bota fillon dhe mbaron aty. Bukuritë e saj janë tepër joshëse, jashtëzakonisht shumë, njerëzit janë shumë dashamirës, shumë mikpritës, shumë bujarë, janë të pashëm. Etnografia e tyre është e jashtëzakonshme. Interesante është për të theksuar se lurjanët festojnë festën e Shemërisë në një ditë me arbëreshet e Italisë dhe në një ditë me Hotin e Shkodrës. Ata mendojnë se janë nga Hoti. Është për tu theksue që në Lurë princër dhe mbretër kanë kalue pushimet. Ka kenë një vend shumë joshës edhe për familjet e mëdha.

Kullat e Lurës tregojnë shpirtin e ndërtuesit dhe shpirtin arkitektonik të shqiptarit, por njëkohësisht edhe shpirtin luftarak dhe atë risi që "Shtëpia jeme asht kalaja jeme". Çdo shtëpi asht një kala, megjithëse varet se si njerëzit i shohin gjanat, por të paktën me syrin tem unë kështu mendoj.

Nji gja tjetër që më ka pëlqye në Lurë asht sasia e madhe e ujit. Nji vend sot për të kenë i bekuem asht uji. Dhe bekimi fillon gjithnjë me ujin...

Kostumin e Zerqanit e dashuroj. Asht kostumi që mund të ketë elegancën ma të bukur që kanë femrat shqiptare... asht edhe shumë elegant, plus që asht i vetmi kostum shqiptar që ka njëqind për qind ngjyrat kombëtare shqiptare.

fotoreportazh

Katër MBRETËR DIBRANË në Tuz të Malit të Zi

Ata ishin katër, katër mbretër të valles dhe melodive dibrane, dy të kurorzuar në fe Festivalin e Valles Tipologjike Shqiptare zhvilluar në Lushnjë, dhe dy të tjerë që u jehon melodia e ciftelisë dhe vikama e fyellit...

I kam në arkivin e emigrantit, një arkiv fotografik që po të thosha "dhjetë mijë" do ti ngelesha në hak...

Sot, më 27 janar 2017, tek lundroja nëpër zarfet kompjuterikë, i shikova me mall e dashuri, të katërt por në vecanti Shaban Xhajkun, shabanin e valles, këngës, ciftelisë e mbi të gjitha të gazit e humorit që i ishte ngjitur pashqitëshmërisht në buzë, fytyrë e në zemër.

Nuk po i mbaj mbyllur, po i përcjell për të gjithë...





cyan magenta yellow black

BOTIME M&B

www.facebook.com/ M&B - Botime dhe Studio Grafike
www.mbbotime.com
Për porosi: botimemb@gmail.com/Cel: 069 20 68 603



HISTORIA E DIBRËS

XHAFER MARTINI

Akademik Kristo Frashëri: “Unë e mendoj historinë e Dibrës jo si një histori pushke, luftëtarësh, siç e kanë qejf shumë malësorët e Dibrës kur flasin e tregojnë trimëritë. Unë dua bashkë me trimëritë, bashkë me gishtin - si i thonë pushkës, - kam dashur të shoqëroj dhe mendjen. Se Dibra ka pas edhe njerëz të mendimit. Ka dhe një prodhim që është prodhimi intelektual popullor, edhe prodhim intelektual që quhet refleksiv shkencor. Por Dibra në tërësinë e saj ka një pasuri të madhe aspektesh të jetës shoqërore, të jetës familjare edhe të jetës krahinore. Këtë kam dashur të përshkruaj në këtë libër, nuk e di sa ia kam arritur.”



KANUNI I DIBRËS

Trashëgimi etnojuridike

XHAFER MARTINI

Kanuni i Dibrës vjen si dëshmia më e madhe dhe më e plotë e tipologjisë së civilizimeve lokale shqiptare. I njëkohshëm dhe i barabartë për nga rëndësia me “Kanunin e Lekë Dukagjinit“ dhe me “Kanunin e Skënderbeut“ (me variantet dhe invariantet e tij), – ”Kanuni i Dibrës” ka të përbashkëta dhe dallime nga dy të parët. Më hollësisht këto dallime do t’i gjeni në “Hyrjen” e mbledhësit të këtij Kanuni, shkrimtarit dhe kulturologut të mrekullueshëm, Xhafer Martini. Këtu vlen të përmend vetëm një veçori dalluese të Kanunit të Dibrës – papraninë (mospërfshirjen) e institucioneve religjoze (kishës e xhamisë) duke mos privilegjuar e favorizuar në sanksionet kanunore as klerin. Nga ana tjetër, përpos barazisë së rreptë të rregullit, të cilit duhet t’i nënshtrohet gjithkush njëlloj, pa dallim, – Kanuni i Dibrës spikat për një elasticitet më human e vetëpërmbajtje më të thellë në shumë çështje “të nxehta” si “gjakmarrja”, “hakmarrja”, “gjaku”, “xhipi”etj. Një tjetër “avantazh” i këtij Kanuni është sasia e bollshme e fakteve, detajeve dhe e rrëfimeve të vërteta që ballafaqohen e pranëvihen gjegjësisht me tabutë e sanksionuara dhe përkufizimet e së drejtës, duke i dhënë Kanunit dimension të gjallë sintetik. “Kanuni i Maleve të dibrës” është dëshmia monumentale e asaj “atlantide” civilizimi të kredhur në memorien dhe etnopsikikën e dibranit.

TOPONIMIA E ÇIDHNËS

HAKI PËRNEZHA, RRUZHDI BITRI

Në librin e këtyre dy autorëve janë ndërthurur meritat e mbledhësit, tejshkruesit dhe të studiuesit. Aty janë bashkë edhe filologu, edhe dialektologu, edhe antropologu e historiani. Libri i tyre është një arritje etnogjuhësore, në të cilën fjala dhe bartësi i saj nuk ndahen...
Pa dyshim, në duart e studiuesve albanologë më të njohur: E. Çabej, A. Buda, K. Frashëri, po dhe të një brezi pasuesish të tyre, ky libër do të merrte dhe do të marrë vlerë tjetër një surplus të padiskutueshëm...
Libri përmban edhe një fjalës të fjalës së rrallë ose në zhdukje të shqipes nëndialektore të këtyre anëve. Të shpëtosh një fjalë nga vdekja është një shërbim i paçmueshëm për një gjuhë.



THEMRA E AKCILIT

AGRON TUFA

Prozat e shkurtra të këtij libri kanë një dallim thelbësor nga krijimtaria ime artistike në poezi, prozë të gjatë apo ese. Diku më shumë, diku më pak, në këto proza të shkurtra ndërthuren elemente dhe të poezisë, dhe të prozës romanore, dhe të esesë. Kështu, përgjatë viteve kur u shkruan prozat e shkurtra të këtij vëllimi interesi im ka qenë kërkimi i një forme sa më të përshtatshme, duke patur si impuls parësor jo më imagjinatën e pastër letrare, sikundër ndodh në poezitë, romanet, tregimet apo novelat, por me të ashtuquajturën “lëndë e gjallë”, e përftuar nga kontakti i drejtpërdrejtë me realitetin. Pra, ndryshe nga procedimet e kulluara letrare, në këto proza jam rrekur të paraqes atë realitet që kam parë dhe që e njoh mirë dhe vetëm në bazë të këtij materiali të vërtetë, të mund të krijoj një kornizë letrare të përshtatshme. Nëse në krijimtarinë e kulluar letrare përparësi ka qenë imagjinata dhe fiction-i, në këto proza të shkurtra përcaktues është fraktura e realitetit konkret, të marrë drejtpërdrejt apo tërthorazi, në dorë të parë.
Nxitje për këtë ka qenë një frazë e ndeshur në një tregim të Vladimir Nabokovit: “Jeta është shumë herë më e papritur dhe më e talentuar se ne”.



SABRI CAKA, KRAHU I SHQIPES NË FLAMUR

HALIL TEODORI

Zona jonë ka nxjerrë heronj dhe figura të shquara, personalitete të rëndësishme të kulturës dhe dijes, guximit dhe vendosmërisë, traditës dhe atdhetarisë.
Kjo kolanë e gjatë dishepujsh të vlerave dhe krenarisë ka shërbyer vendit, por ata kanë ngelur pa u bërë të njohur, përfaqësuar dhe vlerësuar. Është detyrim i gjeneratave që në emër të mirënjohjes, në emrin e thirrjes së gjakut, në emër të më të shtrenjtës që na ndjek nga pas kudo që të shkojmë, në emër të plisit, t’i njohim, t’i promovojmë dhe ta çmojmë kontributin e tyre.
Është kjo përpjekje, është ky angazhim, është kjo detyrësi, ajo që na nxit të jemi ne ata që do të shkruajmë ato faqe të historisë që trualli na i ka besuar ne, sepse vetëm ne mund ta matim dhimbjen e kësaj toke, ta dëgjojmë kushtrimin e këtyre maleve, t’u bindemi këshillave të etërve flokëbardhë, ta lehtësojmë dhimbjen e kësaj plage”.



PËLLUMBAT E RRUGËS

RAMIZ GJINI

Romani më i fundit “Pëllumbat e rrugës”, vjen si përmbyllje trilogjisë groteske mbi një vend imagjinar sa edhe real, Bibollin, një provincë në Shqipërinë postkomuniste, po aq edhe kryeqytet i paradokseve, paranojës dhe megallomanisë, të përfaqësuara nga romanet “Rrëketë” (2007) dhe “Bibollasit” (2009). Pjesa e tretë e trilogjisë “Pëllumbat e rrugës”, është në të njëjtin stil grotesk, të njëjtët personazhe, të njëjtin topos, por në shkallë më të avancuar të sëmundjeve të postkomunizmit.
Romani ka disa pika të forta të tij, siç kemi bindjen, dhe pikë e fortë para së gjithash është uniteti, kompaktësia e linjës së rrëfimit ironik mbi Tushin dhe Lushen në sfondin e panairit grotesk të Bibollit gjithë personazhë simulakër, që përfaqësojnë instancat shoqërore e shpirtërore të kësaj topike të njohur tashmë edhe në dy romanet e mëparshme të autorit.
Në letërsinë tonë të sotme, bashkëkohore, nuk kemi ndeshur ende me nje projekt të përmbyllur suksesshëm të një trilogjie të romanit grotesk, siç janë tre romanet e Ramiz Gjinit.

TË JETOSH NË PAQE

NAIM BERISHA

Në këtë roman trajtohet tema e qëndresës së popullit të arbërit në kohën e Skënderbeut. Duke glorifikuar familjen e lashtë të Berishëve të Mazrekave në Gardh të Poshtëm, dmth, në Muhurrin e sotëm të Dibrës së Poshtme dhe të dy gjeneralëve të Skënderbeut, vëllezërve Dhimitër dhe Nikollë Berisha, djem të Gjergj Berishë Mazrekës dhe Majra Kastriotit) ai, në të njëjtën kohë, glorifikon gjithë qëndresën heroike të Arbërisë nën udhëheqjen e Skënderbeut kundër tiranisë së pashembullt turke. Ky roman me bazë historike të vërtetë është sa tërheqës dhe intrigues, aq dhe me interes e domethënës. Si i tillë, ai lexohet me një frymë.

DIBRA NË SHEKUJT E SUNDIMIT OSMAN

MUNIR SHEHU

Askush nuk mund të thotë se këto këngë e gojëdhëna u trilluan ashtu, kot së koti nga populli. Ato e kanë një burim, për këtë as që mund të dyshohet.
Në to shihet qartë vringëllima e shpatës, lufta për mbijetesë, për liri.
Burimi është populli, vetë historia e tij. Pra, mund të konsiderohen si dokumente historike për ngjarjet që përshkruhen në to.
Çështja e folklorit me burim shumë të vjetër është si puna e muzikës. Nuk mund ta lexosh melodinë pa parë më parë çelsin e muzikës në krye të pentagramit.
Ashtu si për muzikën, që, këtë çelës nuk mund ta gjesh gjëkundi, vetëm në muzikë, po ashtu edhe për folklorin, këtë çelës nuk mund ta gjesh gjëkundi, vetëm në folklor, d.m.th., në popull.

UDHË NË PASQYRË

AHMET PRENÇI

Besnik Mustafaj: Unë e kisha njohur prej shumë vitesh si lexues të pasionuar Ahmetin, gjë që, siç e shihja, kishte ndikimin e vet mbi qasjen e tij ndaj njeriut, natyrës, politikës, historisë. Tashmë nuk do të ketë vend të shprehim habinë, qoftë kjo edhe një habi e bukur, sepse ai na është shfaqur edhe si një prokuror ndryshe, hetues ndryshe dhe kryepolic ndryshe ... Ahmet Pençin e ka “zbutur” dhe vazhdon ta “zbusë” e ta përsosë poezia që ka brenda vetes.
Agron Tufa: Vargje të çlirëta, me muzikalitet spontan, që rrjedhin natyrshëm, me shpengimin karakteristik të frymëzimit origjinal, ato kanë ajrin e lirë të bjeshkëve dhe peizazheve të vendlindjes. Metaforat e freskëta që i hapin udhë përfytyrimit dhe ndjenjës..

PO TË MOS ISHTE DRINI…

NAIM PLAKU

Në përmbledhjen rrëfimore “Po të mos ishte Drini…”, Naim Plaku shkëlqen si prozator. Me një gjuhë mjaft elegante dhe të përpunuar, me një stilistikë të qëruar e plot kolorit të idiomave dhe frazeologjisë popullore dibrane, na paraqet një botë të trazuar kujtesash dhe emocionesh, që kanë në bazë të tyre rrëfimet mitologjike, parahistorike dhe historike dibrane.
Etiketuar si “urtësi dibrane”, ky libër është një mozaik narrativ, me themele në të folmen popullore dibrane, në kujtesën kolektive dibrane, ku autori merr ngjarjet, të ndodhurat dhe i rikrijon e i përpunon me një gjuhë të latuar e të përpunuar hijshëm. Duke përdorur një gjuhë të vrullshme, me një sens të fortë përshkrues dhe rrëfimtar, plot ngjyrime dhe stolisje me fjalë e idioma lokale, autori na çon në rrugëtime mitologjike dhe parahistorike si në rrëfimin e gjatë e të mrekullueshëm “Po të mos ishte Drini, ku do të mbytej Seta”, ku tregohet historia e dy ujërave të Dibrës, në një marrëdhënie të shpirtëzuar njerëzore, me fuqi sugjestive metafizike dhe transhendente.

Rruga e Arbërit nr. 129

100 vjetori i lindjes - Historia e çidhnakut që urdhëroi hapjen e zjarrit ndaj provokatorëve të gushtit 1949

histori

Adem Islam Hoxha i Çidhnës, heroi i rezistencës ndaj monarkofashistëve grekë

Nga **HALIL RAMA**

Njëqint vjet më parë, më 9 janar 1917, në Çidhën të Dibrës lindi Adem Islam Hoxha, emri i të cilit hyri në historinë e kombit për aktin e pashembullt heroik në rezistencën ndaj monarkofashistëve grekë, gjatë provokacioneve të njohura të gushtit të '49.tës. I mbetur jetim që 6 muash, pasi babai Islami dhe nëna, Lihja i vdiqën nga epidemia e tifos e vitit 1917, Ademi do të rritej dhe edukohej nga gjyshi i tij, Abdurrahmani (Hoxhë Kuta). I njohur me titullin "Hoxha i 12 mijëve" në Shehër të Thatë, njëri ndër udhëheqësit popullor për organizimin e rezistencës të krahinës të Çidhnës e të mbarë Dibrës kundër pushtuesve serbo-sllavë në fillim të shekullit XX (gjatë viteve 1912-1920), do të përkujdesej që këto virtyte t'i mishëronte edhe nipi, Ademi. Edukimin e parë atdhetar me dashurinë për atdhe dhe urrejtjen kundër armiqve pushtues e mori qysh në moshën 3-vjeçare, në vitin 1920, në kohën e pushtimit serb për të shpëtuar nga masakrat e pushtueseve, kur për tre muaj rresht u strehua në një shpellë në Gjalica të Çidhnës, në një kohë që pjesa tjetër e popullsisë së Dibrës u shpërngul drejt Tiranës, ashtu si në vitin 1913. Që nga ajo kohë, dhe sot e kësaj ditë, ajo quhet "Shpella e Hoxhës".

Në vitin 1940 për veprimtari atdhetare antifashiste, u burgos nga pushtuesit italianë dhe u internua më pas në kampin e përqendrimit nazifashist në Ventotene të Italisë ku u dënua me 2 vjet dhe qëndroi nga janari 1940 deri në dhjetor 1941. Ky fakt vërtetohet edhe nga regjistri që gjendet pranë Komitetit Kombëtar të Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të Popullit Shqiptar, Tiranë në faqen nr.3 të të cilit me nr.rendor 21, z.Adem Hoxha (atëherë Kuta) figuron të ketë qenë i internuar prej nazifashistëve në kampin e përqendrimit në Ventotene, Itali, prej datës 11.02.1940 deri në dhjetor 1941, duke mos u përfshirë këtu koha e paraburgimit në Peshkopi, para transferimit në Itali dhe ajo e qëndrimit prej 24 ditësh të tjera në burgun e Barit në Itali.

Në kampin nazifashist të Ventotenes Ademi u njoh dhe u miqësua me atdhetarë të tillë, udhëheqës të rezistencës shqiptare kundër pushtuesve nazifashistë, si Nazmi Rushiti, Sadik Bekteshi, Ibrahim Dervishi, Abdyl Këllezi, Zef Mala etj. apo dhe me nacionalistët Safet Butka, Abas Ermeni, Prof.Isuf Luzaj etj. Shoqëria dhe miqësia e tij me figura të tilla, ia rriti Ademit eksperiencën dhe pjekurinë politike.

Në dhjetor 1947 kur i kishte kaluar 30 vjeç, u mobilizua për të kryer shërbimin ushtarak të detyruar në Qarkun e Korcës, (gjatë viteve 1947-1950), prej të cilëve, dy vjetët e fundit në kufi, në Bilisht. Pra, në kohën kur dha urdhërin luftarak për të hapur zjarr mbi forcat agresive të monarkofashistëve grekë, Ademi i kishte të gjitha cilësitë dhe aftësitë si dhe ngritjen ideo politike dhe përgatitjen ushtarake për të komanduar e për të dhënë një urdhër luftarak me peshë të tillë që ishte vendimtar për fatet e atdheut.

NGJARJA E 2 GUSHTIT 1949 NË VIDOHOVË

Më 2 gusht 1949, do të ishte një centralist i thjeshtë nga Çidhna e Dibrës urdhëruesi i hapjes së zjarrit ndaj provokatorëve monarkofashistë grekë në kufirin shqiptar të Kapshticës. Adem Hoxha, çentralist i postës kufitare në Kapshticë të Devollit, kishte radhën e shërbimit të gatishmërisë luftarake në natën e datës 1 (një) gusht duke u gdhirë 2 (dy) gusht i vitit 1949, kur rreth orës 02:00 të mëngjesit të datës 2 gusht 1949, ra zilja e telefonit. Mori receptorin dhe nga ana tjetër, personi që i fliste, u prezantua se ishte komandanti i Postës kufitare të Vidohovës.

Për momentin emri i tij nuk më kujtohet, - tregonte Ademi, - por mbaj mend se ai ishte një djalë i ri rreth të njëzet e dy-tre vjetëve, të cilit, sapo kishin filluar t'i dirsin mustaqet. (Sipas bash-

këkohësve, ai duhet të ketë qenë Memo Nexhipi Bejko, - pak çaste para se të binte dëshmor, i cili më pas është shpallur "Hero i Popullit").

Kur Komandanti i postës së Vidohovës, z.Memo Nexhipi Bejko i ka kërkuar centralistit Hoxha që ta lidhte me komandantin e regjimentit, Ademi, iu përgjigj se "Komandanti i regjimentit në këtë orë është në shtrat, duke fjetur në shtëpinë e tij, në Korçë. Ai nuk ka telefon në shtëpi." Më pas Komandant Memoja i ka kërkuar kufitarit nga Dibra që ta lidhte me Ministrinë e Mbrojtjes, por sërish ka marrë përgjigje refuzuese! "Përderisa nuk mundem me të lidhur me Korçën, si mundem me të lidhur me Ministrinë në Tiranë?! Ne nuk kemi lidhje me radio, por vetëm një central të thjeshtë, me tel !",-i është përgjigjur Adem Hoxha. Dhe në kushtet kur forcat greke kishin shkelur 500 metra në territorin tonë kufitar, komandant Memoja, i zënë ngushtë i ka kërkuar një mendje centralistit nga Dibra se si duhej të vepronte.

-Zjarr!, - i është përgjigjur Ademi.

-Si të hap zjarr?! Me urdhër të kujt të hap zjarr?!, - i tha komandanti i postës së Vidohohëvs.

-Me urdhërin tim! – i është përgjigjur rrufeshëm kufitar Ademi.

-Si me urdhërin tënd?! – ka vijuar komandanti?!!

-Po të them: Me urdhërin tim! Kur forcat greke do të të vijnë te posta, ti a do t'u japësh cigare e duhan dhe t'ua ndezish me shkrepse me dorë në zemër?! Zjarr mbi agresorët, se vetëm kështu mbrohet Atdheu! Vetëm këto ishin fjalët e fundit që këmbyen komandant Memoja dhe centralisti Adem Hoxha ndërmjet tyre, në mëngjesin e 2 gushtit 1949, para se të fillonte lufta mbrojtëse në Vidohovë kundër agresionit të monarkofashistëve grekë të 2 gushtit 1949.

Pra, e thënë ndryshe, urdhërin luftarak për fillimin e zjarrit të parë, të pushkëve të para në Vidohovë me 2 gusht 1949 e ka dhënë, me inisiativën e vet, një ushtar i thjeshtë dibran, Adem Islam Hoxha, ish-centralist i postës kufitare të Kapshticë -Vishocicë-s. Më saktë, me atë arsyetim logjik të pjekur, tepër bindës, në ato rrethana të jashtëzakonshme bindi me të drejtë komandantin e Postës së Vidohovës për të hapur zjarr mbrojtës kundër agresionit të monarkofashistëve grekë, më 2 gusht 1949, në atë situatë të nxehtë luftarake.

Një arsyetim i tillë, si ai i Adem Hoxhës, është tepër bindës dhe i drejtë edhe tani, pas më shumë se gjashtë dekadash, në kohë paqeje dhe në një situatë tjetër marrëdhëniesh krejt të ndryshme nga ajo e asaj kohe. Nuk mund të kishte asnjë zgjidhje tjetër, përveç asaj të Adem Hoxhës, të mëngjesit të 2 gushtit 1949: për të hapur zjarr mbi agresorin.

Kjo është një e vërtetë historike, ndonëse e pashkruar ndokund, ashtu si shumë të vërteta të tjera të pashkruara të historisë së popullit shqiptar, e rrëfyer qartë nga protagonisti i kësaj ngjarjeje në vitin 1993, kur ishte në moshën 76 vjeçare.

ÇFARË SHKRUANTE "ZP" MË 6 SHTATOR 1949

Akti heroik i çidhnakut Adem Hoxha jepet fare qartë, qoftë dhe nga një fragment i reportazhit të të dërguarit të posaçëm të "Zërit të Popullit", Dhimiter Tona, me titull: "Në piramidën 33, në sektorin e Bilishtit", botuar më 6 shtator 1949. Ndër të tjera në të shkruhet: "...Centralisti ndërlidhës, Adem Islam Hoxha nga Çidhën e Poshtëme i Dibrës, në mes mijëra predhash të artilerisë armike, ku s'mbeti pëllëmbë toke pa u qëlluar, ka kryer me heroizëm detyrën e tij: tri herë natën u këput linja, por të tri herët ai e lidhi përmes zjarrit të artilerisë dhe breshërit të plumbave të mitralozit. "Në luftën NCÇl-thotë ushtari Adem Hoxha, i dekoruar me Medaljen e Trimërisë,-nuk pata fat të luftoja kundër armikut, tashti jam edhe unë kryelartë midis shokëve të mij se kam luftuar ashtu si vëllezërit e mij dje për çlirimin e Atdheut; sot unë luftova për mbrojtjen e tij nga monarkët që duan ta skllavërojnë popullin tonë dhe të sjellin në fuqi armiqtë tanë....".

KUSH ISHTE ADEM HOXHA?

Po kush ishte ky ushtari, Adem Hoxha, që mori një nisiativë të tillë për të dhënë një urdhër luftarak të tillë, për fillimin e një lufte frontale si ajo e 2 gushtit 1949?! Çfarë përgatitje ideo-politike e ushtarake kishte ai person që paska marrë një inisiativë të tillë për të dhënë një urdhër luftarak të tillë si ai, për të hapur zjarr kundër provokacioneve të një ushtrie të një shteti tjetër, si Greqia?

Adem Hoxha, i biri i Islamit dhe i Lihes (1917-1993), nga Çidhna, Dibër, veterani i Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar, i internuar në kampin e përqëndrimit nazifashist në Ventotene, Itali, në periudhën janar 1940 - dhjetor 1941 dhe luftëtari i vijës së parë të frontit të luftimeve për mbrojtjen e kufijve të Atdheut tonë nga provokacionet e monarkofashistëve grekë në gusht të vitit 1949, ishte tepër modest, ndaj nuk ka lënë kujtime të shkruara, por vetëm këto rrëfime gojore që nuk na shqiten lehtë nga kujtesa.

Për aktin heroik ish centralisti dibran i postës kufitare "Guri" në Kapshticë të Devollit, Adem Hoxha është dekoruar me "Medaljen e Trimërisë". Kjo vërtetohet me çertifikatën e lëshuar nga ish Presidiumi i Kuvendit Popullor të RSH me nr.6749 dhe nr.i Dekretit 911, datë 23 gusht 1949 që mban nënshkrimin e ish-Presidentit Dr.Omer Nishani dhe të ish-Sekretarit Sami Baholli. Në këtë Medalje është shënuar ky motivacion: "Gjatë luftimeve për mbrojtjen e kufijve t'Atdheut në sektorin e Trestenikut nga agresioni i monarko-fashistave grekë, është dalluar për trimëri, vendosmëri e besnikëri". Kjo çertifikatë është një argument tjetër më shumë që vërteton katërcipërisht se Adem Hoxha ka qenë i saktë në rrëfimet e tij të para dy dekadave. Përpos kësaj, autoriteti i tij i padiskutueshëm në jetën civile, kur ka shërbyer mbi 60 vjet si imam, drejtues fetar dhe shoqëror, nuk lë asnjë shteg për asnjë fije dyshimi mbi të vërtetën e tregimeve të tij për organizimin e rezistencës ndaj provokacioneve të monarkofashistëve grekë të 2 gushtit 1949.

Si bashkëbisedues i para dy dekadave ruaj në memorien episode të rrëfyera mjeshtërisht nga Ademi për Provokacionet e 2 gushtit 1949. Shpesh herë ai thoshte se jetën në atë luftë ia ka shpëtuar ish- Komandanti i Regjimentit, z.Baki Starja. "Gjatë luftimeve unë kisha detyrë që të mbaja ndërlidhjen me central fushor, të lëvizshëm, atje ku zhvilloheshin luftimet. Pozicioni i centralit nuk mund të ndryshohej pa urdhërin e komandantit. Në një moment të caktuar, gjatë luftimeve ra një predhë murtajë e armikut vetëm disa metra larg, ngjitur me pozicionin ku unë kisha vendosur centralin. Pranë meje ndodhej edhe z.Baki Starja, më vonë gjeneral. Fill pas atij momenti, komandant Bakiu më urdhëroi: Adem, shpejt spostoje centralin mu në gropën që hapi predha e murtajës së armikut. Sapo unë instalova aparaturën e telefonit në vendin e caktuar, vetëm disa sekonda më pas, ra predha e murtajës së armikut, pikërisht në vendin ku unë pata më parë pozicionin e centralit. Po të mos kisha ndërruar pozicionin e instalimit të centralit, unë do të isha vrarë në atë luftë," - tregonte Ademi, duke shprehur njëherësh edhe respektin dhe mirënjohjen për Gjeneral Baki Staren që ka qenë oficer madhor në Provokacionet e gushtit 1949. Gjatë një takimi të rastësishëm, gjenerali në pension, Baki Starja, jo vetëm ma konfirmoi plotësisht atë çka treguam më sipër, lidhur me spostimin e centralit fushor, por pasi më shprehu edhe konsideratën e lartë dhe kujtimet që ruante për ish-ushtarin e tij 32-vjeçar, nga Dibra, bashkëmoshatarin Adem Hoxhën, më tregoi edhe arsyen e dhënies së atij urdhëri, d.m.th. eksperiencën e tij luftarake.

RRËFIMI I GJENERAL BAKI STARJES

Gjeneral Baki Starja që kishte kryer shërbimin e detyruar ushtarak në kohën e luftës Italo-Greke, kujton gjithashtu kohën kur ka qenë i mobilizuar në repartin e ushtrisë shqiptare dhe shoqërinë me bashkëushtarin Vesel Bushi (Spata) nga Blliçja e Peshkopisë nga. Nga përvoja e asaj lufte ata kishin mësuar se ushtria greke, artilierët i kishte ushtarë të karrierës me rrogë dhe jo rekrutë të shërbimit të zakonshëm të detyruar. "Artilierët grekë, si profesionistë të kualifikuar, predhat e artilerisë nuk i shpërdoronin, prandaj ata nuk shenjonin me gjuajt dy herë në të njëjtin vend, por për çdo qitje e lëviznin gradimin e shenjimit, për të mos rënë dy predha radhazi në të njëtin vend. Duke ditur këtë eksperiencë, unë e urdhërova Ademin që menjëherë të spostonte instalimin e aparaturës së centralit pikërisht në vendin kur ra predha e mëparshme, pasi e dija se aty ishim të sigurtë nga goditjet e armikut",-tregon gjeneral Starja. Ndërsa centralisti Adem Hoxha, me krenari pohonte faktin që të gjithë ushtarët dibranë që morën pjesë në luftimet kundër provokacioneve të gushtit, shkëlqyen, duke u dalluar ndër të tjerët. Kjo sipas tij edhe për faktin se asnjë ushtar dibran nuk u largua nga pozicioni i luftimeve, ku e kishte caktuar komanda, por të gjithë ata, në përfundim të luftimeve u gjetën në vijën e parë të frontit. Kjo, ndoshta, u bë shkak që më pas dibranët të shiheshin me një sy tjetër më të mirë, nga komanda, ndryshe nga më parë, pasi deri para provës që dhanë në luftime, ata shiheshim si të dyshimtë, për shkak të luftës që qe bërë në Fushalie të Dibrës, në korrik të vitit 1944. E thënë ndryshe, luftimet e provokacioneve të gushtit 1949 u bënë shkak që të rehabilitoheshin dibranët. Në këtë aspekt, ndër më të dalluarit, përveç oficerëve Bajram Hysen Kovaci e Isuf Daci, nga Grykë-Noka, ai kujtonte edhe Arfi Pitarkën po nga Grykë-Noka, që shërbente në postën e Vidohovës, si dhe të tjerët nga reparte të tjera si Fali Konozi nga Grykë-Noka, i plagosur, Sulë Daci po nga Grykë-Noka, Sali Pana nga Kodër-Leshej që ra dëshmor; të gjithë të dekoruar me "Medaljen e Trimërisë" etj.

Ndër shokët dhe kuadrot drejtues të rezistencës kun dër agresionit të provokacioneve greke të 2 gushtit '49, Ademi ruante respekt të veçantë për kolonel Skënder Malindin që jeton edhe sot. Kjo edhe për fakktin se kolonel Malindi, i sapo kthyer nga Akademia Ushtarake e Bashkimit Sovjetik, në vitin 1947, e konsideronte Ademin jo si ushtar të thjeshtë, por si shok, të barabartë me të. Ndaj dhe organizatorët dhe pjesëmarrësit e asaj rezistence të pashembullt ndaj agresionit të monorkofashistëve grekë, meritojnë nderim të veçantë.

profil

Një punë e mirë dhe e përkushtuar kurrë nuk mund të marrë vlera pa pasur brenda pasionin, me të cilin Haki Duka dukej se kishte lindur...

Haki Duka, një **vlerë** e pamohueshme **e sportit dibran!**

Nga DEFRIM METHASANI

Endërsa vitet ecin, të duket ndonjëherë sikur njerëzit harrohen. Por në fakt, veprat që lanë pas disa prej më të shquarve, bënë atë që jo vetëm të mos fshihen nga kujtesa, por të mbeten në altarin e historisë në fushat përkatëse. Njëri prej tyre është edhe Haki Duka, ish drejtuesi për shumë vite në sport, metodist, mësues e protagonist. Pak ditë më parë në dorë kisha edhe librin e tij, një libër i botuar në fakt një dekadë më parë, por që është një botim që sjell gjithë historinë deri në vitin '90, një botim që bën fjalë për të dhënat në shumë sporte, mbi të gjitha, është një testament për gjithçka ndodhi në sportin e Klubit Korabi për dekada të tëra. Aty gjejnë veten ata që jetojnë, por edhe yjet e sportit që na mungojnë. Flitet për skuadra, por edhe për individë, për kampionë, mjeshtra, për trajnerë e specialistë...

Por të lemë pas librin dhe të flasim për Hakiun njeri, Hakiun pasionant, drejtues, metodist, Hakiun e përkushtuar që arriti të mundësonte edhe 75-vjetorin e Klubit Korabi në vitin 2005, një ceremoni madhështore, ku edhe u nderuan shumë prej korifejve të sportit dibran në vite. Por cila është historia e tij në sport dhe nga nisi kontributi? Ai në vitin 1972, vinte i mbushur me shumë energji nga auditoret dhe fushat e të vetmit universitet sportiv në vend askohohe, IKF "Vojo Kushi" Tiranë.

E nisi si inspektor i Edukimit fizik dhe sporteve, por falë cilësisë që ofroi dhe përkushtimit maksimal, shumë shpejt arriti të ishte drejtues i komitetit të fizkulturës e sporteve, siç quhej në ato vite.

Ky mision, pra i drejtuesit, zë fill në vitin 1975 dhe vijoi deri në vitin 1988. Mbaj mend që asokohe sapo kisha nisur punën si mësues i Edukimit fizik dhe kujtoj edhe spektaklet që ideonte e organizonte në çdo fundvit me 10-të sportistët më të mirë të Klubit Korabi, apo takimet mes shkollave dhe fshatrave e zonave, mes kooperativave e ndërmarrjeve, ku dilnin shumë elementë të mirë për ekipet profesioniste.

Pas vitit '80 deri në '90-të, Klubi Korabi u bë lokomotivë e fuqishme e rritjes së numrit të ekipeve në kategorinë e parë. Volejbolli i femrave, mundja, atletika, alpinizmi, qitja, shahu, skitë, radioamatorizmi, basketbolli i të rinjve, por edhe futbolli, pavarësisht se nuk u ngjit dot në kategorinë e parë, ishin promotorë të një ndryshimi cilësor, duke afirmuar vlerat më të spikatura dhe dinjitoze të një treve sportdashëse, si Dibra.

Pas viteve '90-të, sërish Haki Duka e gjeti vendin e tij, duke qenë metodist në drejtorinë arsimore, por në dhjetor të vitit 2002, ai sërish bëhet drejtues i Klubit Korabi për disa vite.



Kontributi i Haki Dukës ishte evident edhe në rritjen cilësore të mësimit në orën e Edukimit fizik, sepse ai për shumë vite mbuloi sektorin e kësaj lënde në seksionin e arsimit e më pas drejtorinë arsimore në rrethin e Dibrës.

Në vitin 2015, falë nismës së tij, Klubi sportiv Korabi festoi jubileun e 75-të të tij, duke promovuar me këtë rast edhe librin që bënte fjalë për historinë e sportit deri në vitin 1990. Ai e bëri me shumë pasion atë jubile, duke dashur të linte pas tullën e fundit, të një muri të madh që ngriti për më shumë se 35 vjet në shërbim të sportit dhe vlerave të tij në Dibër.

Por kontributi i tij, për shumë vite ishte evident edhe në rritjen cilësore të mësimit në orën e Edukimit fizik, sepse ai për shumë vite mbuloi sektorin e kësaj lënde në seksionin e arsimit e më pas drejtorinë arsimore në rrethin e Dibrës. Sëmundja e rëndë e ndau nga jeta në një moshë relativisht të re, kur ai mund dhe duhej të jepte akoma. Bashkëshortja e tij, ish mësuese dhe drejtuese e arsimit në Dibër, Kije Duka, mbetet dëshmitare dhe bashkëpunëtore e gjithë këtyre viteve, të njeriut, mësuesit dhe drejtuesit model.

Java olimpike - Peshkopi 2007. Takimet finale të shkollave të mesme. 19 maj 2007.

FLASIN PËR HAKI DUKËN:

Xhelil Cibaku, *Mjeshtër i Merituar i Sportit*
HAKI DUKA JEPTE SHPIRTIN DHE TALENTIN E TIJ NË MËSIMDHËNIE

Ishte një organizator dhe punëtor shumë i madh. Mbi 15 vite ka drejtuar sportin në Dibër, duke ardhur nga një eksperiencë e gjatë si atlet dhe mësues i Edukimit fizik. Ai shquhej për organizmin e sporteve në Dibër, duke i ndarë ato në dy plane, në sporte popullore zonale dhe në sporte zyrtare. Një prioritet të madh iu dha spartakiadave, duke nisur nga shkollat 8-vjeçare e të mesme, por edhe veprimtarive masive, si kroset, ngjitjet alpinistike, aktivitetet mes ndërmarrjeve, aktivitetin e mundjes tradicionale në Gollobordë dhe jo vetëm, si dhe shtrirjen e sportit në zona, si atletikë, mundje në fshatrat Ostren dhe Sohodoll, pa harruar Bulqizën, në alpinizëm etj. Kujtoj këtu ekskursionet që bënte në pikat turistike apo majë malesh, duke imponuar te fëmijët dhe të rinjtë edhe njohjen me vendin e tyre. Një gjë interesante kanë qenë lojërat popullore që organizonte çdo vit. Ndërkaq duhet vlerësuar mbështetja maksimale që i dha atletikës, një sport që arriti të sjellë edhe medalje ballkanike me trajnerin pasionant Rexhep Zebin. Po kështu, përmend edhe rezultatet cilësore në sporte të tjera si në mundje, ku çdo vit Korabi kishte sportistë në kombëtare. Por dua ta vendos theksin në volejboll, ku për herë të parë vajzat dibrane përfaqësuan edhe ekipin kombëtar me trajnerin e paharruar Bashkim Lala, në shah, alpinizëm, atletikë, qitje, etj. Ai pati një bashkëpunim model me mësuesit e Edukimit fizik nëpër shkolla dhe me stafet e trajnerëve në të gjitha nivelet, duke i mbështetur në punën e tyre. Mbaj mend që në spartakiadat kombëtare Dibra falë rezultateve cilësore merrte flamurin e spartakiadës, si rreth i kategorisë së dytë.

Musa Riçku, *Zv. Kryetar i LID*
ORGANIZATOR DHE PUNËTOR SHUMË I MADH

Me Haki Dukën njihem shumë herët, që kur kam qenë nxënës, aq sa mbaj mend akoma orët e fizkulturës në shkollën e mesme në Peshkopi, ku ai jepte shpirtin dhe talentin e tij në mësimdhënie. Më pas unë fillova mësues në Gurë-Lurë dhe aty ai më ndihmonte me bazë materiale dhe mënyrën metodike të orës së mësimit. Por ky bashkëpunim dhe respekt i ndërsjelltë, vijoi edhe vite më pas, pavarësisht viteve të largimit tim në Tiranë.

Në kohën kur ai ishte drejtues i Klubit Korabi, bëri një festë madhështore me rastin e 75-vjetorit të Klubit Korabi dhe unë isha një nga biznesmenët bashkëfinancues, krahas Met Bitrit dhe Rakip Sulit, për këtë aktivitet. Pasi mbaroi me sukses e gjithë veprimtaria, nuk më harrohet të përmend faktin që ai më nisi drejt Tiranës të gjitha shumat e paguara dhe shpenzimet me fatura përkatëse, duke treguar jo vetëm ndershmërinë që e karakterizonte, por edhe njeriun korrekt dhe mirënjohës. Gjithashtu, nuk kish harruar të dërgonte fotot, dvd dhe një mirënjohje, që mua m'u duk se më shtoi shumë vite jete. Pra, ky ishte Hakiu, njeriu i mirë, punëtor, iniciator dhe konkret.

Rexhep Zebi: *Ish trajner i atletikës, Kanada*
HAKI DUKA LA GJURMË HISTORIE NË SPORTIN DIBRAN

Ndjej dhimbje për mungesën e një njeriu që sportin dibran e ngriti në kulme të tij. Kujtoj gjithë ato vite punë titanike, ku atletikën dibrane nga niveli zero e dërguam në majat e sportit shqiptar, por edhe në Ballkan dhe Europë. Unë e vlerësoj padyshim Hakiun, sepse la gjurmë historie në sportin dibran. Mbi të gjitha vlerësoj bashkëpunimin dhe mbështetjen që i dha sportit ku unë isha trajner. Ai më tërhoqi nga Luznia ku isha mësues dhe ngriti klasat sportive që ishin baza e atletikës. Aty zbuluam talentet dhe vijuam të punojmë deri në vitin 1993 kaq shumë, saqë atletët e Korabit përbënin boshtin e ekipit kombëtar, si Meleq Selmani, Meliha Seferi, Arta Agolli, Qemiran Spahiu, etj. Ajo ishte koha e artë e sportit në Dibër dhe Haki Duka ka meritë të pamohueshme në këtë aspekt.

Dita olimpike e vrapime dhe Java olimpike - Peshkopi 2007. Me shkollarët 9-vjeçar e të mesëm.



Korabi e mbyll renditjen në tabelën e klasifikimit me 11 pikë, gjashtë pikë larg dy vendeve më sipër, Laçit dhe Flamurtarit. Dhe kështu që rriten vështirësitë e qëndrimit në kategorinë superiore.

S'ka shtëpi për Korabin!

Korabi e nisi me humbje fazën e dytë të Superligës ndaj Laçit me rezultatin 1-0. Kjo ndeshje pritej të zhvillohej në Peshkopi, por një ekip i Federatës Shqiptare të Futbollit, pas inspektimit në terren, arriti në përfundimin se fusha nuk është gati për t'u zhvilluar një ndeshje e kategorisë superiore.

Ekipi i Korabit shkoi në Elbasan për të marrë një fitore ndaj Laçit. Për këtë ishte përgatitur trajneri Gerd Haxhiu. Por ndëshkimin ka ardhur që në minutën e tretë të ndeshjes, pas një goli të diskutueshëm për pozicion jashtë loje.

Drejtuesit e ekipit kanë shprehur rezerva për gjykimin e ndeshjes nga kryesori Olsi Sokoli, sidomos rastin e mungesës së një penallti ndaj një ndërhyrje të gabuar në zonë ndaj sulmuesit Ardit Hoxhaj.

Korabi e mbyll renditjen në tabelën e klasifikimit me 11 pikë, gjashtë pikë larg dy vendeve më sipër, Laçit dhe Flamurtarit. Dhe kështu që rriten vështirësitë e qëndrimit në kategorinë superiore.

Ekipi bëri ndryshime gjatë muajit janar. U afruan pranë ekipit Ardit Hoxhaj i cili më parë ka luajtur me ekipin e Skenderbeut ashtu si dhe Paulo Ivani, mesfushoret Besmir Arifaj nga Dinamo dhe Veton Shabani nga klubi Trepça 89 në Kosovë.

Më parë drejtuesit e ekipit larguan nga ekipi Erkan Spahine, Rudin Nakon, Nderim Nexhipin, Emiljano Veliajn, Andi Priftin, Vangjel Zguron dhe Dusko Dukiç.

Foto © Rruzhdi Xhediku

Korabi gjatë kësaj periudhe ka kaluar përmes disa vështirësive që mund të klasifikohen normale për një ekip pa përvojë në Superligë. Financat e pastabilizuara dhe mungesa e një fushë ku të luhen ndeshjet pritëse është një problem shumë i madh për një ekip në superiore.

AFRIMET E REJA DHE SHPRESA PËR MBIJETESË

Ekipi i Korabit duket se e kanë shoqëruar probleme gjatë gjithë fazës së parë. Problemi i fushës për të luajtur e kanë çorientura ekipin dhe tifozët. Në fillim në Selman Stërmasi por kontrata u ndërpre pas barazimit me Tiranën.

Po ashtu në Kukës, pas një barazimi me ekipin vendas Korabi detyrohet të dalë në kërkim të një stadiumi të ri. U fol për fushën e Terbunit të Pukës, por ndeshja e radhës u luajt në Peqin, ku ekipi mori një fitore.

Ndërkohë punimet në stadiumin e Peshkopisë filluan disa ditë para Vitit të Ri, por ndërsa ndeshja e parë pritej të luhej mes sportdashësve, u desh sërish që "mikpritja" dibrane të shtrohej në Elbasan Arena. Por Korabit i duhen gola në portë dhe fitore që të mbijetojë."Do preferoja të shënoja gola me vlerë pikësh. Nuk mund të premtoj sa gola do shënoj, por shpresoj të shënoj gola me vlerë pikësh pasi këto i nevojiten më shume ekipit për momentin, duke qenë se është në një situatë të keqe për pikë", tha për tifozët përmes faqes zyrtare të KF Korabi sulmuesi i sapombërritur në ekip, Ardit Hoxhaj.

Edhe trajneri Gerd Haxhiu i ka shprehur ambicjet për mbijetesën e Korabit në superiore. "Largimet kanë qenë të paralajmëruara, tha ai për Supersport më 20 janar, sepse që në ditët e para të janarit kur kemi filluar stërvitjen iu kemi komunikuar lojtarëve që asnjëri këtu nuk e ka vendin e sigurt. Çdokush nga i pari dhe i fundit, në qoftë se sheh që pozita e tij lëkundet, mund të shohë për ndonjë skuadër tjetër".

"Në fazën e tretë do të hedhim një hap shumë të rëndësishëm për qëndrimin në Kategori. Pastaj në fazën e katërt do të konfirmohemi besoj në mes të tabelës", thekson ai qëllimet e klubit të Korabit në këtë sezon.

Korabi pritet që ndeshjen e radhës ndaj Skënderbeut ta luajë në Peshkopi, pasi kushtet e vendosura nga vëzhguesit e FSHF janë plotësuar, thanë burime nga Klubi.

Korabi gjatë kësaj periudhe ka kaluar përmes disa vështirësive që mund të klasifikohen normale për një ekip pa përvojë në Superligë. Financat e pastabilizuara dhe mungesa e një fushë ku të luhen ndeshjet pritëse është një problem shumë i madh për një ekip në superiore. Ndërsa financat theksohet se janë të zgjidhura nga donatorët, tashmë mbetet vetëm rikthimi i fushës në parametrat e kërkuara, për ta parë Korabin të luajë dhe të fitojë në shtëpi...

Korresp. "Rruga e Arbrit"

Foto © Rruzhdi Xhediku

Ndërsa financat theksohet se janë të zgjidhura nga donatorët, tashmë mbetet vetëm rikthimi i fushës në parametrat e kërkuara, për ta parë Korabin të luajë dhe të fitojë në shtëpi...

Letër në redaksi

Jam Pertefe (Domnori) Leka.

Lexova në gazetën tuaj një shkrim me rastin e 100 vjetorit të shkollës shqipe të Allejbegisë dhe simpoziumin që do të mbahet në muajin prill 2017.

Në pasqyrën që ishte përgatitur nga artikullshkruesi, ishin shkruar emrat e mësuesve ndër vite.

Emri i babait tim nuk figuronte, por në krye të artikullit ishte vendosur fotografia e babës Jahja Domnori, bile e shkruar gabim (Demneri).

Për t'i shërbyer historikut të arsimit në Dibër e shoh me vend që të kontribuoj sadopak për punën që ka bërë im atë në atë krahinë.

Im atë është emëruar mësues dhe ekonomat në Internatin e Kastriotit më 1928 dhe ka qëndruar deri 1931. Për këtë do t'ju dërgoj shkrimin përkatës, materialin e kam marrë nga shkrimet që ka lënë im atë në Fletoren "Jeta ime".

Im atë, Jahja Domnori, është emëruar mësues në Allejbegi në vitet e para pas çlirimit 1945-'46-'47. Baba ka marrë pjesë në ndarjen e reformës agrare dhe me ndihmën e fshatarëve ka ndërtuar shkollën e re.

Qëndrimi i tij ka qenë në shtëpinë e Kadri Demirit. Në atë shtëpi kam qenë edhe unë me nanën dhe në atë shtëpi ka lindur edhe vëllai im, Kujtim Domnori me 1947. Kanë kaluar më shumë se 70 vjet dhe ne e kemi ruajtur miqësinë me atë familje, paçka se prindërit tanë nuk janë më. Para dy muajsh kam takuar

Demir Osmanin, djali i Kadri Demirit, i cili si sot edhe në kohën e diktaturës ka punuar me të njëjtin ritëm pune për sistemin rrugor, atëherë në hekurudha e sot në rrugë të reja, për t'i dhënë frymëmarrje Atdheut. I shkrova këto për të vërtetuar se im atë ka qenë mësues në Dibër dhe ka kontribuar ndershmërisht.

Edhe për këtë periudhë do t'ju dërgoj shkrimin përkatës,nga shënimet e babës tim.Shpresoj të më mirëkuptoni, sepse jam çuditur se si në periudhën e parë pas çlirimit kur im atë ka qenë mësues në Allejbegi nuk figuron emri tij.

Për J.Domnorin kanë shkruar Prof.Dr.Musa Kraja, Prof. Islam Dizdari, Prof.Faik Luli...

Duke ju uruar Vitin e Ri, dëshiroj të realizohet ëndrra e dibranëve "Rruga e Arbërit".

Materialet e shkruara nga im atë do të përpiqem t'i sjell sa më parë.

Respekt,
Pertefe Domnori Leka

Shënim i redaksisë:

E nderuar znj. Domnori Leka,

Duke ju uruar një vit të mbarë dhe me gëzime, gjejmë rastin t'Ju kërkojmë ndjesë për gabimin në tekstin për përvjetorin e shkollës së Allajbegisë, botuar në numrin e dhjetorit të gazetës "Rruga e Arbërit".

Ne besojmë se ngatërresa në emërtimin e fotografisë apo mospërmendja në shkrim nuk është një veprim i qëllimshëm.

Shkrime të tilla që kanë synim kujtesën historike nuk i nënshtrohen një redaktimi të thellë, sepse ne kemi besuar dhe vazhdojmë të besojmë se miqtë tanë nuk përpiqen që me të tilla shkrime të manipulojnë apo të ndryshojnë të vërtetën.

Në numrin e ardhshëm të gazetës, me rastin e Festës së Mësuesit, redaksia do t'i kushtojë një numër special mësuesve dhe me këtë rast do të kemi një portret të posaçëm për mësuesin Jahja Domnori.

Faleminderit

talente

Marko Alia: Pikësynimi im është të marr thirrje për në Kombëtare edhe në kategoritë më të larta dhe ndoshta një ditë të luaj në Evropian

Marko Alia, kënaqësi e madhe **në shtëpinë e Lacios**

Foto: De Cesaris / gazzettaregionale.it

Marko Alia, 17 vjeçari dibran, është njëri nga talentet e rinj të Lacios. Alia luan si portier me ekipin e U17 të Lacios dhe në mbyllje të fazës së parë të kampionatit për këtë moshë u shpall njëri nga 11 lojtarët më të mirë.

"Gjatë pjesës së parë të sezonit djaloshi bardhekaltër ka pasur ditë të vështira, por ai nuk është dorëzuar dhe ka arritur paraqitje shumë pozitive. Për ta vërtetuar këtë, ka ardhur së fundmi dhe ftesa për t'u bërë pjesë e kombëtares Italiane në kategorinë U17. Kjo është një provë e pakontestueshme se sa është pjekur ky lojtar", shkruan për Alinë "Gazzetta Regionale.it", në një shkrim kushtuar 11 lojtarëve më të mirë.

Po kjo gazetë i kushtoi edhe një shkrim të posaçëm djaloshit dibran, i cili ishte i përzgjedhur nga tekniku i kombëtares italiane për moshat, Emiliano Bigica.

Nga 60 lojtarë të mbledhur, Alia ra në sy për talentin e shfaqur në portë.

"Një nga të përzgjedhurit e teknikut ishte dhe portieri Marco Alia, shkruan Gazzetta Regionale.it, i cili luan me U17 e Lacios. Alia gjatë turneut luajti si portier i skuadrës së Jugut, dhe në ndeshjen me skuadrën e të përgjedhurve të Veriut të Italisë skuadra e Jugut fitoi 2-0, ndërsa në ndeshjen me skuadrën aktuale të kombëtares italiane U17, Jugu fitoi 3-2.

Në shkrimin e saj gazeta sportive italiane shkruan se "Duke u shprehur për emocionet e thirrjes për të luajtur me të kaltërit, Alia thotë: "Jam shumë i lumtur për thirrjen që më është bërë për të luajtur me Kombëtaren,

Portieri dibran i të rinjve të Lacios po shkëlqen në ekipin kombëtar të të kaltërve U17. Alia pas ndeshjes së parë me të kaltrit: "Puna e mirë, të shpërblen gjithnjë".

Marko është tani një lojtar që premton dhe me vendosmërinë që ka treguar tani i ka të gjitha mundësitë që të bëhet një portier i mirë. Atij nuk i mungon vullneti për të punuar dhe për të kërkuar çdo ditë e me shumë nga vetja"

por gjithashtu mund të them se nuk jam suprizuar shumë, pasi jam i bindur se puna e fortë të shpërblen gjithnjë. Unë jam stërvitur shumë dhe gjithashtu gjatë lojërave kam luajtur shumë mirë. Pavarësisht, emocioni është shumë i madh, sidomos kur mendoj se do të vesh bluzën e Kombëtares italiane, si dhe të hyj në Coverciano, ku luajnë kampionë të vërtetë. Mendoj se kjo është ëndrra e çdo fëmije, dhe unë kam arritur ta realizoj, dhe gjithashtu e marr si një stimul për të vijuar të jap maksimumin edhe më tej."

Alia i ka idetë shumë të qarta dhe vijon të shprehet për GazzettaRegionale.it: "Këtë përvojë e konsideroj një pikënisje, pasi pikësynimi im është të marr thirrje për në Kombëtare edhe në kategoritë më të larta, dhe ndoshta një ditë të luaj në Evropian. Jam i vetëdijshëm që duhet të punoj akoma shumë, shumë, shumë. Nga një sezon në tjetrin jam përmirësuar, dhe e ndjej se në çdo ndeshje që luaj fitoj më tepër siguri. Gjatë këtij sezoni kam marrë shumë oferta për të luajtur me skuadrat e të rinjve (Primavera), dhe kjo e pasuron bagazhin tim."

Sektori i te rinjve të Lacios është në rritje e sipër e këto shembuj tregojnë se shqiponjat e reja po vishen me bluzat e kaltra gjithnjë e më shumë. Kënaqësi e madhe në shtëpinë e Lacios.

Babai i Markos, Gazmir Alia, është nga ata shqiptarë që e ka gjetur lirinë e tij përmes punës dhe sakrificave. Ai ka ikur me gomone në Itali në vitin 1996, dhe tani është njëri nga modelet e suksesshme të emigracionit shqiptar.

Ai thotë për gazetën "Rruga e Arbërit" se është përpjekur të trashëgojë tek i biri vullnetin dhe pasionin për të fituar përmes punës atë që i takon .

"Marko është tani një lojtar që premton dhe me vendosmërinë që ka treguar tani i ka të gjitha mundësitë që të bëhet një portier i mirë. Atij nuk i mungon vullneti për të punuar dhe për të kërkuar çdo ditë e me shumë nga vetja".

Gazmiri tregon se Markon e kanë ndjekur në stërvitje edhe Bogdani dhe ndoshta në ditët që vijnë një ftesë nga ekipi kombëtar shqiptar i kësaj moshe mund të shkojë.

Por mes dilemave nëse do të luajë për U17 të Shqipërisë apo Italisë në të ardhmen, Marko nuk preferon të përgjigjet. "Energjitë e mia janë të fokusuara te stërvitja. Të tjerat do t'ia lëmë kohës", - thotë ai.

Alia është i dyti lojtar nga Fushë-Alia që luan në ekipet e moshave në Itali. Talenti tjetër quhet Aleksandër Përnezha, i cili luan si sulmues në ekipin e Albereta San Salvi, për moshën U20, për të cilin mediat e përtej detit nuk kanë munguar t'i thurin elozhe.

Përgatiti: **Edval Zoto**

Skema e 11-shes më të mirë për fazën e parë të U17. Në portë Aliaj. gazzettaregionale.it

Talenti që mahnit Londrën

Julian Kullani - 10 vjeçari që ka shënuar 100 gola!

Një faqe e postuar në rrjetet sociale me emrin e djaloshit simpatik Julian Kullani, vërtet më tërhoqi, madje më emocionoi, jo vetëm si gazetar sportiv, por edhe si dibran. Ky talent i vogël, ka katër vite që ka nisur të luajë sportin e bukur të futbollit, në qytetin ku prej vitesh jetojnë prindërit e tij. Por falë cilësive të jashtëzakonshme, goditjeve të forta në portë, shpejtësisë së aksioneve, teknikës së lartë dhe nuhatjes para portës, Juliani është kthyer në një lider të vërtetë për grupmoshat e U-10 Dragonis Londër, duke kaluar shifrën e 100 golave, pikërisht në ndeshjen e fundit të grupmoshave atje. Golat e tij, shpeshherë postohen në faqen sociale në fb, që tashmë promovohet edhe nga dibranët dhe shqiptarët e Londrës.

Babai i tij, Florenx Kullani nga Luznia, natyrisht që ka meritën jo vetëm si prind duke e mbështetur djalin e tij, por edhe në ndjenjën patriotike që i ka ushqyer Julianit të vogël, që para çdo ndeshje me ekipet rivale, veprimi i parë që bën, është shqiponja me duar. Ndoshta që tani është shpejt të flitet për ëndrra apo qëllime të tij, por fjala që përdor më shpesh djaloshi dibran i futbollit anglez, është kombëtarja e Shqipërisë. Duket se një talent i ri po bëhet gati dhe shpresojmë që kontributi i tij të vijë edhe në kombëtaren tonë të futbollit, e cila ka nevojë në të ardhmen për yje të tillë. *D.Methasani*

Rruga e Arbërit nr. 129

Si nuk kanë të ftohtë këto vogëlushë nga Bulaçi? Apo shpirti i tyre rrezaton energji. E ndoshta e ftohta e acaruar zbutet. Po ku? Shtatet e vogëlusheve, energji prodhojnë... Nga shpatet e Runjës forcë, energji marrin.

skicë

Fredi i vogël me **zemër të madhe**

Nga **Dionis XHAFA**

Tirana, e madhe disi në raport me qytetet e tjera shqiptare, ofron argëtim, kënaqësi, dëshirë paksa për të jetuar, por se edhe kaq padrejtësi, realitet të ashpër, e tillë shndërrohet heraherës. Kryeqyteti është i ashpër për njerëzit normalë në kuptimin fizik të fjalës, e lëre më pastaj për ata që për një apo tjetër arsye, në jetë kanë pësuar ndonjë dëmtim fizik, vuajnë nga ndonjë sëmundje apo janë shtresa të margjinalizuara të shoqërisë.

Dhe, në këtë lloj kategorie shoqërore janë shumë njerëz e ndër ta edhe një aktor, me origjinë nga Peshkopia, me banim në Tiranë, Fredi i Madh.

Prapë, edhe Fredi i Madh druaj ta quaj për shkak se nuk dua që asnjë person të jetë në shoqëri më superiori, më lart se të tjerët apo të ushtrojë pushtet apo presion mbi qenie të tjera, njerëzore më së shumti. Por si e takova Fredin? Isha ulur te kafe "Agolli" pranë qendrës së Tiranës, kur aty e vë re aktorin e njohur që e kisha parë edhe në televizion.

E kisha parë atë edhe më herët, por se kisha hezituar që t'i flas, se ku i dihet se çfarë reagimi mund të kishte. Por se kur e pashë ashtu të vetmuar e mora guximin që t'i flas. Në fakt, derisa ai është një aktor që është shfaqur edhe në ekran, kisha disi edhe droje që t'i flisja, t'i afrohesha, e lëre më pastaj të bëja me të muhabet shtruar.

Por, se sapo nisa të prezantohem me të, si një gazetar në fakt, por edhe si qytetar t'i isha afruar, njëlloj do të ishte me shumë mundësi, pasi direkt më tha se ishte i gatshëm për bisedë. Nisëm të flasim. I thashë se me origjinë jam nga Dibra, nga Shupenza, por rritur në Maqellarë. Ai më tha se më parë kishte jetuar në Peshkopi, ndërsa kishte shumë kohë që jetonte në Tiranë. Por se cili ishte problemi i vërtetë i Fredit? A ishte problemi i vetëm i tij shtatshkurtësia apo kishte problem edhe më të mprehtë se kaq? Në fakt, shtatshkurtësia e Fredit nuk është se shfaq ndonjë problem të madh, pasi atë e kishte për shkak se kishte vuajtur nga një sëmundje që kur kishte qenë i vogël, por se problem kyç ishte fakti se atë e kishin larguar nga puna, nga Teatri i Kukullave, e kishin nxjerrë mes katër rrugëve, pa i dhënë ndonjë motiv dhe se ai nuk dinte më se ku ta gjente drejtësinë. Mu lut që problemin e tij ta trumpentoj, të shkruaj një artikull, mirëpo te gazeta ku punoj nuk mundesha, e andaj jam vonuar për të pasur një artikull për Fredin.

Por çfarë është sot Fredi në fakt? Ai është metafora më e qartë se sistemi ynë, politik në radhë të parë e shtyp, e ndrydh, e vret të dobëtin, të ndryshmin, të pamundurin. Fredi ishte sikundër çdokush nga ne në ato çaste, kur mbetemi vetëm në mes të katër rrugëve, braktisur prej të gjithëve, tradhtuar politikisht, moralisht e njerëzisht. Ashtu, humbur në rrotën e një sistemi që e shkatërron të dobëtin e të vobegëtin. Me trishtim e kujtoj momentin kur pasi këmbyem muhabet, Fredi iku me ngadalë ashtu paksa vështirësisht, duke ecur rrugëve të gjera të kryeqytetit të madh, që varros njerëzit e vegjël me zemër të madhe.

Por çfarë është sot Fredi në fakt? Ai është metafora më e qartë se sistemi ynë, politik në radhë të parë e shtyp, e ndrydh, e vret të dobëtin, të ndryshmin, të pamundurin. Fredi ishte sikundër çdokush nga ne në ato çaste, kur mbetemi vetëm në mes të katër rrugëve, braktisur prej të gjithëve, tradhtuar politikisht, moralisht e njerëzisht.

Disa të dhëna rreth Fredit për aktivitetin e tij në Teatrin e Kukullave

Alfred Zeneli, ky është emri i vërtetë i aktorit. Ai ka nisur punë në Teatrin e Kullave në vitin 2005. Fredi ka imituar një sërë rolesh, ndër ta edhe kafshë. Kështu, Fredi ka luajtur rolin e arushit, ketrit. pinguinit, rolin e Titit, ky një fëmijë i vogël 6-7-vjeçar, të ufos, ariut, të një indiani, urithit, sikundër ka pasur edhe role të veçanta për çdo fund të vitit. Ai shprehet se ka luajtur edhe rolin e virusit të kompjuterit. Fredi thekson se asnjë prej shfaqjeve që ka luajtur, nuk ka dalë nga repertori i tij.

Qeshuní vogëlushë!

Nga Dr. **Selman MEZIU**

Bardhësi. Bora në degët e pemëve duket si pulëbardhë. Bukuri e dhurueme prej stinës. Acar që të ftoh gjithkund. Por jo shpirtin e vogëlushëve. Ato sikur janë miqësuar me borën e shkriftueme. Drejt shkollës çapiten me kam nën e mbi atë. Çantat me libra varun në supe nuk i ndjen. Çizmet blu me cirka akulli e bore shkëlqejnë. Veshje dimnore që më ther në shpirt. Asht apo nuk asht e tillë? Ftohtësia e dimnit shkak shtatores të ngrime. Ajo projekton deri në gdhendën e fundit të shpirtit veç ftohtësi. Por ato qeshin. Ju nuk e shihni ato buzëqeshin. Mezi iu duken dhëmbët e vegjël. Por megjithatë ato qeshëzojnë amël. Si zogjtë e malit që pranë derës së shtëpisë gjejne thërrime të hedhura mbi borë. Peisazhi i bardhësuar, veshur me ngjyra që lëvizin. Gëzimi i tyre trem borën për qark. Ato iu ngjajnë fluturave. Po atyre që nuk struken. Nuk tremben. Nuk fshihen. Zaten jane gjithnjë në fluturim.

Ndalemi tek veshja se diçka më dëfton. Ajo kullon vner varfanjakësh. Sigurisht të dhjetëvjeçarit të dytë të shekullit të njëzetë e njëtë. Xhaketa të holla, me xhepa mërthyer. Me komça ngjyrë ylberesh, paksa të akullzuar. Dëftojnë tregjet nga ku kanë ardhun. Trikot të ngjyeme në fabrikat e Evropës. Pantallona e tuta festival ngjyrash. Uji i borës ftohsja e kërcijve të kamëve. Se ajo trufullon me gjithë trupin e tyne, Kokat e qethura lajmtar pranvre. Edhe pse erërat e ftohta mpijnë e ngrinë gjithçka. Do të vijnë burra të fortë. E gra që e durojn kafshimet e dimnave të acartë. Valle kjo të jetë arsyeja?

Por ato qeshin si në shenjë gëzimi, përzier me acarin e dimrit. Ndoshta ndjesia që iu ngjall peisazhi! Ato e mposhtin atë në rropamat e mëngjeseve. Duart e ngritura, furtuna lirie. Dy gishtat, biles dhe katër, shpresë demokracie. Fëmijët janë imitonjës. Ato kopjojnë. Kopja e nanës, babës e mësuesve ato janë. Vogëlushët ngultas shikojnë. Pulëbardha borë iu hakërrehet, t'i mposht, t'i dobësoi. Por...

Bota e tyre e qetë, pa djallëzira. Shikojnë përpara. Dikush me sytë, drejt vështron. Por ndonjë bardhësia e verbon. Prandaj ato kështu si në rrjesht ngjyrat e rrobave sikur i qetëson. Si nuk kanë të ftohtë këto vogëlushë nga Bulaçi? Apo shpirti i tyre rrezaton energji. E ndoshta e ftohta e acaruar zbutet. Po ku? Shtatet e vogëlusheve, energji prodhojnë. Kjo duhet të jetë dukuri biologjike. Apo procese biokimike? Nga shpatet e Runjës forcë, energji marrin. Natyra iu skalit tipare të forta. Ajo i kalit fizikisht. Ndaj ato nuk tremben. Ato qeshin. Ndoshta pak por ama qeshin. Kjo, pse jo, iu rrezaton energji. Prandaj bora rrin urtë poshtë çizmeve të tyre.Kur ulen në banka e ftohta sulmon. Se edhe ato e dinë se lëvizja energji prodhon. Edhe zemra e tyre më shume gjak pompon. E mushkëritë oksigjen thithin përmes udhëve plote dredha. Tani soba duhet të ndizet. Se përndryshe shkumsi në dorë iu dridhet. Sot nuk kishte dru. Dhamët iu grindën mes tyre. Çizmet prodhuan të ftohtin. Prandaj kamët filluan t'iu dridhen. Mallkuar qofshi! Ofshajnë ato. Urrejtja ju buron idhnueshëm nga shpirti i njom. Nuk iu hynë në tru asgjë nga shpjegimi. Se buzët u dridhen nga e ftohta e kobshme. Ato nuk qeshin ma, se buzët filluan t'iu nxihen. Dikush nga shtatë vjeçarët, lotët filluan t'iu rrjedhin.

Ato nuk munden me durue. Udhën e gjatë u nisën me e marr. Ecin ashtu si në rresht. Kjo e diktuar nga bora. Nga ftohtësia, nga stuhia që copza akulli iu hedh në fytyrë. Ato ashtu ngrohen ne avujt e njani tjetrit. Ne rrezatimin e zemrave të njoma. Po edhe të dashurisë fëminore. Bora bie flokë flokë. Por, ato guximtarët vogëlush, ecin. Hapat i kane të vegjël por kam shpejt ama. Përfytyrojnë zjarrin në votër. Bukën e ngrohtë të rreshkur në prush. Nanat që i presin krahë hapur. Sigurisht me kujdes e dhemshuri nane. Prandaj ato qeshin përsëri edhe lozin. Edhe pse bora flokëzon akoma. Ndërsa veriu dhamët e egra ju tregon. Por ato stuhia nuk i pengon. Ndoshta prandaj qeshin. Bota e tyre e vogëlz pranverë luleshumë tregon. Prandaj qeshuni vogëlush. Bota e juaj nuk njeh dimër. Natyrën juve në gji e futni. Zjarm nga trupi juaj i dhuroni. Ndaj ajo qesh bashkë me juve. Edhe pse ka fustanin e bardhë të nusërisë së dimrit. Ndaj qeshni!

kulturë

Hazis Ndreu ishte njëri ndër njohësit më të mirë të trevës dibrane, meqë është autor i disa studimeve historike.

"Hazis Ndreu me nëntë fusha"

Nga **Arsim KOLARI**

Hazis Ndreu është një figurë e madhe e artit dhe historisë sonë kombëtare. Talenti i tij, qysh në fëmijëri ka reflektuar bindshëm në disa fusha artistike, ndaj jo më kot artisti ynë i talentuar Bujar Kapexhiu, tha: Dibra me nëntë male, Hazis Ndreu me nëntë fusha! E kishte fjalën për: aktor, poet, këngëtar, studiues, valltar, koreograf, instrumentist, etnograf e folklorist.

E vështirë është të merresh e të perfeksionohesh vetëm në njërën nga këto fusha. Angazhimi i Hazisit në kaq lëmi, flet për dhuntinë e tij që habit çdo intelektual, e habia më e madhe krijohet në momentin kur e sheh këtë artist të jetë i përpiktë, i përkushtuar dhe tepër i suksesshëm në nëntë fushat e përmendura. Fillet e karrierës, në moshë fare të vogël, i nisi në estradën profesionale të Peshkopisë, fillimisht si aktor, koreograf, këngëtar e instrumentist.

Hazis Ndreu u njoh si një ndër aktorët më të mirë të skenës ku performoi, me zemër të madhe për secilin rol që merrte. Të gjithë ata që e njohën tregojnë se atë kurrë nuk e gjenin të rraskapitur, me gjithë lodhjes që patën ofruar provat për shfaqjet e rolet e ndryshme. E kjo, sigurisht ka ndodhur nga mishërimi me rolet e tij, dhe nga prirja e tij natyrore t'i përgjigjet çdonjërit në pyetjet që i parashtronin me alegori dibrane. Në vitin 1983 u botua vëllimi i parë "Tregime alegorike dibrane", pastaj vëllimi i dytë "Alegori dibrane". Vëllimi humoristik "Ordinanci" me rastin e 30 vjetorit të çlirimit të atdheut (1974) ku mori çmimin e dytë në konkursin kombëtar të letërsisë, organizuar nga Ministria e Kulturës dhe "Lidhja e Shkrimtarëve e Artistëve të Shqipërisë".

Vepra e tij poetike është një shpërthim i ndjenjave personale, sidomos në ciklin e poezive atdhetare, ku Hazisi e lidh Dibrën me heroizmat e saj kundër pushtuesve osman dhe sllav. Ka krijuar me mijëra vargje epike, lirike dhe satirike. Kemi vëllimin "Ushtima e Maleve" (1961), "Valët e Drinit të Zi" (1966), "Një trim i Skënderbeut në Dibër" (1969) dhe "Këngë e vargje rapsodike" (1971).

Kush më mirë se ai diti dhe dijë të këndojë natyrshëm këngën dibrane?! Asnjë deri më sot nuk i është afruar, sepse kënga e tij, edhe ato që s'e dëgjojnë këtë lloj muzike, i bën të ndalojnë e të shijojnë zërin e tij melodioz, tingujt plot variacione të melodisë me çifteli, e duke i dhënë çdo note shpirt rapsodi. Vulën e tij mbajnë këngët: "Hajredin Pasha po vjen Radikës", "Elez Isufi arusha e maleve", "Kënga e Suf Xhelilit", "Vijnë pamoprat përreth detit", "Kënga e Mahmut Dac Kalisit", "Moj fusha e Korabit" (kënduar nga Lirie Rasha), "Sa për hatër të vatanit", "Kënga e Sul Markes", e mjaft këngë të tjera të punuara edhe për artistë të tjerë. Thuhet se në konaqet ku ka kënduar Hazisi, burrat kanë hequr kësulat për respekt dhe kanë derdhur lotë trimërie duke dhënë urata për të.

Hazis Ndreu ishte njëri ndër njohësit më të mirë të trevës dibrane, me që është autor i disa studimeve historike. Ai, pas një pune 22 vjeçare rreth studimit për fisin e Katriotëve dhe Skënderbeut, dëshmoi se ai rrjedh nga Sina e Katriotit, solli studimin me vlera të mëdha njohëse e edukuese. Hazisi ishte i shquar veçanërisht për studimin e fushës toponomastike, me anë të së cilës autori na njeh me traditat tona, vyrtytet, atdhetarizmin e popullit dibran. Në studimet e tij historike, Hazisi ka përdorur mitologjinë, teologjinë, filozofinë, folklorin, por nganjëherë edhe politikën.



Karrikaturë nga Bujar Kapexhiu.

Hazisi Ndreu e njihte fort mirë folklorin dibran. I gjurmonte dhe i përpunonte këngët e vallet që këndoheshin nëpër sebepe dibrane, për t'i risjellë pastaj si të rralla e t'i vishte me petkun më të mirë artistik. Hazisi e ndriçoi folklorin dibran me këngët dhe alegoritë që i kishte "në majë të gjuhës" e që i vinin në shprehje kur lypsej...

Si valltar virtuoz, ai qysh në moshën 20 vjeçare mori pjesë në të gjitha festivalet kombëtare e ndërkombëtare. Jo vetëm te ai vetë, por edhe te valltarët ku ka qenë koreograf, vërehej harmonia e lëvizjeve të këmbëve, kokës, krahëve, të cilat me përpikmëri i përgjigjeshin rënies së lodrës e melodisë së valles. Në ato pak minuta të koreografisë së tij, dilnin në shesh ndjenja e malli njerëzor, dhimbjet e popullit, por edhe çiltërsia e shpirtërave që dinë dhe dashurojnë jo vetëm njerëzit, por edhe atdheun. Ai diti më mirë se kushdo të koordinon dhe harmonizon vlerat e interpretuesve në hapësirë me muzikën, me të cilën përçonte mesazhe që e bënin publikun të mos mbështeste shpinën në karriget e sallave. Shquhet për vallëzimin e valles dyshe dibrane, atë të "Korabit", "Thuprës" dhe "Koxhaxhiklijen".

Nëse për Bethovenin është thënë se me sinfonitë e tij u quajt "mësues i muzikës", për Hazis Ndreun mund të thuhet se simfoninë muzikore e krijoi vetëm me dy telat e çiftelisë prej drurit të manit. Një dru i gdhendur dhe dy tela mjaftuan që ai të ndezë mallin e bashkëatdhetarëve, për të mos u shuar më kurrë. Hazisi mbushi plot 50 vjet në Radio dhe Televizione me çiftelinë në dorë, e në koleksionin e tij gjejmë me dhjetra çmime të nivelit të lartë, si kurorë e të gjithë këtyre vlerësimeve, qëndron titulli i dhënë për merita të veçanta "Artist i Merituar". Çiftelia e shndërroi atë në një mit, por edhe ai e shndërroi këtë vegël muzikore në instrument me peshë të madhe. Lirisht mund të themi, Hazisi ishte dhe do mbetet kulmi i shkëlqimit të folklorit dibran dhe atij verior.

Dibra është e njohur për traditën e saj të pasur të artizanatit me vlera të çmuara, të krijuara prej shekujsh nga mjeshtrat e saj popullorë, por me ardhjen e Hazis Ndreut në skenë, si të thuash, lulëzoi edhe fusha e etnografisë dibrane. Veç se shkroi për traditat dibrane, ai i zhvillonte ato nëpër dajlet skenike, siç kemi lojërat e ndryshme e anekdotat. Kur jemi te veshja tradicionale dibrane, ai u paraqit gjithnjë me kostumin e përbërë nga këmisha e bardhë me kopsa, jeleku me sumbullat e tij dekorativ, tirqit e bardhë me gajtanë të zi, e sipër këtij kostumi me tirq vente dollamën. Plisi apo kësula (siç quhet në Dibër) ishte e formës së rrumbullakët anash, dhe e rrafshtë në pjesën e sipërme. Natyrisht, edhe opingat ishin specifike, me formë të mprehtë te gishtat dhe rripin që e shtrëngonte mesin e këmbës. Por, mbi të gjitha, rreth brezit të mesit, te Hazisi gjeje kurdoherë armën e quajtur "e brezit të krahut", për të cilën po ta pyesje, përgjigjej: "Kështu hedhim valle ne nga Veriu, me hekura në brez". Kjo mbase e bënte të quhej "koka" e Dibrës.

Hazisi e njihte fort mirë folklorin dibran sipas zonave. I gjurmonte dhe i përpunonte këngët e vallet që këndoheshin nëpër sebepe dibrane, për t'i risjellur pastaj si të rralla e t'i vishte me petkun më të mirë artistik. Folklori dibran jo që nuk ishte i avancuar, por atë Hazisi e ndriçoi me këngët dhe alegoritë që i kishte "në majë të gjuhës" e që i vinin në shprehje kur lypsej. Kush e njeh odën dibrane, pa dyshim di të çmojë emërtimin "burrë ode", emërtim ky i cili nuk fitohet kollaj e nga kushdo. Mirëpo, Hazisi, sipas gjithë kësaj, del se ka qenë i lindur me këtë emërtim, e le më në moshën e thinjave që i shkonte më tepër se kujtdo.

Krijimtaria e tij, ashtu si edhe vetë jeta, u ndërpre përnjëherë, mu në hovin e një shpërthimi edhe më të madh. Ajo mbeti një vepër e papërfunduar, me të gjitha shkëlqimet e përvojën e një talenti të lindur, që s'pati kohë t'u vërë "pikën" krijimeve të tij. Kështu e themi, sepse Hazisi la në dorëshkrime librat "Nëntë Malet e Dibrës", romanin "Lufta e Dohoshishtit", dramën "Dasëm pa nuse", etj. Në përgjithësi, veprimtaria e të madhit Hazis Ndreu, me tonin e vet specifik, e bën të dallueshëm nga gjithë intelektualët e kohës, dhe natyrisht të pavdekshëm për artin, letërsinë e historinë dibrane, pastaj edhe mbarëshqiptare.

Jordan Daci, dibrani që dëshiron të bëhet Avokati i Popullit

Qysh se është formuar shoqëria njerëzore, u vu re se i forti e rrihte të dobëtin, se njeriu që kishte pushtetin bënte çfarë të donte me të papushtetshmin dhe se kishte shumë padrejtësi të kësaj natyre. Atëherë, kryesisht filozofët e lashtësisë menduan se duhet instancë e drejtësisë, që të vendosë balancat, që të dënojë të fortin në rast se abuzon me të dobëtin, mos të letjohet padrejtësia, mos të shkatërrohet natyra, mos të preken liritë themelore të njeriut. Kohët kanë evoluar në dekada e në shekuj dhe se edhe sot e kësaj dite ekziston një institucion, që mendon për shtresat e margjinalizuara të shoqërisë, për të diskriminuarit dhe për të pamundurit. Ky institucion quhet Avokati i Popullit dhe se mendon për shtresat në nevojë. Në krye të institucionit në fjalë dëshiron të vijë një dibran dhe se ai quhet Jordan Daci, avokat. Ky i fundit ka paraqitur kandidaturën me një CV të lavdërueshme, është i pajisur me doktoraturë, sikundër ka edhe përvojë në mësimdhënie.

Jordani rrjedh nga një familje me tradita të Dibrës, nga ato familje nga të cilat pritet që pasardhësit të dalin njerëz të zotë dhe të arsimuar. Detyra që dëshiron të marrë z.Jordan Daci nuk është vetëm post publik, politik apo institucional, por është në radhë të parë përgjegjësi njerëzore ndaj shtresave më të pamundura të shoqërisë, më të harruara, më të lëna në hije, e se urimi për të është që jo vetëm ta fitojë si një post, por të ndjejë thellësisht e moralisht se mundet të jetë "babai" i mbrojtjes të të drejtave të njeriut të të pamundurve, të lënë në cep, në katakombet e shoqërisë.

Doktoratura e fituar nga ana e Jordan Dacit është shkalla më e lartë e pjekurisë arsimore të individit e se kur kjo gradë fitohet në fushën e drejtësisë, nënkupton njohje të thellë të ligjeve e të neneve të ligjeve të Republikës së Shqipërisë.

Shpresa e madhe është që Jordani të mos njohë ligjet ashtu ftohtë, por të përpiqet mbi të gjitha të jetë njerëzor në trajtimin e çështjeve e se këta të fundit do ta bënin atë një Avokat të Popullit ndryshe, njerëzor, shumë njerëzor. Ia urojmë z.Daci të zgjidhet Avokati i Popullit, një rrugë e vështirë në mbrojtje të individëve dhe të drejtave të tyre themelore.

Dionis XHAFA

Rruga e Arbërit nr. 129

tregim

Tregime të jetuara, shkëputur nga libri në dorëshkrim "Prova e besës".
Çdo ngjashmëri me emra realë njerëzish ose vendesh është rastësi.

Dosja "gjarpri"

Nga **XHELAL ROÇI**

(vijon nga numri i kaluar)

Sigurimi i Shtetit ka qenë një ndër institucionet e kohës komuniste më të errëta dhe më të egra.

Shumë nga krimet e asaj kohe janë gatuar në ato zyra dhe sot, pas 25 vjetësh, loja me hapjen e tyre vazhdon. Pjesë-pjesë ato janë hapur, sipas orekseve të politikës, ndërsa në tregimet e jetuara të Xhelal Roçit ato "hapen" të plota: tregohen detaje, ngjarje, biseda. Por Xhelali nuk ka marrë përsipër t'i tregojë dhe zbulojë dosjet, por i sjell për lexuesit në formën letrare, si dëshmi të asaj që ka ndodhur.

Por edhe si mesazh se e kaluara nuk duhet përsëritur dhe brezat e rinj duhet t'i njohin siç kanë ndodhur ngjarjet. Vetëm kështu e kaluara nuk do të përsëritet.

Kryetari i Degës së Punëve të Brendshme të atij rrethi ishte ulur në tavolinën e punës. Ai, përveç pajisjeve të tjera, në tavolinë kishte vënë përpara një dosje me kapak blu, të mbushur me dokumente, në kapakun e së cilës, në anën e majtë, ishte shkruar me shkronja shtypi: Ministria e Punëve të Brendshme dhe, në mes, me shkronja dore e me një kaligrafi të bukur: Dosja "Gjarpri".

Kjo dosje ishte hapur me datën 20 tetor 1948, kur Sef Gurra nga fshati Katund i Epërm, bashkë me gruan e djalin e tij kishte kaluar ilegalisht kufirin dhe ishte arratisur në Jugosllavi, ku kishte kërkuar azil politik.

Sef Gurra kishte qenë partizan. Fillimisht kishte luftuar kundër okupatorëve. Pas disa kohësh kishte dezertuar nga forcat partizane dhe e kishte quajtur veten nacionalist dhe ishte bashkuar me forcat e reaksionit, që bashkëpunonin me okupatorët. Përsëri, pas gjashtë muajsh, dorëzohet tek një udhëheqës i një formacioni partizan të Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare, bën autokritikë dhe i kërkon atij t'i jepet mundësia të shlyejë fajet që kishte bërë, duke premtuar se do të jepte prova në luftë kundër nazistëve gjermanë e bashkëpunëtorëve të tyre. Nga frika se mund të zbuloheshin nga okupatori veprimet e tij për futjen me detyra zbulimi në radhët e Lëvizjes Nacionalçlirimtare, Sef Gurra, pas disa muajsh, dezertoi përsëri dhe u bashkua me forcat "nacionaliste" të Ballit Kombëtar.

Sefa u raportoi nacionalistëve se e kishte shumë të vështirë të realizonte detyrat që i ishin ngarkuar. Ata kërkonin prova pendimi dhe provat jepeshin me pjesëmarrje nëpër aksione kundër armiqve e tradhtarëve.

Ai, bashkë me bashkëpunëtorët e tjerë të okupatorëve, i përcollën gjermanët deri në Shkodër dhe vetë qëndruan nëpër male. Sefa, bashkë me shokët e tij të ashtuquajtur nacionalistë, shpresonin se do të shpërthente kryengritja e armatosur dhe me ndihmën e anglo-amerikanëve do të përmbysnin qeverinë komuniste të sapokrijuar.

Me prishjen e marrëdhënieve me Jugosllavinë, në muajin qershor të vitit 1948, Sef Gurra, ashtu si dhe shokët e tij, menduan se u krijuan mundësitë për ata që të shpëtonin lëkurën e tyre.

Pasi realizoi arratisjen, shteti i huaj e vuri menjëherë në shërbim të atij zbulimi. Për t'u aftësuar më mirë për detyrën që mori përsipër, Sefa bëri tre muaj përgatitje në një kurs spiunazhi, ku përvetësoi mirë përdorimin e armëve, luftimeve trup me trup, përdorimin e armëve të ftohta, sidomos thikën, asgjësimin e rojeve të objekteve, grumbullimin e të dhënave me karakter sekret, format e ndërlidhjes me agjenturën e atij zbulimi jashtë shtetit, marrjen në lidhje të agjenturës e tjera. Ai mësoi sesi mund të kalohet kufiri në mënyrë ilegale, si duhet t'u ruhej pritave të kundërshtarit, si duhet të vepronte për të rekrutuar agjenturë të re për llogari të atij zbulimi dhe baza ku do të strehohej vetë. Ai duhet të vepronte dhe si duhet të kontrollonte agjenturën që ai mbante në lidhje dhe bazat ku ai do të strehohej e të furnizohej me ushqime e të tjera. Gjithashtu, në kurs mësoi sesi mund të dezinformonte kundërshtarin, duke hapur lajme të rreme me anën e bazave ose simpatizantëve të tij. Si duhet të punojë për të maskuar agjenturën e tij dhe një nga porositë më të rëndësishme, që ishte edhe çelësi i suksesit, ishte ruajtja e sekreteve të punës. Sefa, gjatë kohës së përgatitjes në kurs, u dallua në përgatitje teorike, praktike e sidomos në qitje me armë luftarake, si dhe në mundje sambo luftarake trup me trup.

Organet e sigurimit të shtetit shqiptar, që gjatë kohës që Sef Gurra kishte filluar përgatitjen në kursin e spiunazhit, ishin vënë në dijeni, por për ata organe dilnin detyra të reja që kërkonin studime, punë intensive, që të përcaktonin se ku do të vepronte konkretisht Sefa, ku mund të futej ilegalisht nga ana e kufirit, çfarë detyrash do të kryente, kush do të ishin bazat dhe bashkëpunëtorët e tij. Synimi i zbulimit të huaj dihej. Ai, me anën e Sef Gurrës, shokëve dhe bashkëpunëtorëve të tij, krijonin brenda vendit turbullira, pakënaqësi dhe deri kryengritje të armatosur. Këto veprime të bëheshin shkak për të ndërhyrë nga jashtë me forca të armatosura, gjoja për të stabilizuar gjendjen, ndërsa qëllimi imediat ishte përmbysja e shtetit të ri komunist në Shqipëri.

Nga organi kufitar ishte marrë një sinjal që bënte fjalë se me datën 14 maj 1949, një grup me më shumë se dy veta kishin kaluar kufirin dhe ishin futur në thellësi të vendit tonë. Ky konkluzion ishte arritur nga këqyrja e gjurmëve në brezin e gjurmimit në kufi.

Katër ditë më vonë, qytetari Malë Driza paraqitet në organet e sigurimit të shtetit se një person i panjohur i kishte trokitur në dritaren e dhomës së katit të parë në orët e mesnatës dhe, kur ky i kishte kërkuar se kush ishte ai, personi i panjohur i kishte thënë: "Hape derën, se jam kushëriri juaj, Sefa". Malë Driza shpjegoi se, i trembur nga sa dëgjova, mora menjëherë çiften dhe qëllova në ajër. Krisma e çiftes u shoqërua me lehje qensh në fshat. Në këtë kohë, nga ana e përroit që ndan dy lagjet e fshatit, qëlloi një tjetër me pushkë në ajër. Ky duhet të ishte ndonjë pushkatar i pajisur me armë me leje nga Dega e Punëve të Brendshme.

Të nesërmen Malë Driza kishte përhapur fjalë se kishte qëlluar në një dhelpër që ishte afruar tek koteci i pulave, por nuk e kishte vrarë.

Një person, mik i organeve të Sigurimit të Shtetit, informonte se Malë Driza kishte dyshuar se mund të ishte përpara ndonjë provokacioni të krijuar nga organet e këtij Sigurimi. Në bazë të udhëzimeve të atyre organeve ai mund të kishte shkuar natën e të kishte trokitur në derë, duke u paraqitur se ishte Sefa, kushëriri i tij i arratisur.

Me këto mendime kishte shkuar të denonconte në Degën e Punëve të Brendshme.

Kryetari i Degës së Punëve të Brendshme i bëri disa pyetje:

- A kishte qenë me të vërtetë Sef Gurra?
- Çfarë marrëdhëniesh gjinore kishte Sef Gurra me Malë Drizën?
- Nga kishin ardhur dhe nga ishin larguar personat që kishin trokitur në dritare?
- Sa veta kishin qenë ata?
- Ku kishin qëndruar personat e tjerë dhe a kishte parë gjë me sy Malë Driza se sa vetë ishin?

Pas kësaj, kryetari i Degës dha urdhër që:

- Të mbahej lidhje me organet kufitare dhe të vlerësohej çdo sinjal apo gjurmë në kufi.
- Të forcohej shërbimi i ruajtjes së kufirit.
- Të dhënat dhe informacionet që do të grumbulloheshin të bëheshin objekt analize e diskutimi, duke i marrë të lidhura me njëra-tjetrën.

Qëllimi final do të ishte organizimi i kurthit, për të bërë të mundur kapjen të gjallë të pjesëtarëve të grupit që ishin futur ilegalisht në kufi.

Megjithëse kishin kaluar disa ditë, nuk ishte siguruar asnjë e dhënë apo sinjalizim tjetër për futjen e grupit në kufi.

Gjithashtu, nuk kishte asnjë reagim nga lidhjet miqësore, familjare e shoqërore të Sef Gurrës për ardhjen e tij ilegalisht në vendin tonë.

Nga analiza doli se studimi i lidhjeve të Sef Gurrës ishte bërë me të meta e dobësi dhe gjatë analizave dhe diferencimit të tyre ishin vërtetuar mangësi. Forca zbuluese ishte e pamjaftueshme dhe e paaftë për të zbuluar veprimtarinë e grupit armiqësor të Sef Gurrës.

* * *

Në Degën e Punëve të Brendshme u paraqit një person, i cili kërkoi takim me kryetarin e kësaj Dege. Oficeri i shërbimit ditor i përgjigjet me indiferencë se kryetari nuk ndodhej në zyrë dhe se ishte me shërbim jashtë organit.

– Në qoftë se dëshironi, ne mund t'ju krijojmë mundësinë të takoni ndonjë tjetër ose më shpjegoni mua hallin që keni dhe do t'ia them kryetarit kur të kthehet.

Personi i ardhur po mendohej. Oficeri i shërbimit i kërkoi t'i merrte gjeneralitetet dhe, së fundi, e pyeti përsëri se çfarë kishte për t'i thënë kryetarit.

Ai shpjegoi se quhej Sali Osmani. Ishte nga Katundi i Epërm. Ishte bari dhe punonte e jetonte në fshat. Ai kërkonte nga kryetari i Degës të pajisej me armë zjarri, pushkë, sepse në fshat kishin filluar të shfaqeshin shumë shpesh egërsirat, që po dëmtonin bagëtitë. Këtë kërkesë duhej t'ia plotësonin sa më shpejt, sepse ujku po ju futej në vathë.

Oficeri i shërbimit nuk e mori shumë në konsideratë këtë bisedë dhe mendoi se ky njeri mund të ishte me të meta mendore. Saliu e porositi edhe njëherë oficerin e shërbimit, se duhej, menjëherë, sapo të kthehej, ta vinte në dijeni kryetarin e Degës. Ai i shpjegoi se dëshira e tij ishte të takohej vetë me kryetarin dhe të bisedonte me të për këto probleme. Së fundi, ai i tha se deri në orët e vona do të qëndronte në qytet dhe do ta priste kryetarin. Në qoftë se ai nuk do të vinte, duhet t'i krijonte mundësinë ta priste në takim.

Oficeri i shërbimit e takoi me një person tjetër në Degë, i cili i shpjegoi Saliut se çfarë dokumentesh duhet të plotësonte për t'u pajisur me armë zjarri. Saliu i thotë se unë nuk kam shkollë dhe nuk di si bëhen dokumentet, prandaj duhet të takohem vetë me kryetarin tuaj. Ai di sesi vepron me mua. Unë, - vazhdoi Saliu, - nuk lidhem me letra me qeverinë, por me besë. Kërkoj që kërkesën time t'ia parashtroni kryetarit dhe ai do të gjykojë vetë sesi do të veprojë.

Kryetari, sapo u kthye, i kërkoi nëpunësit të shërbimit që ta informonte për të rejat e ditës. Atij i raportuan për disa probleme dhe e vunë në dijeni që kishte ardhur një person, i cili kishte kërkuar takim me të. Ai quhej Sali Osmani dhe ishte nga fshati Katund i Epërm. Ai kërkonte të pajisej me armë zjarri, pasi në fshatin e tij ishin shfaqur egërsirat që dëmtonin bagëtitë e futeshin nëpër vatha. Ai, para se të largohej, na tha se do të ishte në qytet deri në orët e vona. Kryetari dëgjonte raportimin dhe mendonte... Nxori njerëz që e njihnin Sali Osmanin, i porositi që po ta gjenin ta sillnin në takim. Personin në fjalë nuk e gjetën. Të nesërmen e lajmëruan dhe ia sollën në takim kryetarit. Ata u përshëndetën si dy shokë të ngushtë të një ideali. Shkëmbyen disa biseda dhe Saliu filloi të shpjegojë:

-Para tre ditësh më kishin humbur katër kokë bagëti. Pasi mbylla të tjerat, dola natën të kërkoj dhe shkela në disa vende. Kështu kaloi gati gjysma e natës. Atë natë, një bashkëfshatar i yni, Malë Driza, gjuajti me çifte, mbasi i ishte afruar dhelpra tek koteci i pulave. Pas tij filluan të gjuajnë edhe të tjerë me pushkë. Kur po kaloja afër shtëpisë së Kamber Tafës, rreth 30 metra poshtë avllisë së tij, pashë dy veta që ishin shtrirë në vijë të drejtë në distancë 4-5 metra me njëri-tjetrin, me armë ngrehur. Fillimisht nuk u vura shumë rëndësi, kalova poshtë tyre dhe bëra sikur nuk pashë asgjë. Vazhdova rrugën time. Pasi kalova në krahun tjetër dhe po ngjitesha lart rrugës që ndan pyllin me shtëpinë e Kamber Tafës, dëgjova një të trokitur të lehtë në dritaren e dhomës së katit të dytë. Personi që trokiste kishte hipur në një pemë. Nata ishte e errët, fshati ishte në qetësi. Brenda avllisë së Kamberit qentë grindeshin duke lehur. Kamberi hapi dritaren dhe po bisedonte me të.

Fillimisht mendova se ata ndoshta do të ishin njerëzit tuaj që bënin shërbimin natën, por, me sa kuptova, ishin të tjerë njerëz.

Të nesërmen kam kërkuar përsëri andej për të gjetur bagëtitë dhe kam parë gjurmë këpucësh, mbeturina ushqimesh, si dhe bishta cigaresh.

Po atë ditë në pyll, poshtë Shpellës së Gjarprit, kam gjetur mbeturinat e të brendshmeve dhe lëkurën e deles time, ndërsa mishi ishte ngrënë tek shpella, i pjekur në zjarr. Kockat akoma mund të gjenden të hedhura përreth dhe zjarri ishte ndezur brenda. Gjurmët dukeshin të njëjta me ato që ishin afër shtëpisë së Kamber Tafës. Ata ishin gjurmë këpucësh të tjera, jo nga ato që mbajnë banorët vendas.

Me sa mendoj unë, Kamber Tafa nuk ka zënë mend nga ajo "shkollë" që bëri. Po atë ditë takova Kamberin dhe i shpjegova se më kishin humbur katër kokë bagëti, të cilat i kam kërkuar gjithë natën. Të nesërmen tre kokë i gjeta, njërën ma kishin therur e pjekur tek Shpella e Gjarprit.

Ai menjëherë u zverdh fare. Dukej se po i binte të fikët dhe u ul në tokë. Nxori kutinë e duhanit dhe ndezëm nga një cigare. Kamberi ra në mendime dhe nuk gjente fjalë që të fliste.

- Në vazhdim të bisedës, - vazhdoi Saliu, - i thashë atij se, te qershia e egër poshtë shtëpisë tënde, u tremba shumë. Pashë dy vetë të shtrirë në tokë rreth 4-5 metra larg njëri-tjetrit, që qëndronin në pozicion me armë në dorë. Mbeti i habitur, pastaj e mblodhi veten dhe më tha: "Mua me ndjek qeveria, kam qenë në burg për politikë dhe më ruajnë natën. Tek unë nuk kanë besim".

(vijon në numrin e ardhshëm)

ese

Bashkia Dibër me mbështetjen e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), Agjencive të OKB-së në Shqipëri dhe me mbështetjen financiare të Qeverisë së Suedisë në bashkëpunim me Qendrën Agritra Vizion dhe AZHR me datë 9 dhjetor 2016 zhvilluan para Pallatit të Kulturës Peshkopi mbylljen e fushatës ndërgjegjësuese: "16 Ditë Aktivizim kundër dhunës ndaj gruaj dhe dhunës në familje". Me këtë rast, Zamira Gjeleshi, një nga organizatoret e veprimtarisë, përzgjodhi për gazetën disa krijime në poezi dhe prozë të nxënësve, të cilat kanë në qendër dhunën në familje. Redaksia vendosi t'i botojë këtë numër dhe numrat e ardhshëm. Ritheksojmë se gazeta mbetet e hapur për botimin e tregimeve, poezive dhe krijimeve të tjera artistike të nxënësve dhe talenteve të reja nga të gjitha shkollat e qarkut të Dibrës.

Unë zgjedh të jetoj pa dhunë

Një herë e një kohë...

"Një britmë shurdhuese,disa tinguj të një frymëmarrjeje të lodhur ,fytyrë e saj që mbytet në det lotësh dhe guaskë e krenarisë që i humb në shkretëtirën e mëkatit të tjetrit pasohen nga zhurmë hapash të një kolonizatori jetësh, nënqeshje djallëzore dhe vështrimi ulkonjar i atij,që është dhe burgu shpirtëror i asaj." Këto janë vetëm disa detaje nga qoshet e errëta të situatave ndërmjet çifteve shqiptare ,të cilat vazhdojnë të përbalten dhe në rrethanat e ditëve të sotme nga llumi i injorancës, që i ka përlyer tashmë mendimet e shumë meshkujve të prangosur nga padija.

Këta njerëz janë krijuar nga tallazet e pamëshirshme të jetës për të qenë dhe mbetur armiq të vetvetes saqë edhe në rastin kur nga qielli në vend të shiut do të binte dituria ,ata duke përdorur atë mprehtësinë " e adhurueshme" të logjikës së tyre do të nxirrnin edhe këtë herë çadrën. Ky reagim, si prej një të sëmuri psikik, meriton ngritjen e një dollie në shëndet të shkatërrimit të tyre, vetëm e vetëm për shkak të aureolës së saktësisë dhe qartësisë së padukshme dhe të paqenë që mbartin këto sjellje. Gjykimi i tyre u hyn thellësive të paeksploruara për ta trazuar edhe më tepër të vërtetën e gënjeshtërt ,që i mashtron duke u vënë frerët e arsyetimit të saktë dhe duke i endur udhëve ,që verbojnë nga errësira. Mos ndoshta ata vërtet nuk e dinë akoma se nuk ka perde ,që mbulon te vërtetën ,sepse ekzistenca e saj është kurdoherë e dukshme?

Rrota e mekanizmit shkatërrues i ka marrë me vete këto qenie duke u eliminuar elementet primarë , që përbëjnë binomin e të qenurit njeri . Duke menduar në breg të lumit ,por duke u futur edhe nëpër dallgët e këtij fenomeni si dhuna u mbërtheva pas lumit ,që solli këtë proces kaotik në shoqëri. Ky lum fryhet e merr me revan :lot,mallkime,lutje dhe falje duke metamorforizuar ligjin natyror. Kur do të kuptohet se gjërat janë krijuar për t'u shfrytëzuar ,ndërsa njerëzit janë bërë për t'u dashur? Ndaj duhet bërë kujdes ,se nuk mund të luajmë një lojë në të cilën i kemi të paqarta rregullat e saj.Teksa po u vishja mendimeve kostumin e abstraksionit duke e derdhur hijshëm në detin krijues ,iu drejtova vetes dhe i pohova "Mashkulli duhet të vërë dorë mbi femrën..." Janë pikërisht këto fjalë ,që buronin nga marrosja e pashpjegueshme dhe dhënia e pakushtëzuar kundrejt kësaj dukurie që më bënë të arsyetoj si më poshtë:

Së pari,mashkull është ai që vë dorë mbi femrën(i zgjat dorën për ta ndihmuar) tek e cila ajo mund të gjejë arsyen për të buzëqeshur sërish. Ajo dorë e zgjatur shihet nga ato si një shpëtim ,që troket më pas butësisht në derën e shpresës së ngujuar brenda qenies së kësaj femre ,që në fund të fundit gjithçka që ajo lyp dhe do të vazhdojë të lypë është " dashuria".

Së dyti,shfaqja më e arrirë e vënies dorë mbi një femër është në çastin kur një kokëfortësi boshe dhe e kotë i ka ndarë për disa kohë dy krijesa duke u thyer pasqyrat ku transkriptohet e vërteta. Është kjo ndarje që hyn kompromis me ndjenjën dhe i bën ata të kuptojnë se lidhja etyre është përligjur për të qenë e pavdekshme . Atëherë po që duhet vendosur dorë mbi një femër për ta shtrënguar ethshëm pas vetes ,në mënyre që të arrish të ndjesh dhe tik- taket e zemrës së saj ,që u varen si medaljon ndjenjave të tua ,që rrahin gjoksin për këtë gur smeraldi, që vezullon nën kraharor edhe nën rrymën e mallëngjimit.

Së treti ,emocioni në çift arrin majat më të larta, kur ai kurorëzohet me një krijesë ,që lartësohet në përmasat e hyjnores. Tingujt e këtyre çasteve janë kolona me e bukur zanore e filmit të jetës dhe në skutat e këtyre momenteve është e drejtë që mashkulli të vërë dorë mbi femrën duke e rrëshqitur lehtazi dhe përkdhelshëm atë mbi flokët e asaj ,që i dhuroi një arsye më tepër për të pritur lindjen e diellit të çdo të nesërmeje.

Janë këto tre situata brenda të cilave çdo mashkull duhet ta gjejë arsyen për të vënë dorë mbi një femër dhe askund tjetër. Një veprim ndryshe do t'i kthente në hipokritë ,që e kërkojnë veçantinë te veset.

Të hulumtuarit në thellësitë e së vërtetës së kësaj dukurie të ashtuquajtur dhuna ,që po kalb pjesën më të madhe të mendjeve mashkullore ,kërkon pajisjen me të tjera mjete, që i bëjnë jehonë së vërtetës. Fatmirësisht, pronësia e tyre bën që në fund të çdo fillimi të feks si xixëllojnë shpresa hijerëndë për t'u bërë autodidaktë të ndryshimit të procesit tonë të të menduarit.

Jam lindur nga një nënë ,që më ka ndihmuar të kompozoj jetën vetëm mbi drejtësinë ,jam ushqyer dhe veshur nga duart e saj, të papërtuara ,që më kanë mësuar të mos e humbas kurrë toruan përballë hovit të të tjerëve ,jam maturuar nën kujdesin e saj të pamasë dhe e kam parë veten tek zgjohesha dhjetëra herë në kraharorin nga i cili buronte aromë "nëne" dhe kurrsesi nuk do të doja që albumit te jetës time t'i shtoheshin foto të lotëve të saj. Them me bindje se shija e atyre lotëve do të më shndërronte në një kalë që harliset si i tërbuar drejt shkaktarit të tyre.

Pyes veten: Po sikur ai shkaktar të jetë ai që...

Përgjigja : Ky fakt nuk e kacafyt aspak qëndrimin tim.

Ndaj "burrë dhe baba" është ai që nuk bëhet marionetë e instinkteve kafshërore, por pre e arsyes që qëndron në thelb të njeriut.

Për fatin e mirë të nënave dhe femrave dhe për fatin e keq të atyre meshkujve ,që mundohen ti thyejnë ,ekziston një e vërtetë e pamohueshme , që konsiston në faktin se edhe përballë goditjeve të pamëshirshme të jetës,ato kanë ditur dhe do të dinë gjithmonë, sesi të jenë edhe më të forta, madje edhe në vendet ku janë thyer. Të gjithë familjet në përgjithësi dhe femrat në veçanti, që jetojnë me ndjenja të krisura nga fenomeni "dhuna" ,nuk duhet të kërkojnë fajin te pafajësia e tyre ,por të veprojnë lirshëm në klonimin e sjelljeve ,që i bëjnë rezistencë shtypjes së ushtruar mbi to dhe kërkimit të ndëshkimit ligjor dhe moral tëshkaktarëve. Gjithçka e kaluar ,që sillet si makth në të tashmen,bën mirë ti shitet të shkuarës pa çmim ,sepse çdo gjë e kaluar me ata që na vodhën pjesë nga lumturia nuk meriton as të mbetet ,e jo më të kujtohet.

E gjej veten shpesh të rrethuar nga mozaikë mendimesh dhe ndjenjash ,që vijnë si pasojë e fragmenteve të përditshme ,që më zë veshi dhe syri ,autorë të të cilave janë femra me të cilat abuzohet. Një i tillë është dhe ai që vijon: "Një herë e një kohë fjalët nuk më lëndonin, ndryshimi nuk më vriste, dashuria nuk më thyente,frika nuk më shokonte dhe shpresat nuk shuheshin kurrë. Eh,një herë e një kohë... E ndërsa sot kërkoj e gjunjëzuar që në vendvdekjen time të jetë veç një gur i shkruar: Këtu prehet një udhëtare e huaj ,e arratisur në kërkim të ëndrrës, që iu vodh në Tokë nga njerëzit." Pas një odiseje të lodhshme dhe të gjatë brenda vetes dhe të tjerëve për të iluminuar kuptimin e këtyre rreshtave, të cilët thoshin asgjë dhe gjithçka ,ndihesha pelegrin i vetmuar në këtë përpjekje të gjithëkohshme dhe të përjetshme për t'i siguruar femrës respekt dhe mirëqenie .

Të gjunjëzuarit e lirisë së një qenieje njerëzore, të shkelurit përdhunisht mbi plagët e hapura e të mëdha të pafajësisë dhe shuarja e dritës së shpresës së një shpirti të paqtë.A nuk janë këto gjithçka ata bëjnë? Kush i ka lejuar ?Kush po i lejon?Unë ,ti dhe të gjithë. Ndaj për të realizuar misionin ,që do ti çlirojë ato dhe ne nga të qenurit të plagosur nga shtiza e veprimeve shtazarake të tyre duhet të pohojmë që të gjithë njëzëri se: "Një herë e një kohë është sot dhe e sotmja është e vetmja mënyrë për të rigjetur dhe zëvendësuar orët e lirisë së humbur."

Punoi: **nx.Armanda Gjoka**

Dhuna ndaj gruas...

Drita ishte e hirtë me një horizont shurdh. Shiu binte si me përtesë e ankim, kur përplasej në qelqin e dritares dukej sikur rënkonte me një zhurmë të mbytur. Ajo vështronte dridhjen e atyre pikëzave prej të cilave qelqi dukej i mallëngjyer. Fytyra i kishte marrë ngjyrë balte gjë që të linte të kuptoje menjëherë, që kishte një shpirt të trazuar e mendjen e kishte gjetkë. Sytë e saj dukeshin sikur mbartnin në vetvete të qarën, por pa lot.

Duke ndenjur përballë dritares, zhytur tërësisht në një gjendje plogështie të trishtuar dëgjoi përplasjen e derës që u duk sikur e përmendi. Dëgjoi hapa prapa shpine dhe ndjeu t'ia përshkonin trupin mornica të tëra frike. Nuk e hapi gojën. E parandjeu atë që do të ndodhte. Një dorë u zgjat prapa krahëve të saj dhe e kapi nga flokët duke e rrëzuar në dysheme. Goditje të njëpasnjëshme pasuan. Ajo s'arrinte të mbushej me frymë. Faqet iu njomën. Nuk duroi më dhe një klithmë rrënqethëse u shkëput prej shpirtit të saj të trazuar e plasi nga goja si një dinamit. Mbase kjo klithmë bëri të shuheshin goditjet. Të paktën për pak. Gruaja u ngrit duke shtrënguar barkun me njërën dorë dhe duke fshirë njomën e faqeve me kurrizin e dorës tjetër. E njëjta situatë çdo ditë...

Nuk e kuptonte këtë njeri. Acarohej për gjëra absurde. Bërtiste nëpër shtëpi siç bërtasin ata që kanë një dërrasë mangët. Prishte, rrëzonte çdo gjë përret, kur nuk kishte më asgjë për të thyer dhe prishur, ikte. Ikte për t'u kthyer edhe më i acaruar dhe tërë acarimin e shfrynte te ajo gruaja e tij. Nuk kishte dashur kurrë asgjë prej tij, vetëm t'a linte të qetë. Nuk e kishte lidhur jetën me këtë njeri me deshirën e saj , por me vullnetin e tjerëve. Nuk i kishte thënë kurrë qoftë edhe një fjalë të keqe e përsëri ai jo vetëm që s'bëri gjë për t'a parë të lumtur, por edhe atë copëz lumturi ia vodhi e ia hodhi tej.

Ndërkohë që po mendonte këto, ishte ulur sërish në qoshen e saj të vetmuar , në të vetmin vend ku gjente prehje. I shoqi ishte larguar, me siguri ishte duke u kotur rrugëve me shpresën se do të mund të gjente diçka tjetër për të gjuajtur e për të shfryrë inatin që një zot e dinte nga ku i buronte. Shiu kishte pushuar. Shikonte udhën ngjyrë portokalli që linte dielli kur fshihej pas reve ,yjet që ndizeshin njëri pas tjetrit dhe nuk kishte si të mos e kaplonte një ëmbëlsi gjysmë e shuar, por ngushëlluese . Sapo kishte rënë nata dhe veli ngjyrë blu i hedhur në qiell si një pelerinë e magjepsur e zbukuruar prej yjesh të shumtë kishte shuar çdo gjurmë të portokalltë të pak çasteve më parë.

Rrinte ashtu duke kundruar me syteë gjysmë të perënduar, sa pamjen jashtë dritares, sa avullin që linte frymëmarrja e saj që ndërpritej herë pas here. Ndjeu akullsinë e dritares t'a përshkonte tej për tej . Ashtu ishte edhe ajo: e ftohtë, e akullt dhe me ndjenja të mbytura. Vitet e kaluara nën peshën e trishtimit dhe vuajtjes , kishin veshur zemrën e saj me ftohtësi dhe do të duheshin shumë pranvera që të shkrinin akujt. Dikur kishte qenë ndryshe. Nuk e kuptonte as vete ndryshimin që kishte pësuar ëe në momentin e parë që shkeli në këtë shtëpi. Dikur kishte patur një buzëqeshje plot shkëlqim në fytyrë , të tillë që do të dashuroheshin dhe gurët! Dikur, por jo më. Kjo buzeqeshje i kishte ikur përgjithmonë bashkë me ikjen e vajzërisë së saj ku kishte kujtimet më të bukura. Por kujtimet i ishin mjegulluar aq shumë saqë shpesh nuk arrinte të kuptonte në kishin qenë reale apo ishin thjesht një fryt i imagjinatës së saj... Koka po i pëlciste prej pyetjeve pafund që kishte . Pse nuk e shmangu martesën me atë përbindësh që kishte në vend të një bashkeshorti? E përse, dreqi ta hajë , përse? Pse i duhej të vuante prej atij të marri sa herë që ndonjë gjë shkonte keq? Përse i duhej të duronte dhe të ishte e detyruar të kyçte gojën? Ç'faj bëri e zeza që i shoqi i përbalti dinjitetin pështyu mbi lumturinë e saj qe ia shkërmoqi zemrën pa mëshirë, duke e bërë mijëra copëzash pa shprese ngjitje? Mbase,do të kishte qenë ndryshe nëse ai do të shkollohej. Ku i dihet? Mund të kishte mësuar ndonjë rresht mbi të drejtat e grave. Mbase, do të kishte mësuar të vetëpërmbahej. Mbase, do të ishin të lumtur... Po ku ishte lumturia e saj? E ndiente veten krejtësisht të padobishme . Si një frymë më shumë mbi dhe . E pa vlere ja ç'mendonte se ishte! Plehu i asaj bime që nuk arriti të lulëzonte në 'kopshtin e saj' . I asaj bime të rrallë që quhej ...lumturi...

Por , përsëri thellë brenda vetes , shpresa për më mirë nuk i ishte shuar. Do të shuhej vetëm kur të ikte dhe vetë nga kjo botë. Me siguri po të ikte askush nuk do ta vinte re. Do të ikte sikur të mos kishte ardhur kurrë! Po ai , i shoqi , si do të ndihej ? Ah, sikur t'i shihte ata sytë e tij të lotonin për të! Boll kishin lotuar të sajat!

Në çast i vetetiu në kokë ideja që e mundonte kohët e fundit. Në fund të fundit , pse ta zgjaste më kot? U ngrit nga qoshi i saj I heshtur duke prekur ëdo cep të tijin me mallëngjim. Ecte ngadalë , fare ngadalë. Shikonte përreth duke lëvizur kokën me mundim sa në njerën anë sa në tjetrën, e lotët nuk shtereshin. E kishte vendosur! Shpejtoi hapat drejt kuzhinës. Në dysheme kishte kudo copëza pjatash e gotash të thyera. Nuk i bënë përshtypje, ndonëse po i gërvishtnin këmbët. Në mes të gjithë asaj rrëmuje mbi dyshemene e kuzhinës arriti të dallonte me vështirësi atë që sytë po i kërkonin. E mori ndër duar dhe ndjeu zemrn t'i rrahe fort. Po ! Ishte thikë ! Britma të gjata e të çjerra dolën që nga thellesitë e shpirtit të vuajtur prishën heshtjen e ambientit të vdekur përreth. Nuk u besonte syve! Njollat e gjakut kishin ndotur dyshemenë . Për çudi ndihej e lehtësuar. Sytë po i perëndoheshin ngadalë. Nje buzëqeshje e vakët ia veshi fytyrën e saj. Çfarë ? Po vdiste dhe nuk kishte njeri përreth për t'i mbajtur duart? Po largohej pa e parë dhe një herë të shoqin ? Mbase më mirë të mos e shihte!! Fryma po i ndalej. Buzët iu mbyllën duke finalizuar dhe mbylljen e syve.u shtri sa gjerë e gjatë ende duke mbajtur thikën në duar. Mori fund ...

Heshtje. Me ne fund ishte larguar nga kjo bote prej se ciles vetem vuajtje pati .U ngjit atje lart, e prej andej mund te shihte e te bente cdo gje qe i thoshte zemra e saj. Ishte shkrire tashme zemra e akullt. Fytyren e saj e pershkonte perseri buzeqeshja plot shpirt e diteve te vajzerise. Heh,per here te pare pas shume kohesh, ishte e lumtur, ndonese ne nje bote tjeter!

Olta Shehu, *Klasa: IX-a,*
Shkolla: "Demir Gashi"Peshkopi

Robinjë e qenies tënde

Një tingull mund të jetë një fije shpëtimi, një psherëtimë mund të shndrrohet në shpresë, një frymëmarrje mund të ndriçojë një iluzion...

Por jo...

Jetoj e ngujuar në një dhomë boshe ku nuk ka asgjë, veç ofendimeve dhe keqtrajtimit tënd...

Është shumë e çuditshme mënyra se si më ke tjetërsuar...Tani nuk mbaj më unin tim të rreshkur ndër vite, jam robinjë e qenies tënde, dëshirave dhe ëndrrave të tua...

S'më mbetet gjë tjetër, vetëm të uroj errësirën rreth meje, rrënimin dhe gjunjëzimin para teje. Zërat e hienave, që vijnë nga të gjitha anët, nga thellësia e së shkuarës, nga torturat e së tashmes së përjetuar...

Jam e burgosura jote...

Jam skllave e vuajtjeve të mia, ndërkohë kamzhiku godet me forcë çdo pjesë të trupit tim...

Mënyra se si m'i ke shtrembëruar, shpërfytyruar është e neveritshme...

Dita – ditës unë shoh se si shpresa për t'u larguar nga ti zhduket në çdo kohë, hapësirë dhe pakuptueshmëri, drejt një realiteti të huaj, që vetëm e ardhmja ime nuk mund të jetë, natyrisht as e tashmja... Këtë ndjenjë asfiksuese në shpirtin tim përjetësia do të ma bëjë më të tmerrshme se vdekjen.

Lutem me shpresë çdo agim dite, por është e kot... Vetja ime nuk ekziston më, vetja ime në netët e errëta, e pakontestueshme, e pakritikueshme, e admirueshme,...

Fuqitë e mia kanë shterur,çdo qelizë e trupit ka vdekur, mjegulla po shpërndahet mbi mua duke mbuluar fytyrën time, kujtimin tim si skamnor i lumturisë.

Historia përsëritet...

Kjo nuk është imagjinata ime, por kjo ndodh sot... Në fakt ndodh sot, nesër, çdo ditë...

Bëhem ndryshimi që dëshiroj të shoh në botë...

Universi komploton për të më ndihmuar , që të arrij qëllimin....

E ardhmja u përket atyre, që besojnë në bukurinë e ëndrrave të tyre...

Punoi: **nx. Elsa Sala**

Rruga e Arbërit nr. 129

veprimtari

“Ngritje pa krye”, komedia ku shfaqin talentin dy vajzat nga Dibra

Nga **Alban TUFA**

Gjithçka filloi aty ku duhej të mbaronte. Në një fabrikë këpucësh ndodh një protestë me tonet e një kryengritje, ose më mirë diçka më pak se kryengritje…një ngritje pa krye. Përse pa krye? Sepse nuk i jep zgjidhje përfundimtare asnjë problemi. Pasqyron vetëm gjendje. Një gjendje e vështirë e cila të dikton nevojën e ngritjes së zërit për rritje rroge, për kushte më të mira pune, për të drejta, për dinjitet. Cilat janë rrugët që i janë hapur grave? Cila nga këto të çon në udhë pa krye?

Puna në fasoneri, përpos një anomali e ekonomisë së tregut dhe një dështim i kapitalizmit. Në ditët tona mund ë konsiderohet si përplasja e fundit që i bën sistemi patriarkal një numri shumë të madh të grave dhe vajzave.

Përveç këpucëve, aty fabrikohet dëshira e ikjes, pamundësia e zgjedhjes, ankthi i kohës, nevojat ekonomike si dhe konflikti personal. Si munden ato të gjejnë pavarësinë? Cilat janë rrethanat që kufizojnë lirinë e tyre dhe a do munden ato t’i kapërcejnë?

Kjo është ajo që pasqyroi shfaqja teatrale e dhënë më 21 janar në Pallatin e Kulturës Kamëz me regjinë e Ergys Malsisë, dhe skenar të Diana Malajt nën e aktrimin e vajza të “FemArt”. Ato janë pjesë e grupimit rinon ATA me qendër në Kamëz.

“Ngritje pa krye” si parësore e ka të rrisë ndjeshmërinë ndaj çështjes kryesore që trajtohet, ndaj dedikimit, përkushtimit dhe sakrificës që bëjnë çdo ditë në heshtje të gjitha gratë dhe vajzat që për një arsye a tjetër janë të detyruara të përplasen në këtë “mundësi” që në fakt më shumë se mundësi- është pamundësi për të shkuar/punuar diku tjetër. Pastaj patjetër që ka nota rebelimi ndaj kësaj gjendjeje sociale e cila ka paracaktuar rolin e gruas në shoqëri. Ironizohen me kujdes “adetet maskiliste” , institucioni i martesës me shkuesi etj. Synon të mprehë mirë “shqisën feminist” me të cilën duhet t’i shohim gjërat e përditshme të cilat deri tani na janë paraqitur krejt normale.

Komedia me nota jo të vogla dramaciteti mbushi sallën me të rinj e të moshuar dhe fitoi duartrokitjet e tyre

ATA kanë zgjedhë të jetojnë ndryshe nga bashkëmoshatarët e tyre, madje edhe nga të rriturit, duke mos humbur kohën kafeneve e gjetkë. Në Kamzën e tyre plot paragjykime dhe plot mangësi si në aspektin e nevojave dhe të argëtimit po vënë bazat e ngrehinës së tyre artistike. Si projekt të parë madhor vajzat e “FemArt” dolën me këtë shfaqje.

Diana Malaj shpjegon: “ Grupi “FemArt” është i përbërë nga disa vajza me moshë nga 15 deri në 20 vjeç dhe ka si fokus kryesor krijimin e një klime të ngrohtë dhe rehatie mes grupit në vetvete me qëllim trajtimin e problemeve sociale të para në optikën e perspektivës gjinore.

Takimet e FemArt finalizohen çdo fundjavë me prezantime teorike, takime tematike në lidhje me teoritë e studimeve gjinore, pjesëmarrja e gruas në jetën sociale, të drejtat e tyre civile, trajtohen dhe praktikohen mënyrat (informale) të fuqizimit të vajzave, identifikimi i cilësive të tyre dhe puna e përditshme me to, janë të gjitha nuanca të grupit tonë.”

“Për mua “FemArt” është një projekt tejet i veçantë sepse flet për femrat, për respektin ndaj tyre, për problemet e tyre, për sukseset që kanë arritur dhe pse jo mund edhe të frymëzohem nga ndonjë femër e suksesshme, ku dhe unë mund të kem një të ardhme të ndritshme si ata”, - thotë Kleziana Domi, lindur në Sllovë të Dibrës.

“Pas shfaqjes u ndjeva shumë e emocionuar sepse tek po dëgjoja njerëzit që po largoheshin dhe po flisnin për shfaqjen, u gëzova që ishte përcjellë mesazhi të cilin ne kishim synuar të përcillnim.”, tha ajo më tej.

Kleziana shpreh dëshirën për ta ndjekur rrugën e aktrimit duke e parë edhe si profesion. Kjo ishte dalja e saj e dytë para publikut si aktore dhe talenti i saj është vërtetë për tu admiruar.

Një pjesë e vajzave e ka përjetuar thellë historinë për shkak të afrisë me eksperiencat personale të tyre, në mos vetë, kanë mamatë ose dikë të afërt të punësuar në fasoneri. Një pjesë tjetër e vajzave, më të voglat, e kanë marrë me shume entuziazëm angazhimin e tyre në shfaqje dhe daljen e parë publike.

Shpeshherë ne qëndrojmë në prag të së vërtetës, të trembur. Dhe gjithmonë të vërtetat kur thuhen me shaka, pranohen më kollaj. Teatri, fotografia, poezia apo çdo formë tjetër kreative e cila hyn në komunikim me tjetrin simbolikisht dhe pa e friksuar, do të jenë praktikat tona më të mira, ndaj shfaqja nuk ishte ezauruese, përkundrazi vetëm sipar i iniciativave të tjera që do të ndërmerren në vazhdim nga grupi FemArt.

Ndërsa Esina Isufi, me prejardhje nga Tërnova shprehet: “ Pas shfaqjes ndjeva vërtet rolin tim në këtë shoqëri. U ndjeva mirë që kam dhënë pak nga unë për ndërgjegjësim sado i vogël të jetë, aty njerëzve që panë shfaqjen dhe atyre që do e shohin.”.

Në vazhdim ajo shpreh dëshirën për të studiuar aktrim në Akademinë e Arteve, duke qenë se e pëlqen këtë art dhe gjen veten në të.

Megjithëse jo profesioniste këto vajza dëshmojnë se praktika dhe puna të bëjnë vërtet të ndjehesh profesionist, e kjo shihet qartë kur një sallë e tërë të duartroket. Ato e duan artin dhe këtë duan ta injektojnë në shoqëri.

Esina Isufi, me prejardhje nga Tërnova shprehet: “Pas shfaqjes ndjeva vërtet rolin tim në këtë shoqëri. U ndjeva mirë që kam dhënë pak nga unë për ndërgjegjësim sado i vogël të jetë, aty njerëzve që panë shfaqjen dhe atyre që do e shohin.”

Njeriu i punës dhe i pasionit për jetën, **ISA HOXHA**

Para një muaji u nda nga jeta, një dashamirës i punës, i njerëve dhe i qytetarisë dibrane në Tiranë, Isa Osman Hoxha.

Lindi më 3 mars 1935 në një familje të madhe, me vlera qytetare ardhur nga Reka e Dibrës së Madhe, në fillim të shek. XX. I ati, Osman Hoxha, kish shërbyer si zyrtar i lartë në zonën nga ku vinte-Kryetar Komune i Rekës, por edhe Deputet në Parlamentin e ish-RF Jugosllave, si përfaqësues i Dibrës për Partinë Radikale në vitet 1926-1928. Në këtë moment, kur fuqinë në Jugosllavi e merr diktatura ushtarake, Osmani largohet nga Reka për të ardhur në Shqipëri, i kërkuar si shqiptar i rrezikshëm për shtetin serb.

Nga ky moment e deri në vitin 1939, Osman Hoxha, ka shërbyer si zyrtar i lartë në administratën e re shqiptare, ku përmendim: Kryetar Bashkie në Sarandë (1928-1930), Kryetar Bashkie në Lushnje (1930-1933), Kryetar Bashkie dhe Nënprefekt në Burrel (1933-1937) dhe Kryetar Bashkie në Fier (1937-1939). Pas okupacionit fashist nuk pranoi të punonte më në administratë dhe mbylli sytë në Tiranë në vitin 1956.

Bir i denjë i kësaj dege të Fisit HOXHA, Isai kreu shkollën unike në Tiranë, si dhe dy vite shkollim në Medresenë e Tiranës. Duke pare perspektivën e zymtë të shkollimit fetar nën rregjimin komunist, i ati u bind nga njerëzit e fisit që Isain ta rregjistronte në Politeknikumin “7 Nëntori”, meqë shfaqte aftësi të mira teknike.

Pasi kreu këtu degën elektrike me rezultate të larta, me shumë vështirësi u rregjistrua në Institutin Politeknik pasi nuk i jepej e drejta e shkollimit për arsye biografie (dy nga vëllezërit e tij më të mëdhenj kishin kryer burg për antijugosllavizëm nga rregjimi komunist).

Në vitet e para të punësimit, Isain e përndoqi biografia dhe punoi si elektriçist i thjeshtë në Hidrocentralin e Ulzës, ku u dallua për profesionalizëm të lartë dhe u transferua si shef i Stacionit elektrik në Cërrik. I aftë e i apasionuar pas profesionit, Isai i bëri kudo vend vetes me punë të pakursyer dhe përkushtim.

Kështu transferohet në sektorin e sizmikës në Institutin e kërkimeve të naftës me qendër në Fier, ku punoi për mëse 13 vjet. Së fundmi në vitin 1975 transferohet në Tiranë në sektorin e energjitikës të Kombinatit të tullave në Tiranë, ku kishte gjithë fisin dhe familjen. Punoi aty deri sa doli në pension në vitin 1995.

I martuar me Fitnetin, arsimtare nga familja autoktonase tiranase Ndroqi, mbesa e dijetarit të shquar të fesë Islame, Hafis Ismail Ndroqi, i cili ka drejtuar edhe Bashkinë Tiranë, si dhe vëllai i doktorit human Prof. Shefqet Ndroqi. Nga kjo martesë ato patën tre vajza dhe një familje të rregullt me vlera të larta ndershmërie, korrektese e qytetarie.

Isai ishte njeriu ku zë vend plotësisht fjala e urtë popullore: ”Ç’i sheh syri, ia bën dora”. Kishte një paraqitje të pastër, të rregullt, sqimatar, tipik “dibran”, plotë respekt dhe përkushtim për çdo moshë.

U nda nga jeta, duke lënë bashkëshorten, fëmijët e plotë niper e mbesa, më 2 janar 2017, në moshën 82 vjeçare, (nga një atak kardiak) por me një paraqitje, vitalitet e energji që nuk e reflektonte moshën;

Shoqata “Bashkesia Dibrane”, Komuniteti Dibranë në Tiranë, si dhe “Këshilli i të Urtëve” i Bashkësisë Dibrane, i shprehin ngushëllimet e sinqerta familjes së z.Isa Hoxha, dhe të afërme të tij.

Shpirti i tij u prehte në paqen e përjetëshme.
Qofte i Xhenetit, qoftë për jetë i kujtuar.
Lamtumirë Isai ynë i shtrenjtë!

elegji

Elegji për Bajkenin
(Nipin)

Dhimbja

U nda nga jeta në mënyrë kaq të shpejtë e të papritur e në moshë të re... Pse kaq shpejt? Pse ky fat i zi? Pse, për ty e për ne? Edhe gurët e sokakut do e ndjejnë mungesën tënde, do të kërkojnë e do t'i marrë malli, o Bajken...

Po ç'emër t'u vinim këtyre lotëve? Kur akoma s'ishin tharë lotët e mortes. Janë lot që nxjerrin në pah se jeta e vdekja janë udhëtare. Se është në bashkejetesë dhimbja me paqen dhe janë pjesë e jetës e hidhura dhe e ëmbla.

Para disa ditësh përcollëm në banesën e fundit Bajkenin, njeriun tonë të dashur të zemrës.

U nda nga jeta në mënyrë kaq të shpejtë e të papritur e në moshë të re, duke lënë në pikëllim të thellë prindërit, vajzën, Imeldën, vëlla Dritanin, kushërinjtë, miqtë dhe gjithë shokët e punës, të cilët e kishin si vëlla. Na la pas hidhërim e dhimbje. Ike në kulmin e moshës. Pse kaq shpejt? Pse ky fat i zi? Pse, për ty e për ne? Edhe gurët e sokakut do e ndjejnë mungesën tënde, do të kërkojnë e do t'i marrë malli, o Bajken. Po ku e le vajzën që e deshe aq shumë?

BISEDË ME GURËT E SOKAKUT

- A e morët vesh se ka ndërruar jetë Bajkeni? – tha një nga gurët e sokakut.

- Po, – thanë të tjerët - e morëm vesh, biles ka pesë muaj që ka qenë i sëmurë. E dëgjova rastësisht në rrugë kur kaloi Xhimi që po i thoshte Almës.

- Aaaa, prandaj ka pesë - gjashtë muaj që s'vjen të na shohë - thotë tjetri - që kur ka ikur në Tiranë, në çdo 2-3 javë do na vinte e të na shihte, Xhimin e ne.

Na ra shumë keq, jo vetëm mua, por të gjithëve - thotë njëri gur.

- Më shumë më ka rënë mua - thotë guri pranë derës së shtëpisë, - se këtu ka shkelur më shpesh.

Gurët afër avllisë thonë: - Po, por kur ishte i vogël, më shumë hynte nga avllia në shtëpi se nga dera.

E Guri më i vjetër ndërhyn: - Të gjithëve na ka ardhur keq, do ta kërkojmë e do të na marrë malli.

- E kujt nuk i ka ardhur keq për Bajkenin, kur neve, po njerëzve?

- Mos u qaj hallin njerëzve, - thotë tjetri - se njerëzit i ka bekuar Zoti, se çfarë nuk i ra njeriut e nuk e mbajti. Atyre natyra u dha privilegjin të qajnë të nxjerrin lot e me lotët që nxjerrin ata pastrojnë shpirtin e lehtësojnë dhimbjen.

- Lotët janë të vlefshëm si gurët e diamantit, madje më të vlefshëm, se diamantët dalin nga thellësia e tokës, kurse lotët dalin nga thellësia e shpirtit, por pale a e vlerësojnë njerëzit këtë gjë.

- A e dëgjuat si tha një burrë, D. Shehu?- tha një gur - se dhe gurëve të sokakut u ka ardhur keq. I vetmi që na ka kuptuar neve, se të tjerët nuk i kanë parë të çarat tona që kemi pësuar ndër vite.

Ky sokak ndër vite ka parë shumë morte të rënda. Ka filluar me Metin, Skënderin, Mufitin, Lufta, Leta, Sadeti, Yllka, Krenari e Bajkeni.

Në morte, sidomos në ato të rënda, njerëzit bëjnë shumë pyetje. Po ç'na bëre mo Bajken? Po pse ike, mo Bajken? E shumë pyetje të këtij lloji. - Po pse, a Bajkeni e zgjodhi atë rrugë? Se të ishte për Bajkenin, ai edhe 100 parajsa nuk do t'i ndërronte, por do të rrinte me vajzën e me Xhimin. Pra, duke qarë ngarkohen edhe me gjynaf, po ajo gruaja tjetër – ç'na bëri ai voc, mi Zime.

- Mos e tepro, – thotë guri tjetër - se në këtë rast ajo i dha të kuptojë Zimes, se ajo, jo vetëm merr pjesë në hidhërim, por po merr gjysmën e hidhërimit të saj. E siç e thashë edhe më përpara, prej të keqit bëhen lloj-lloj pyetjesh, por që përgjigje s'mund të marrin nga mendje njerëzore. A një pyetje është me vend. Pse ky fat zi? Sepse kjo është gjysëm ngushëlluese dhe do të thotë që jeta e çdo njeriu është në fije të perit, që nuk i dihet se si, kur, e ku pritet, ndërsa për dhjetëra pyetje të tjera ka vetëm një përgjigje: Fatit të parashkruar në qiell nuk i gjendet dermani në tokë (sentencë greke).

Kjo rrugicë ka parë shumë tërmete, por dhe ne gurët e sokakut jemi bërë për t'u ngushëlluar e do të na mungojë Bajkeni. Po pse, a është kujtuar njeri për ne? Sa budalla që bëhesh, por tërmeti më i madh për ne gurët ka për të qenë kur do të na varrosin duke na mbuluar me beton e asfalt, në emër të progresit e qytetërimit, pa e menduar gjatë se ndërkohë kështu njerëzit varrosin kujtesën e tyre. E ç'është jeta e njeriut pa kujtesë? Kujtesa mban të gjallë të vdekurit e të gjallët.

MORTI

As koha e ftohtë e acartë, as bora e era e temperaturat e ulta nuk i penguan ato lumë njerëzish, që erdhën për të përcjellë e respektuar për në banesën e fundit Bajkenin. Erdhën shokët e femijërisë, të shkollës e të sokakut. Në këtë ngricë e me rrugë të bllokuara e bënë gjithë atë sacrificë duke vënë dhe veten në rrezik. Por ç'u ke bërë, mor voc, që të dashkan kaq shumë e të respektuan.

Po lumi i njerëzve nuk u ndal as në Itali, që për dy muaj ndejte për kurim, kushërinj shokë e të njohur erdhën e të panë. Si dhe të njohur e të panjohur që ishe në Itali erdhën të panë, të dhanë kurajo e të qëndruan pranë, e të mbështetën me sa kishin mundësi. A u harrohet atyre të gjithëve, e vëllezërve Vani me bashkëshortet e tyre. Po kushërinjt e tu, që dy muajt e fundit nuk u ndalën asnjë ditë e asnjë natë, e nuk të lanë vetëm, e të mbajtën me biseda, humor e kurajo, e më duket se ta zgjatën jetën. Po shokëve të punës, mor Bajken, kolegë e shoqe, ah Zot më fal se gabova.

Po ato nuk ishin shokë, por vëllëzerit e tu. Ato nuk ishin shoqe, por motrat e tua. Ato nuk ishin kolegë, por ishin Dritanët e tu. Po nuk mbeti asnjë prej tyre pa qarë, mor Bajken, me lot në sy. Po ato ma hijeshuan mortin, mor Bajken. Po s'di ç'të them më shumë, s'di si t'ua shpërblejë se më duket shumë pak një faleminderit e thënë nga goja, edhe pse e them me zemër. Por vetëm lutem: Zoti i bekoftë e mos paçi fatkeqësi të tilla në shtëpitë e tyre.

Si nip të kisha përzemër, por nuk ia fal vetes që s'të kam njohur tamam. Kjo besoj është për të gjithë ne. Mua kjo brengë do më shoqërojë gjithë jetën. Kjo do të jetë një arsye më shumë, si dhe kujtimet që kemi së bashku, që nuk do të harrohesh. Se njeriu nuk konsiderohet i vdekur për aq kohë sa kujtohet nga të tjerët. Ra ky mort dhe kuptova se kush qenke. Respekti i treguar nga njerëzit dhe lotët në sytë e tyre nuk tregonin vetëm dhembshuri, ata ta bënë respektin si NJERI QË MERITOJE RESPEKT. Për mirësinë që kishe, për urtësinë, me ty flitej e debatohej me kënaqësi për librat, për artin, për muzikën, kishe diapason për jetën, mbi të gjitha ishe person që s'të mungonte guximi e kurajo, të cilat unë i kisha provuar tek ty. Akoma më shumë ngushëllimet e marra nga Facebook-u si dhe të shokëve që vinin për ngushëllim evidentonin respekt e dhimbje të shoqëruara me shkrimet e tyre, si dhe të treguara nga gojët e shokëve të tu, duke treguar cilësitë e tua më të mira e gjithë vërtetësi. I falenderojmë nga zemra gjithë ata që na ngushëlluan. Qofshin të bekuar!

JETA

Në një mbasdite, kur rrinim deri vonë të mbledhur, kryesisht të afërm të Bajkenit, në mort, duke bërë biseda, Shpëtimi shprehet: Me e dit se më percjellin kaq shumë njerëz e me një mort kaq të hijshme sa kjo, ku të gjithë lotojnë, nuk më ngelet merak me vdek prej nesër. Por kam frikë se kur të vdes unë, pale do mblidhen njëzetë a tridhjetë veta me më përcjell.

Ja pret një tjetër: – Prap më duken shumë, o Shpëtim.

- Më duket se ke të drejtë – përgjigjet Shpëtimi. Do t'ju tregoj një histori, si i thoni ju me shkollë, një episod nga jeta. Në Peshkopi, në lokalin e punës, berberhane, ishin katër–pesë kolegë. Lokali ishte plot me njerëz. Hyn dhe një katundar, i cili ulet si gjithë të tjerët dhe pyet: "Ku qenka usta Jahja?" Nuk vjen sot i përgjigjet, se është paqejf , por është i biri, e më tregojnë mua me gisht. U pyetëm si zakonisht: Si je, nga je, etj. Ai fillon me pyetjen për sëmundjen e Jahjes e unë i përgjigjesha me indiferentizëm, si pa interes. Ndërkohë fillojnë ngacmimet dhe nga kolegët e tjerë. Katundari shumë shpejt ra viktimë e ambientit përreth shpotues e ngacmues, dukej se ishte shumë i drejtë e i sinqertë. Shpejt ai po binte viktimë e ngacmimeve tona. Por më i zellshmi isha unë e duhet të luaja rolin e brezit të ri që nuk çaj kokë për prindërit. Biseda thellohet hidh e prit me kolegët dhe shikonim me verejtje që katundari po nevrikosej, se nuk i përputhej koncepti i tij me fjalët tona. Nuk i mbaj mend të gjitha çka thamë. Erdhi koha që të ulej te karrigia ime, ndërkohë biseda vazhdonte e unë them se ku ka si gruaja, të kem cullët mirë, të jem rehat, pa për të tjerët, a s'kan shku në ...

Ndërkohë po i vija përparësen e bardhë për qafe, ai shifte majtas djathtas, por asnjëri s'po qeshte, se po ta merrte vesh se po talleshim, nuk i dihej fundi. Unë flisja në dukje me seriozitet. Sa i vura pecetën, ai brof nga karrigia, heq nga qafa pecetën e hedh në ndenjësen e karrikes e më drejtohet gjithë inat: Jazik, mor të qoft, i kujt babe je e flet kështu, por Jahjen e njeh dhe e nderon gjithë Dibra, edhe ti flet kështu, jazik, jazik të qoftë! Ec e fol derisa shkoi te dera. E hapi të dilte e drejtohet me fytyrë nga unë e më thotë: - Po për ty edhe vorr s'ka për të pas, mor jezit! E përplas derën e ikën. Fillojmë të qeshim, por pamë se e tepruam pak ... Kjo histori gati 50-vjecare, ndër vite ishte harruar. Kur erdha të banoja në Tiranë, një ditë të bukur, duke ngrënë dreke me një teke raki përpara, gjithë qejf me televizorin ndezur, kur shoh në lajme se Bashkia e Tiranës njofton se për disa kohë janë mbyllur varrezat, derisa të sqarohet konflikti midis bashkisë dhe pronarëve të tokave të Tufinës e Sharrës. Vazhdova të ha bukë gjithë qejf apo s'kisha dhe spece të mbushme, e them me vete: Eh Tiranë, o bir! Pas nja dhjetë minutash se si më erdhi në tru e nëmura e atij katundari, se për ty s'ka për të patur vorr. Filloi truri ta përpunonte e mua filloi të më kapte jo frika, por ankthi. Mendoja se mos po më zë e nëmura e atij katundarit e po vdes këto ditë që s'ka varre. Ndejta gjithë kohën me frikë, edhe shokëve të mi nuk u dëftova frikën, por Zot shyqyr nuk zgjati më shumë se dy jave kjo situatë. Fillova të qetësohem e ta marr veten. E ndërkohë, gjatë bisedës që bëhej, njerëzit përreth ishin në ilaritet gjatë tregimit, kur befas ia pret një nga nuset e reja: O Timi, kot je merakos aq shumë, veç të vdisje se flori do pagunim e një vend do ta gjenim.

Nga ilariteti plasën të qeshurat me lot. Po ç'emër t'u vinim këtyre lotëve? Kur akoma s'ishin tharë lotët e mortes. Janë lot që nxjerrin në pah se jeta e vdekja janë udhëtare. Se është në bashkejetesë dhimbja me paqen dhe janë pjesë e jetës e hidhura dhe e ëmbla.

U PREHSH NË PAQE, BAJKEN!

I paç lënë jetë vajzës, edhe pse në çdo aspekt të jetës kujtimi yt do të jetë prezent, përsëri do na mungosh ti, humori dhe ironitë e tua. Nuk do të shikojmë për së afërmi përkujdesjen e përkëdheljet e tua ndaj Xhimit. E trajtoje atë sikur s'ishe djali i saj, por vajza. Do ta ndjejmë përgjithnjë mungesën tënde, o DJALË, o BABA, o NIPÇE.

Daja Selamiu

Rruga e Arbërit

Aty ku fjalët nuk i merr era!

+5°C H: +5° L: 0°
Peshkopi
Friday, 16 December
See 7-Day Forecast ...

Sat	Sun	Mon	Tue	Wed	Thu
+1° -7°	+5° -7°	+3° -8°	0° -7°	-5° -12°	-9° -15°

KRYESORE | AKTUALITET | OPINION | INTERVISTA | KULTURE | ARKIVA NE PDF | PETICIONI | PAJTOHU / NDIHMO EDHE TI

Na ndiqni *online*, falë ndihmës së z. Agim Deva, të cilin e falenderojmë për ndihmën dhe përkushtimin.

Informacioni për këtë website:
info@rrugaearberit.com
Informacioni për gazetën:
rrugaearberit@gmail.com
Përdor KONTAKT PAGE për pyetje dhe sygjerime.
Shtyp butonin **"NDIHMO EDHE TI"** për tu abonuar dhe kontribuar në botimin e gazetës. Çdo lloje kontributi shkon në masën 100% në llogarinë e gazetës në Tiranë/Shqiperi në mënyrë të sigurtë përmes PayPal.

Ky website është komplet një kontribut (donacion) në shërbim të botimit të gazetës "Rruga e Arbërit", lobimit për ndërtimin e rrugës me të njëjtin emër, që do lidhë Tiranën me pjesën tjetër të Ballkanit në Lindje të Shqipërisë, si dhe zhvillimin e Dibrës dhe krahinave përreth.

© Copyright Rrugaearberit.com & Gazeta "Rruga e Arbërit". Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Rrugën e Arbrit ia kërkojmë qeverisë shqiptare, jo inxhinierëve dhe shoqatave qytetare

Nga Gëzim Alpion Më datë 28 tetor 2016, nga një lajm i revistës Monitor1, dhe më pas nga disa media »

NUMRI I RI

Shtyp foton për versionin në pdf ose abonou për versioni print.

GAZETA

Gazetën mund ta gjeni në pikat kryesore të shitjes në Tiranë, Durrës, Fushë Krujë, Elbasan, Shkodër, Burrel, Klos, Bulqizë, Peshkopi dhe Dibër të

printime dixhitale
me ngjyra dhe bardh e zi
shpejtësi | cilësi | çmime të favorshme
libra | broshura | revista | fletëpalosje
katalogë | kalendarë | postera | ftesa etj.
duke filluar nga 1 kopje e vetme
për informacion: mbbotime@gmail.com / Cel. 069 20 68 603

cyan magenta yelloë black 24